www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 7

Tiranë – E mërkurë, 27 janar 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 20.1.2016	Për emërim në detyrë	343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 20.1.2016	Për lirim dhe emërim në detyrë	343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 20.1.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar	343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 20.1.2016	Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë	343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 20.1.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 954, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)"	344
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 20.1.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta"	345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2016	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2015-2020	345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 20.1.2016	Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth	400

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 21.1.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	407
Kërkesë e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 331, datë 19.1.2016	Për shpronësimet për interes publik të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë–Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)", për objekte dhe truall	412
	Ndreqje gabimi material në tekstin e vendimit nr. 1098, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 243/2015.....	413

VENDIM
Nr. 17, datë 20.1.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gëzim Musabelli emërohet zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 18, datë 20.1.2016

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ilirjan Mustafaraj, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ilir Marko emërohet zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 20, datë 20.1.2016

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida"**;

1. AKHMED; RAJAPOVICH; CHATAEV

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 24, datë 20.1.2016

PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "e", e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin

dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, me vlerë të përgjithshme 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, për periudhën 2016-2018. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë.

2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme deri në 70% të kostove të pranueshme, por jo më shumë se 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë.

Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen përfshihen kostot, për:

a) përmirësim produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;

b) pjesëmarrje në panaire jashtë vendit;

c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;

b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) Kanë një strategji dhe plan marketingu;

ç) Janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij;

d) Kanë paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni tatimor dhe doganor.

4. Pagesa e subvencionit bëhet 50%, me miratimin e projektit, dhe 50%, në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën e përgjithshme të projektit.

5. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

6. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

7. Aplikuesit janë të detyruar të raportojnë periodikisht pranë AIDA-s lidhur me zhvillimin e projektit dhe qëllimin për të cilin është përfituar ky fond.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 25, datë 20.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 954, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE (ARTIZANATI)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 6, 7, 8 e 9, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 954, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit i pikës 4 riformulohet, si më poshtë vijon:

"Nuk përfitojnë nga ky fond sipërmarrjet të cilat kanë përfituar nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucionet financiare ndërkombëtare për të njëjtin projekt.".

2. Pika 5 riformulohet, si më poshtë vijon:

"5. Projektet që përzgjidhen nga sektori i artizanatit mbulojnë fushat e mëposhtme:

a) Zhvillimin e produkteve të reja;

b) Blerjen e pajisjeve për nxitjen e prodhimit;

c) Marketingun e produktit;

ç) Kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese.".

3. Shkronjat "ç" dhe "e", të pikës 6, shfuqizohen.

4. Pika 7 shfuqizohet.

5. Emërtimi "Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministri përgjegjës për ekonominë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 26, datë 20.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "b", të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, emërtimi "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Portin Detar të Durrësit dhe në radën përkatëse, me kodin VII.5.2" zëvendësohet me emërtimin "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse, me kodin VII.5.2".

2. Në shkronjën "c", të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, emërtimi "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet detare të Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse, me kodin VII.5.3" zëvendësohet me emërtimin "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat e tyre, me kodin VII.5.3".

3. Pas shkronjës "e", të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, shtohen shkronjat "ë" dhe "f", me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"ë) "Për ushtrimin e veprimtarisë së ormexhimit", me kodin VII.5.6;

f) "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", me kodin VII.5.7.".

Pika 3 e nënkategorisë VII.5, ndryshon me këtë përmbajtje:

"3. Licencat e nënkategorive VII.5.1, VII.5.2, VII.5.3, VII.5.4, VII.5.5, VII.5.6 dhe VII.5.7 trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese, që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t'iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL-ja, për nënkategoritë VII.5.1, VII.5.2, VII.5.3, VII.5.4, VII.5.5, VII.5.6 dhe VII.5.7, janë ato respektive, të përcaktuara në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 27, datë 20.1.2016

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR BURIMET E ENERGJISË SË RINOVUESHME, 2015–2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme 2015–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BURIMET E ENERGJISË SË RINOVUESHME NË SHQIPËRI 2015–2020

Shqipëria si palë kontraktore në Traktatin e Komunitetit të Energjisë

Shtator, 2015 (miratuar në janar 2016)

LISTA E AKRONIMEVE

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
BRE-N&F	Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Ngrohje dhe Ftohje
BRE-E	Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Energji Elektrike
BRE-T	Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Transport
EE	Eficienca e Energjisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
EUROSTAT	Statistikat Evropiane
HEC	Hidrocentral
HECV	Hidrocentral i vogël
KM	Këshilli i Ministrave
KFBE	Konsumi Final Bruto i Energjisë
ktoe	Kilo ton ekuivalent nafte (*kilo ton oil equivalent*)
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MM	Ministria e Mjedisit
NUED	Ngrohja e Ujit me Energji Diellore
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PKVER	Plani Kombëtar i Veprimit për Energjitë e Rinovueshme
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
VNM	Vlerësim i ndikimit në mjedis
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria si një prej Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është e detyruar të transpozojë dhe të jetë në përputhje me direktivën e BE-së 2009/28/EC, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme". Një nga kërkesat e ligjit 138/2013 "Për burimet e rinovueshme të energjisë" dhe e kësaj direktive është përgatitja dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (PKVER), i cili vendos objektiva kombëtarë të energjive të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit, si dhe masat mbështetëse për t'i arritur ata.

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare e ka konsideruar promovimin e përdorimit të energjive të rinovueshme si një mjet të rëndësishëm të politikave të energjisë për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit

Edhe pse në fakt Shqipëria siguron mbi 95% e energjisë elektrike nga hidrocentralet, një pjesë të konsiderueshme të energjisë e importon, pjesë e cila varion – në varësi të kushteve vjetore – midis 30% dhe 60% të totalit të furnizimit me energji primare. Energjitë e Rinovueshme mund të jenë një zgjidhje për reduktimin e kësaj varësie nga importet dhe për të përmirësuar jo vetëm sigurinë e furnizimit me energji, por edhe sigurinë makroekonomike dhe politike të vendit duke zvogëluar deficitin e buxhetit të vendit.

Mbi bazën e këtyre fakte që ofrojnë kontekstin për rritjen e mundshme të rolit të BRE-ve në gjendjen e energjisë dhe ekonomisë aktuale në Shqipëri, dhe mbi bazën e parimeve të sigurisë energjetike dhe vlerës ekonomike shtuar në ekonominë vendase, janë miratuar objektivat e mundshëm të politikës së BRE-ve:

I. Konsumi i burimeve të energjisë të rinovueshme në masën 38% në vitin 2020;

II. Diversifikimin e burimeve të rinovueshme në vend, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga era, dielli, biomasa dhe energjinë gjeotermale; Përdorimi i burimeve vendase të energjisë, në veçanti në zonat e largëta duke hapur vende pune dhe përmirësuar standardet e jetesës;

III. Rritja e kontributit të biokarburanteve dhe lëndëve djegëse të tjera nga burimet e rinovueshme me 10% në totalin e konsumit të karburantit në sektorin e transportit deri në vitin 2020

Rritja e përdorimit të teknologjive BRE është hap me rëndësi në përgjithësi, drejt një shoqërie më

të qëndrueshme, dhe në veçanti, sjell përfitime të mëdha për industrinë shqiptare.

Objektivi prej 38% nga BRE-ja është miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2012/04/MC-EnC.

Objektivi i përgjithshëm kombëtar

Si pikënisje në Objektivin Kombëtar për BRE do të jetë viti 2009 në të cilin KFBE-ja ka qenë 2,104 ktoe dhe përqindja e BRE-së në terma konsumi ka qenë 31.2%. Duke përdorur metodën e përcaktuar në direktivë, sipas teknologjive jepen të dhënat bazë për promovimin e BRE-së.

Energjia e rinovueshme për sektorin e transportit BRE-T: Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE-së prej 38% në vitin 2020 është e parashikuar konsumi në territorin e Shqipërisë të sasisë prej 3% të KFBE-së, ose ndryshe përzierjen në masën deri 10% në volumin të karburanteve të lëndëve djegëse të rinovueshme (FAME), që konsumohen në sektorin e transporteve. Kjo sasi është e barabartë me të paktën 75 ktoe FAME për sektorin e transportit në vitin 2020. Kjo sasi e pjesës së rinovueshme në biokarburante merr në konsideratë rritjen me 60 ktoe në vitin 2020 krahasuar me 2014-n.

Energjia e rinovueshme për sektorin e ngrohjes dhe ftohjes BRE-N&F: Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE-së prej 38% në vitin 2020 është e domosdoshme konsumi në territorin e Shqipërisë të sasisë prej 10% të KFBE-së që duhet të konsumohen në sektorin e ngrohjes dhe të ftohjes, BRE-N&F. Kjo sasi do të thotë një rritje shtesë të sasisë së nxehtësisë me të paktën 800 GWh/vit në vitin 2020 ose konsumin vjetor të BRE-N&F prej 279 ktoe nxehtësi nga biomasa drusore/industriale/mbetjet dhe pompat e nxehtësisë.

Energjia e rinovueshme për sektorin e energjisë elektrike BRE-E: Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE-së prej 38% në vitin 2020 është e domosdoshme konsumi në territorin e Shqipërisë të sasisë prej 29% të KFBE-së që duhet të konsumohen në sektorin e energjisë elektrike, BRE-E. Kjo sasi do të thotë një rritje të sasisë shtesë të konsumuar energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me të paktën 270 ktoe (3,140 GWh) deri në vitin 2020. Kjo do të thotë, gjithashtu, një rritje mesatare të gjeneruesve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme në masën 830 MW (20-35% faktor kapaciteti), të cilat propozohet të ndahen sipas tabelës përmbledhëse:

Tabela 1: Tabela përmbledhje e BRE-së për ngrohje/ftohjen, transportin dhe energjinë elektrike që do të shtohen pas vitit 2015 në konsumin final bruto të energjisë në Shqipëri deri në vitin 2020

	Teknologjitë shtesë të BRE-së 2015–2020	***Sasia*** *ktoe*	***Gjenerimi GWh***	***Instalimi MW***
1. BRE-E	**HECV** deri në 10 MW **(SHPP)**	200	2,326	750
	Eolike (Wind)	30	233	30
	Fotovoltaike (PV)	40	582	50
	Total 1	***270*** *ktoe*	***3,140***	***830***
	% në KFBE	**25%**		
2. BRE-N&F	***Biomasë***	52	800[th]	-
	Total 2	***52*** *ktoe*		
	% në KFBE	**10%**		
3. BRE-T	***Biokarburante FAME***	75		-
	Total 3	***75*** *ktoe*		
	% në KFBE	**3%**		
BER	**Total 1+2+3**	***397*** *ktoe* nga totali 1,017 ktoe		
	% në KFBE	**38%**		

Tabela ½: Përqindja e mbetur 2014-2020 për arritjen e objektivit kombëtar të BRE-ve

A	**Pjesa e BRE të konsumuara përkundrejt KFBE gjatë viteve 2009–2014**	**%**	**31.2%**
B	Objektivi i BRE-së që do të konsumohet në KFBE në vitin 2020	%	**38.0%**
C	Sasia e BRE-së të konsumuara mesatarisht në KFBE gjatë viteve 2009–2014	ktoe	**666.7**
D	KFBE për Shqipërinë gjatë viteve 2009–2014	ktoe	**2,281.5**
E	KFBE i pritshëm për Shqipërinë në vitin 2020 (me EE)	ktoe	**2,678.5**
F	Sasia vjetore e BRE-së, shtesë për arritjen e objektivit më 2020-n	ktoe	**397.0**
G	Sasia vjetore totale e BRE për t'u konsumuar në vitin 2020	ktoe	**1,017.2**

1. SITUATA E PËRGJITHSHME E BRE-ve NË SHQIPËRI

1.1 Hyrje dhe vështrim historik

Furnizimi me energji primare në Shqipëri është i dominuar nga nafta, hidrocentralet dhe biomasa. Sektori i energjisë në vend mbështetet kryesisht nga importet e energjisë, veçanërisht nga nënproduktet e naftës dhe importet e energjisë elektrike. Historikisht, nevojat e energjisë elektrike janë plotësuar pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet. Kapaciteti total i instaluar i energjisë në Shqipërisë arrin në 1.8 GW, i dominuar nga hidrocentralet. Burimet ujore janë burimet më të rëndësishme natyrore të Shqipërisë dhe potenciali hidroenergjetik i përgjithshëm është vlerësuar në 4.500 MW. Sot, vendi ka shfrytëzuar vetëm 35% të potencialit të hidrocentraleve. Hidrocentrale të vendosura dhe të lidhura në kaskadë mbi lumin Drin përfaqësojnë rreth 80% të prodhimit total të energjisë elektrike.

Ndryshimet në prodhim të energjisë elektrike mund t'i atribuohet të prodhimit të luhatshme nga hidrocentralet. Për më tepër, vendi vuan nga humbje të mëdha të transmetimit dhe shpërndarjes - si teknike dhe joteknike - të cilat u vlerësuan deri në 44.96% në vitin 2012, sipas ERE-s, dhe për shkak të masave të forta dhe aktive të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare janë ulur deri në 29% për gjashtë muajt e parë të 2015-s.

Duke qenë se kushtet hidrologjike ndryshojnë nga viti në vit, vendi është i detyruar të mbështetet në importin e energjisë elektrike në masë të madhe. Kërkesat në rritje të energjisë elektrike ka rritur edhe mbështetjen e Shqipërisë në importin e energjisë elektrike. Në veçanti, gjatë dekadës së parë (2001–2010), kërkesa finale të energjisë elektrike u rrit me një normë mesatare vjetore prej 4.8%. Në anën tjetër, kapaciteti gjenerues i energjisë elektrike, u rrit me një normë vjetore prej 0.6%. Vendi është transformuar nga një eksportues te një importues të energjisë elektrike. Për këtë arsye, zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese është një nga prioritetet kryesore të sektorit të politikave të energjisë në Shqipëri. Zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është planifikuar kryesisht përgjatë lumenjve Mat, Vjosa, Devolli dhe Bistrica. Përveç kësaj, qeveria shqiptare është duke u përqendruar në diversifikimin e furnizimit të saj të energjisë dhe promovimin e burimeve të tjera të rinovueshme të energjisë, të tilla si biomasa, energjia diellore dhe e erës.

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm të BRE-së. Potencialin i saj i energjisë diellore është vlerësuar në 1,500-1,700 kWh/m^2 në vit. Vendi ka, gjithashtu, potencial të pashfrytëzuar të energjisë së erës, veçanërisht përgjatë bregdetit Adriatik. Sipas Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, janë identifikuar një sërë zonash me potencial të lartë të energjisë së erës, me një shpejtësi mesatare vjetore të erës prej 6-8 m/s dhe densitet energjetik 250–600 W/m^2. Shqipëria ka gjithashtu potencial të konsiderueshëm biomasës nga mbetjet bujqësore, që vlerësohet rreth 2,300 GWh/vit. Nxehtësia nga burimet e rinovueshme, e cila aktualisht ofrohet nga përdorimi joefikas i druve të zjarrit, promovohet, kryesisht me futjen e sistemeve diellore për ngrohjen e ujit, biomasës industriale dhe biomasa bujqësore. Sa i përket sistemit të prodhimit të energjisë elektrike, pavarësisht se hidrocentralet, që është teknologjia kryesore RES, pritet të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme deri në vitin 2020, teknologjitë e tjera RES të tilla si: era, biomasa apo energjia diellore pritet të luajnë një rol të kufizuar, edhe pse ka potencial të konsiderueshëm.

Zhvillimet në konsumin final të energjisë tregojnë dominimin e nënprodukteve të naftës. Nga viti 1990 deri në vitin 2013 mund të vërehet një rënie e madhe në kontributin e lëndëve djegëse të ngurta, d.m.th., qymyrit dhe gazit

natyror. Në vitin 2013, sektori i transportit ishte konsumatori më i madh i energjisë, me rreth 40% të konsumit total final, ndjekur nga sektori rezidencial (27%), industria (17%), sektori i shërbimeve (9%) dhe në fund bujqësia (5%).

Shqipëria si një prej Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është e detyruar për të transpozuar dhe të jetë në përputhje me direktivën e BE-së 2009/28/EC "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe të amendojë, e më pas shfuqizojë direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC". Kjo edhe si kërkesë e ligjit nr. 138/2013, "Për burimet e rinovueshme të energjisë". Një nga kërkesat e ligjit dhe e kësaj Direktive është përgatitja dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (PKVER), i cili do të përcaktonte objektivat kombëtarë të energjive të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare e ka konsideruar promovimin e përdorimit të energjive të rinovueshme si një mjet të rëndësishëm të politikave të energjisë për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Edhe pse në fakt në Shqipëri mbi 95% e energjisë elektrike dhe 20–23% të burimeve totale parësore janë siguruar nga hidrocentralet, objektivat e politikës energjetike të Qeverisë Shqiptare janë për të rritur më tej përdorimin e BRE-së.

Në dekadën e fundit, në mbarë botën, pjesa më e madhe e debatit në lidhje me nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme është përqendruar në skemat e mbështetjes financiare dhe përmirësimin e kushteve të lidhjes në rrjet për energjinë elektrike të rinovueshme. Pa dyshim që, këto janë çështjet kryesore që do të vazhdojnë të mbeten në qendër të vëmendjes së politikëbërësve sot dhe në të ardhmen.

Shqipëria përbën një rast të veçantë, sepse prodhimi i energjisë elektrike në vend realizohet në pjesën më të madhe nga përdorimi i hidrocentraleve të mëdhenj dhe të mesëm. Po ashtu, rreth 10–13% e Totalit të Burimeve Primare të Energjisë (TBPE) në vend - përfshirë importet - sigurohet nga biomasa, në veçanti, nga drutë e zjarrit.

Nga ana tjetër Shqipëria kryen importe të konsiderueshme të energjisë elektrike, të cilat, në varësi të kushteve vjetore, ndryshojnë nga 30–60% e TBPE-së. Energjia e rinovueshme mund të jetë zgjidhja për uljen e kësaj varësie strategjike nga importet dhe përmirësimin jo vetëm të sigurisë së furnizimit me energji, por edhe të sigurisë makroekonomike dhe politike të vendit duke ulur deficitin e buxhetit të vendit.

Mbi bazën e këtyre fakte që ofrojnë kontekstin për rritjen e mundshme të rolit të BRE-ve në gjendjen e energjisë dhe ekonomisë aktuale në Shqipëri, dhe mbi bazën e parimeve të sigurisë energjetike dhe vlerës ekonomike shtuar në ekonominë vendase, janë miratuar objektivat e mundshëm të politikës së BRE-ve. Rritja e përdorimit të teknologjive BRE është një hap me rëndësi në përgjithësi, drejt një shoqërie më të qëndrueshme, dhe në veçanti, sjell përfitime të mëdha për industrinë shqiptare. Argumenti i vlerës së shtuar në ekonominë vendase do të duhet të përdoret në procesin e vendim-marrjes për skemat e reja mbështetëse ndaj BRE-ve. Mbështetja e instalimeve të BRE-ve mund të ofrojnë mundësi me vlerë për zhvillimin e zonave lokale relativisht të varfra.

1.2 Oferta dhe kërkesa për energji

Bazuar në Bilancin Kombëtar të Energjisë të vitit 2009, ku konsumi i përgjithshëm neto i burimeve primare të energjisë është 2100.93 ktoe, vetëm 449.82 ktoe janë prodhuar nga hidrocentralet, kontributi nga biomasa është 210 ktoe, energjia diellore është 6.65 ktoe dhe në total të gjitha BRE-të arrijnë 666.47 ktoe (e barabartë me 31.2% të konsumit final të energjisë bruto për vitin 2009). Ndërkohë, sipas bilancit më të fundit të energjisë për Shqipërinë lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) - për vitin 2013 - nga një konsum të përgjithshëm neto i burimeve primare të energjisë të 2345.90 ktoe vetëm 592.72 ktoe janë nga hidrocentralet, kontributi i biomasës është 201.50 ktoe, energjia diellore është 11,92 ktoe, iokarburantet 35 ktoe dhe në total të gjitha BRE arrijnë në 846.63 ktoe (të barabartë me 33.20% të konsumit final të energjisë bruto për vitin 2013).

Historikisht, Shqipëria ka përjetuar një rritje të madhe jonormale të konsumit të energjisë elektrike. Një pjesë e mirë e kësaj rritjeje është nxitur artificialisht nga nivelet jashtëzakonisht të larta të vjedhjes së energjisë elektrike, mos

pagesat e faturave të energjisë elektrike dhe në disa raste nga tarifat që janë nën kosto. Konsumi i lartë i energjisë elektrike në sektorin e banesave, veçanërisht për ngrohjen e banesave, ka bërë që një burim i vyer të largohet nga përdorimi tregtar dhe industrial që ndryshe mund të krijonte vende pune dhe të kontribuonte në rritjen ekonomike. Masat e marra së fundmi nga Qeveria Shqiptare për parandalimin e mospagesës së energjisë elektrike (e cila është reduktuar nga 52% për vitin 2013 në përafërsisht 29,8% për gjashtë muajt e parë të vitit 2015) kanë hequr një nga pengesat kryesore për futjen e BRE-së dhe masave të eficiencës së energjisë në të dy anët e sistemit energjetik shqiptar kërkesës dhe furnizimit.

2. OBJEKTIVI PËR BRE-të NË SHQIPËRI

2.1 Objektivi kombëtar për BRE-të

Qëllimi kryesor i direktivës së re të BE-së për energjinë e rinovueshme (direktiva 2009/28) është caktimi i objektivave detyrues për përdorimin e energjisë nga burime të rinovueshme. Direktiva përcakton një objektiv të përgjithshëm prej 20% për BE-në dhe objektiva individualë për shtetet anëtare bazuar në nivelin e tyre aktual të energjisë së rinovueshme dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të tyre. Brenda objektivit të përgjithshëm për BRE-të, ekziston një detyrim specifik që nga burimet e rinovueshme të sigurohet 10% e energjisë që përdoret në sektorin e transportit.

E njëjta metodologji, vetëm duke marrë një tjetër vit bazë (2009 në vend të vitit 2005), është aplikuar për të llogaritur objektivat individualë të secilës Palë Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, përkatësisht edhe për Shqipërinë. Brenda objektivit të përgjithshëm të BRE-së, për secilën Palë Kontraktuese dhe, konkretisht, për Shqipërinë, ekziston një Objektiv prej 38% dhe një detyrim specifik brenda këtij Objektivi për të përmbushur 10% të energjisë së përdorur në transport nga burimet e rinovueshme.

Objektivi prej 38% nga BRE-ja është adoptuar në vendimin e Këshillit të Ministrave 2012/04/MC-EnC kur direktiva e BRE-së u miratua për Komunitetin e Energjisë.

Në tabelën 1 më poshtë janë paraqitur shifrat e parashikuara të konsumit final bruto të energjisë të të gjitha llojeve të energjisë (nga të dyja burimet e rinovueshme dhe konvencionale), në periudhën deri në vitin 2020. Këto llogaritje kanë marrë gjithashtu parasysh efektet e pritshme të masave për eficiencë energjie dhe kursim që do të futen gjatë periudhës. Nën titullin "skenar reference" është paraqitur një skenar që merr parasysh vetëm masa të eficiencës së energjisë dhe kursimeve. Është shumë e rëndësishme të theksohet, siç u përmend më lart se këto kursime kanë qenë pothuajse të papërfillshme, pasi PKVEE u miratua zyrtarisht në shtator 2011. Nën titullin "Skenar shtesë për eficiencë energjie" është paraqitur një skenar që merr parasysh të gjitha masat që do të miratohen me qëllimin kryesor për të arritur objektivin PKVEE prej 9% në vitin 2018. Sipas nenit 5 (6) të direktivës 2009/28 / EC, për qëllime të matjes së pajtueshmërisë me objektivin indikativ 2020 dhe trajektoren e përkohshme, shuma e energjisë së konsumuar në aviacion duhet të konsiderohet të jetë jo më shumë se 6,18% e konsumit të përgjithshëm të energjisë së Palës Kontraktuese. Konsumi i energjisë në aviacion për Shqipërinë gjatë viteve 2009 dhe 2010 ka qenë respektivisht 0.97% dhe 1.07% të konsumit të përgjithshëm bruto të energjisë finale, kështu që nuk ka nevojë për rregullim duke qenë se këto vlera janë më të ulëta se 6.18% (në vijim tabela 1).

Rrymat e energjisë në bilancin kombëtar.	2009	2010		2011		2012		2013		2014	
	Viti bazë	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE
1) ngrohje/ftohje[1]	511.89	587.66	587.66	610.56	610.56	529.20	526.69	679.66	669.93	649.34	630.67
2) energji elektrike[2]	619.20	632.96	632.96	634.59	634.59	649.47	646.38	662.29	652.80	670.23	650.97
3) transport[3]	754.44	759.44	759.44	767.00	767.00	736.73	733.23	801.86	790.37	788.80	766.13
4) Konsumi Final Bruto i Energjisë [4]	***1,885.53***	***1,980.06***	***1,980.06***	***2,012.15***	***2,012.15***	***1,915.41***	***1,906.30***	***2,143.81***	***2,113.10***	***2,108.37***	***2,047.77***

Rrymat e energjisë në bilancin kombëtar	2015		2016		2017		2018		2019		2020	
	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE	Skenar Reference	Skenar me EE
1) ngrohje/ftohje	719.17	687.40	786.48	739.56	822.43	763.78	875.12	799.04	916.68	832.45	949.02	857.09
2) energji elektrike	687.50	657.13	704.80	662.75	722.10	670.60	739.40	675.12	756.70	687.17	774.00	699.02
3) transport	828.30	791.71	842.00	791.77	869.70	807.67	884.10	807.24	913.20	829.29	955.26	862.72
4) Konsumi Final Bruto i Energjisë	***2,234.97***	***2,136.24***	***2,333.28***	***2,194.08***	***2,414.23***	***2,242.05***	***2,498.62***	***2,281.39***	***2,586.58***	***2,348.90***	***2,678.28***	***2,418.82***

Tabela 1: Konsumi përfundimtar bruto i parashikuar në Shqipëri për ngrohje-ftohje, energji elektrike dhe transporti deri në vitin 2020, duke marrë parasysh efektet e eficiencës së energjisë dhe masat për kursimin e energjisë [5] 2009–2020 (ktoe)

[1] Është konsumi përfundimtar i energjisë për të gjitha komoditetet energjetike përveç energjisë elektrike për qëllimi të tjera përveç transportit, (EU/OJ L304 of 14.11.2008).

[2] Konsumi bruto i energjisë elektrike merret nga prodhimi i brendshëm bruto i energjisë elektrike, duke përfshirë autoprodhimin, plus importin, minus eksportin.

[3] Konsumi në transport përcaktohet në nenin 3/4/a të direktivës 2009/28/EC. Energjia elektrike nga BRE-ja në transportin rrugor për këtë parametër duhet të shumëzohet me faktorin 2,5, siç edhe përshkruhet në nenin 3/4/c të Direktivës 2009/28/EC.

[4] Sipas përcaktimit në nenin 2/f të direktivës 2009/28/EC. Kjo përfshin konsumin përfundimtar të energjisë plus humbjet në rrjet dhe përdorimin për nevoja të brendshme të nxehtësisë dhe energjisë elektrike në impiantet e prodhimit të energjisë elektrike dhe nxehtësisë.

[5] Këto parashikime mbi eficiencën e energjisë dhe kursimet e energjisë janë në përputhje PKVEE.

3. PKVER PËR PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVIT PËR BRE-TË NË SHQIPËRI

3.1 Përmbledhje e politikës për energjinë e rinovueshme në Shqipëri

Vitet e fundit, Qeveria Shqiptare është përpjekur të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për energjinë. Në këtë drejtim, ajo ka bërë përpjekje të shumta për të ndryshuar ligjet ekzistuese dhe për të nxitur një klimë më konkurruese për produktet e energjisë në përgjithësi dhe BRE-të në veçanti. Së bashku me një sërë përmirësimesh ligjore, janë miratuar katër ligje kyç: ligji për koncesionet, për sektorin e energjisë (miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në maj 2015), për energjitë e rinovueshme (aktualisht është në proces rishikimi), për eficiencën e energjisë në ndërtesa (projekt ligji u miratua vitin e shkuar, është përgatitur në një linjë me direktivën e BE-së). Qëllimi i këtyre ligjeve është liberalizimi i tregut të energjisë elektrike, rritja e konkurrencës, nxitja e zhvillimit të burimeve të rinovueshme dhe tërheqja e investimeve të huaja në sektorin e energjisë dhe garantimi i një reforme të qëndrueshme në fushën e energjisë. Për sa i përket zhvillimit të projekteve për energjinë e rinovueshme, është përmirësuar procesi i licencimit. Megjithatë, në disa faza ende ekzistojnë vështirësi ose paqartësi. Ngritja e një zyre me një ndalesë (*one-stop shop*) për licencat është një hap i madh përpara që ka bërë Qeveria Shqiptare qysh prej vitit 2009, por për sa i përket funksionimit të saj, do të duhet ende të përmirësohet.

3.2 Objektivat tregues për energjitë e rinovueshme

Sipas nenit 4/1 të direktivës 2009/28/EC, Palëve kontraktuese në traktatin e KE-së u kërkohet që objektivat e tyre tregues për pjesën e energjisë më burime të rinovueshme për vitin 2020 të jenë si më poshtë:

- ngrohja dhe ftohja;
- energjia elektrike; dhe
- transporti.

Llogaritja e objektivave specifikë të këtyre tre sektorëve, e konvertuar në vlerat energjetike të parashikuara (ktoe) duhet të jetë të paktën po aq e madhe sa edhe sasia e parashikuar e energjisë nga burime të rinovueshme që korrespondon me objektivin e përgjithshëm të BRE-ve për Shqipërinë për 2020, siç raportohet në qelizën e fundit të tabelës 6b). Për më tepër, objektivi specifik për transportin duhet të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 3(4) të Direktivës 2009/28/EC për një nivel prej 10% të pjesës që zënë energjitë e rinovueshme në sektorin e transportit. Nga produktet e naftës, vetëm benzina dhe nafta diesel llogariten për emëruesin. Kjo do të thotë që vajguri/karburanti "Jet" që përdoret në aviacion, si dhe karburanti që përdoret për anijet nuk llogariten. Biokarburantet nga plehrat, mbetjet, materiali celuloze joushqimor dhe materiali linjo-celulozë llogariten dyfish në drejtim të numëruesit; Objektiv kombëtar i përgjithshëm për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë më 2009-n dhe 2020-n (të dhëna të marra nga shtojca I, pjesa A e direktivës 2009/28 / EC) është paraqitur në tabelën 2.

A	**Pjesa e BRE të konsumuara përkundrejt KFBE gjatë viteve 2009–2014**	**%**	**31.2%**
B	Objektivi i BRE-së që do të konsumohet në KFBE në vitin 2020	%	**38.0%**
C	Sasia e BRE-së të konsumuara mesatarisht në KFBE gjatë viteve 2009–2014	ktoe	**666.7**
D	KFBE për Shqipërinë gjatë viteve 2009–2014	ktoe	**2,281.5**
E	KFBE i pritshëm për Shqipërinë në vitin 2020 (me EE)	ktoe	**2,678.5**
F	Sasia vjetore e BRE-së, shtesë për arritjen e objektivit në 2020-n	ktoe	**397.0**
G	Sasia vjetore totale e BRE-së për t'u konsumuar në vitin 2020	ktoe	**1,017.2**

Tabela 2: Objektivi i përgjithshëm kombëtar

Tabelat 2a dhe 2b janë plotësuar për të dy objektivat specifikë dhe trajektoren e vlerësuar të energjisë nga burimet e rinovueshme për ngrohjen, ftohjen dhe kondicionimin e ajrit, energjinë elektrike dhe transportin. Llogaritjet e tabelës 2a dhe 2b ofrojnë udhëzime për përgatitjen e tabelat 3a dhe 3b, bazuar në metodologjinë e propozuar nga Sekretariati për Energjinë.



Figura 1: Objektivat tregues dhe trajektorja e parashikuar për energjinë nga burime të rinovueshme për ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport (%)



Figura 2: Trajektorja e parashikuar për energjinë nga burime të rinovueshme për ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport (ktoe)



Figura 3: Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme për ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport (%)



Figura 4: Objektivat tregues të BRE-ve që përdoren në transport sipas kërkesave të ligjit për biokarburant dhe objektivat e BRE-ve në transport (%)

Teknologjitë BRE	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-Ngrohje dhe Ftohje	11.55	12.12	10.87	11.51	10.52	10.80	10.97	11.06	11.15	11.37	11.42	11.60
BRE-Energjia elektrike	18.16	19.18	18.51	20.98	21.05	19.27	22.69	23.83	24.25	24.80	26.00	26.21
BRE-Transporti (%)	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	1.63%	1.66%	1.66%	1.83%	2.16%	2.60%	3.09%	3.65%
Objektivi i kombëtar	**29.71**	**31.31**	**29.38**	**32.49**	**33.20**	**31.73**	**35.32**	**36.73**	**37.55**	**38.76**	**40.48**	**41.43**
BRE-T (%) vs	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	4.36%	4.44%	4.40%	5.23%	6.10%	7.25%	8.55%	10.00

Tabela 2a: Objektivi specifik për 2020 dhe trajektorja e vlerësuar e energjisë nga BRE-të në ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport (shifrat janë për skenarin me zbatimin e PKVEE-së)

Teknologjitë BRE	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-Ngrohje dhe	11.5	12.1	10.8	11.5	10.5	10.8	10.6	10.5	10.5	10.6	10.6	10.8
BRE-Energjia elektrike	18.1	19.1	18.5	20.9	21.0	19.1	21.6	22.4	22.5	22.6	23.6	23.6
BRE-Transporti (%)	0.00	0.00	0.00	0.00	1.63	1.66	1.66	1.83	2.16	2.60	3.09	3.65
Objektivi kombëtar i	**29.71**	**31.31**	**29.3**	**32.4**	**33.2**	**31.63**	**33.9**	**34.81**	**35.2**	**35.8**	**37.31**	**38.0**
BRE-T (%) vs	0.00	0.00	0.00	0.00	4.36	4.44	4.40	5.23	6.10	7.25	8.55	10.0

Tabela 2b: Objektivi specifik dhe trajektorja e vlerësuar e energjisë nga BRE-të në ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport (shifrat janë për skenarin pa zbatimin e PKVEE-së)

Konsumi final buto i parashikuar:	200	201	2011	201	201	201	201	201	201	201	201	202
(A) i BRE për ngrohje dhe ftohje	217.	240.	218.	220.	225.	227.	237.	246.	253.	264.	273.	286.
(B) i energjisë elektrike nga BRE	342.	379.	372.	401.	451.	404.	484.	522.	543.	565.	610.	633.
(C) nga BRE në transport	0.00	0.00	0.00	0.00	35.0	35.0	36.6	42.4	51.5	63.8	78.4	95.5
Konsumi i parashikuar i BRE	***560.***	***619.***	***591.***	***622.***	***711.***	***666.***	***758.***	***811.***	***849.***	***893.***	***962.***	***1017***

Tabela 3a: Tabela e llogaritjes finale për pjesën që zë energjia e rinovueshme në 3 sektorët bazë, ngrohje-ftohje, energji elektrike dhe transport (ktoe)

4. MASAT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKË NË SECILIN SEKTOR

4.1 Përmbledhje e politikave dhe masave për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash për përfshirjen në politikën e saj për energjinë të kërkesave të direktivave të BE-së për rregullat e përbashkëta për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë dhe nxitjen e prodhimit dhe të konsumit të energjisë nga burimet e rinovueshme. Në mënyrë që të përmbushë detyrimet e saj ndërkombëtare dhe të arrijë sipas detyrimit ligjor objektivin prej 38% energji të rinovueshme në konsumin final bruto deri në 2020, Shqipëria po ndërmerr një rishikim të instrumenteve të saj mbështetëse të prodhimit të energjisë së rinovueshme. Skema e përshkruar më poshtë do të lejojë Shqipërinë të ndjekë objektivat e saj të BRE-ve, respektivisht duke ruajtur dhe rritur sigurinë në furnizim duke përfshirë larmishmëri të teknologjive të gjenerimit të BRE-E.

4.1.1 Skemat mbështetëse aktuale për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme

Aktualisht, ka një tarifë promovuese vetëm për HEC-et e vogla me fuqi të instaluar më të ulët se 15 MW dhe tarifa përllogaritet sipas çmimit mesatar vjetor të energjisë elektrike në Bursën e Energjisë në Hungari (HUPX) të përcaktuar në euro cent /kWh x 1.24 x kursin mesatar të këmbimit euro/lek për vitin e mëparshëm. Kjo metodë është bazuar në një formulë të thjeshtë, dhe, për më tepër, merr parasysh çmimin e importit të energjisë elektrike dhe e lidh atë me tarifën për të shmangur kostot që rendojnë te konsumatori. Formula e sipërpërmendur, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, do të jetë për vitet 2015–2016 për HECV-ve ekzistuese.

Sistemi i ri i tarifës promovuese do të paraqitet me anë të adoptimit të ligjit të ri për BRE-të, i cili është duke u përgatitur, duke pasur parasysh se nivelet e tarifave do të duhet të marrin në shqyrtim llojin e teknologjisë dhe eficiencën e pajisjeve gjeneruese. Gjithashtu, ligji i ri për BRE-të do të ofrojë stimuj të tjerë, si p.sh.:

- Përcaktimi i një objektivi kombëtar për BRE-të në totalin e konsumit përfundimtar të energjisë;
- Detyrimin e kompanive të transmetimit ose të shpërndarjes për të lidhur impiante të reja të BRE-së në rrjetet e tyre; pagesa vetëm e kostove direkt të lidhjes në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Njohjen e marrëveshjeve ekzistuese të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të dhe detyrimin e Operatorit për të blerë energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e vogla.

Si rezultat i këtyre masave është rritur ndjeshëm interesi në burimet e rinovueshme sidomos, hidrocentrale të vegjël si teknologjia me "tradicionale" dhe që njihet më mirë.

Një zhvillim të konsiderueshëm vitet e fundit kanë marrë sistemet termike të paneleve diellore për përgatitjen e ujit të ngrohtë, për të cilat ligji aktual parashikon masa lehtësuese në sistemin e taksave.

4.1.2 Skemat mbështetëse promovuese të BRE-E në tregun e energjisë

Aktualisht në ndryshimet që propozohen në ligjin nr. 138/2013 synohet të ristrukturohet suporti shtetëror për energjitë e rinovueshme dhe ta zëvendësojë skemën e tarifës *feed*-in me një sistem të bazuar në Kontrata për Diferencën (CfD). Gjithsesi, në legjislacionin që po amendohet, skema e tarifës *feed*-in parashikohet të mbetet në fuqi vetëm për të mbështetur energjinë e rinovueshme në shkallë të vogël deri në kapacitet 2 MW të instaluar për njësi gjeneruese.

Prodhuesit e energjisë së rinovueshme, aktualisht me marrëveshje blerje-energjie të përfunduara përpara hyrjes në fuqi të ligjit që po amendohet do të kenë një tarifë *feed*-in fikse për pjesën e mbetur të kontratës. Kjo situate nuk përjashton të drejtën e këtyre prodhuesve për të kaluar në një skemë suporti Kontrata për Diferencën.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", po hartohet modeli i ri i tregut të energjisë elektrike, i cili, ndër të tjera, parashikon tregtimin e energjisë elektrike nga burimet e energjisë së rinovueshme, në tregun e ditës në avancë në momentin e krijimit të Bursës se Energjisë Elektrike Shqiptare.

Kriteret e ligjore të gjenerimit me BRE-E do të vendosen nga ERE. Vetëm gjenerimi që plotëson kushtet ligjore mund të mbështetet sipas një CfD. Teknologjitë e rinovueshme që do të jenë të pranueshme për suport sipas skemës CfD, janë të listuara më poshtë:

- Shndërrimi i biomasës;

- Era në kufijtë tokësorë;
- Fotovoltaikët diellorë;
- Hidroelektriciteti;
- Energjia nga mbetjet me CHP;
- Gazi nga landfillet;
- Gazi nga kanalizimet e ujërave të ndotura urbane.

Ministria do të rishikojë listën çdo vit dhe mund të propozojë një ndryshim të listës të Këshillit të Ministrave në rast se një tjetër teknologji do të konsiderohet e konsoliduar.

Gjithashtu, në ndryshimet ligjore do të parashikohet hartimi i metodologjive të përcaktimit të çmimeve fikse, të cilat do të llogariten në mënyrë që të mbështetin prodhimin e një sasie të konsiderueshme të energjive të rinovueshme, ekonomikisht të pranueshme nga tregu.

4.2 Skemat mbështetëse për promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme në ngrohje dhe ftohje (BRE-N&F)

Qeveria është duke planifikuar për të futur disa skema mbështetëse për përdorimin e energjive të rinovueshme për qëllime ngrohje dhe ftohje. Qeveria po rishikon ligjin e BRE-së, me qëllim për të futur një dispozitë, e cila do të mundësonte financimin e projekteve për ngrohje dhe ftohje që përdorin kryesisht biomasë, në sektorin e bujqësisë. Financimi pritet të bëhet nëpërmjet granteve nga fondi BRE që të themelohet nga Qeveria. Grantet do të arrijnë deri në 30% të kostos totale të investimit të projektit. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave do të identifikojë projektet më të përshtatshme në bazë të realizueshmërisë së tyre financiare dhe ndikimin në përmbushjen e objektivit të BRE-së në sektorin e bujqësisë

4.3 Skemat mbështetëse për promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme në transport (BRE-T)

Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", neni 8(4), parashikon që duke filluar nga viti 2010, sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme që përdoren për transport nuk do të jetë më pak se 3% e totalit të lëndëve djegëse të tregtuara në treg, ndërkohë që duke filluar nga viti 2015 dhe, më tej, nuk do të jetë më pak se 10%.

Drafti ligji i ri për biokarburantet do të mbajë të njëjtë objektivin prej 10% për t'u përputhur me Direktivën e BE-së 2009/28 / EC. Legjislacioni nuk përmban asnjë objektiv specifik për llojet e ndryshme të teknologjive.

Bazuar në pikën 2 të nenit 8 të ligjit nr. 9876, datë 14.2.2008, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për sektorin e transportit dhe të ministrit përgjegjës për sektorin e hidrokarbureve/energjisë, përcakton sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit. Megjithatë, asnjë përcaktim i tillë nuk është bërë nga asnjë ministër që nga hyrja në fuqi e ligjit.

Detyrimi i shpjeguar më lart është vendosur për kompanitë e furnizimit me shumicë të nënprodukteve të naftës, të cilat kanë licencë tregtimi.

Ligji nuk parashikon sanksione ose masa ndëshkuese për mospërmbushjen e objektivit. Megjithatë, personat që i nënshtrohen këtij detyrimi, të cilët licencohen nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, mund të ndëshkohen nga kjo e fundit për mospërmbushjen e kërkesave të legjislacionit parësor dhe dytësor në fuqi që rregullon veprimtaritë për lëndët djegëse të rinovueshme të përdorura për qëllime transporti.

Përveç kësaj, po i njëjti ligj parashikon vendosjen e një gjobe për tregtarët me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës që nuk publikojnë në një vend të dukshëm në vendet/pikat e tyre të shitjes një shënim që tregon biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse të rinovueshme dhe naftën dhe benzinën, të përzier përkatësisht me biodizelin dhe bioetanolin në masën 5%.

Nuk është ngritur asnjë mekanizëm specifik për mbikëqyrjen e përmbushjes së objektivit. Ndonëse ligji për biokarburantet nuk shprehet për këtë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të nënprodukteve të naftës, ka autoritetin që të mbikëqyrë përmbushjen e objektivave të përcaktuar nga ligji.

Mbështetja financiare mund të klasifikohet në

mënyra të ndryshme. Shembuj të tillë janë: mbështetja financiare për investimin, grantet kapitale, huat me interes të ulët, përjashtimi nga taksat ose reduktimi i tyre, rimbursimi i taksave, skemat e tenderimit, detyrimet për energjitë e rinovueshme me ose pa certifikata të gjelbra (certifikata të gjelbra të tregtueshme), tarifat promovuese (*feed*-in), shpërblimet promovuese, skemat vullnetare

Mbështetja financiare për biokarburantet e përdorura për transport ofrohet nëpërmjet përjashtimit nga taksat. Sipas nenit 10 të ligjit për biokarburantet, duke filluar nga periudha e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe deri në vitin 2018, taksa e akcizës për këto produkte do të jetë zero.

Përveç kësaj, ligji ka një përjashtim tjetër i cili ishte në fuqi deri në vitin 2012, përjashtimi nga taksat doganore dhe TVSH-ja për të gjitha makineritë, materialet dhe pajisjet e nevojshme dhe pjesët e objekteve të përdorura për prodhimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera të djegshme të rinovueshme, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- pajisjet dhe makineritë që shndërrojnë plehun organik në përmirësues organik të tokës, i cili mund të përdoret për kultivimin e bimëve për qëllim energjetik;
- pajisjet, materialet dhe makineritë bujqësore që do të përdoren nga fermerët vendorë për kultivimin e bimëve për qëllim energjetik;
- pajisjet dhe makineritë teknologjike, kryesore dhe ndihmëse, të impianteve të prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përjashtohen nga taksat doganore dhe nga TVSH-ja për periudhën e parë deri në fund të vitit 2012.

Organet zbatuese të kësaj skeme janë Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave, së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Nuk është bërë asnjë vlerësim se cilat do të ishin ndikimet e pritshme lidhur me prodhimin e energjisë. Megjithatë, vitin e kaluar u vu në punë një impiant për prodhimin e biokarburantit në zonën industriale të Porto Romanos në Durrës, me kapacitet prodhimi rreth 100 000 tonë në vit. Ulja e taksave nuk kushtëzohet nga ndonjë kriter për eficiencën e energjisë.

Kjo është një masë mbështetëse është futur që prej vitit 2008. Baza ligjore e kësaj mase është ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport". Skema mbështetëse është funksionale që prej vitit 2008.

Data e fillimit të përjashtimit nga taksat (TVSH-ja dhe taksat doganore) për pajisjet dhe makineritë e fermerëve që prodhojnë lëndën e parë për prodhimin e biokarburantit dhe që përdoren për ndërtimin e impiantit të prodhimit të biokarburantit ishte data 14 mars 2008, ndërkohë që data e fundit ishte 31 dhjetor 2012.

Data e fillimit të përjashtimit nga taksa e akcizës e biokarburanteve të prodhuara ishte 14 mars 2008, ndërsa data e fundit është 31 dhjetor 2018. Nuk është parashikuar ndonjë madhësi maksimale ose minimale sistemi për prodhuesit e biokarburanteve që të përfitojnë nga përjashtimi nga taksat siç parashikohet nga ligji. Aktualisht në Shqipëri aplikohet vetëm një masë mbështetëse për prodhuesit e biokarburantit, ajo e përjashtimit nga taksat. Për biokarburantet në Shqipëri nuk aplikohet asnjë skemë rajonale ose lokale.

Skema ofron përjashtimin nga taksat (TVSH-ja dhe taksat doganore) për makineritë dhe pajisjet që përdoren për ndërtimin e një impianti për prodhimin e biokarburanteve. Nga kjo skemë përfiton kushdo që merr leje për ndërtimin e një impianti për prodhimin e biokarburanteve. Skema nuk përfshin specifikime lidhur me teknologjinë e përdorur për prodhimin e biokarburanteve për të përfituar nga kjo skemë. TVSH-ja rimbursohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, ndërkohë që përjashtimi nga taksat doganore aplikohet në momentin kur makineritë dhe pajisjet hyjnë në kufirin e Shqipërisë. Siç përmendet më lart, pavarësisht se ligji kërkon që Këshilli i Ministrave, pas propozimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për transportin, përcakton objektivin (përqindjen) minimal të biokarburanteve që do të përdoren brenda një viti në sektorin e transportit, asnjë detyrim i tillë vjetor nuk është përcaktuar. Siç përmendet më lart, ligji nuk bën dallime për mbështetjen sipas llojeve të karburantit dhe teknologjive. Në legjislacionin ekzistues nuk parashikohet asnjë mbështetje specifike për biokarburantet që plotësojnë kriteret e nenit 21(2) të Direktivës 2009/28/EC.

4.3.1 Masat specifike për promovimin e përdorimit të energjisë nga biomasa

Në shumë shtete anëtare, burimi i energjisë së biomasës ka një rol të rëndësishëm si energji primare për të mbuluar nevojat energjetike në të tre sektorët: ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport. Strategjia kombëtare për biomasën, e përgatitur tashmë në shumë shtete anëtare, është thelbësore për të planifikuar rolin dhe ndërthurjen e përdorimeve midis përdorimeve fundore të energjisë dhe ndërthurjes me sektorët e tjerë joenergjetikë. Për këtë arsye, edhe Shqipëria e ka vlerësuar potencialin e brendshëm të biomasës për ta përdorur atë me më eficiencën në sektorë të ndryshëm. Masat mbështetëse do të përcaktohen me rishikimin e ligjit për BRE-të.

1.1.1.1.1 Furnizimi me biomasë: në vend dhe nga jashtë

Biomasa është një nga burimet më të përdorura të energjisë në Shqipëri – kryesisht në formën e druve të zjarrit, e kombinuar në disa raste me shumë me shkurre dhe mbetje të bimëve nga sektori i bujqësisë. Konsumi i druve të zjarrit është ulur rreth tre deri në katër herë më shumë gjatë periudhës 1990–2002. Pas këtij viti, konsumi i druve të zjarrit është rritur pak në vitet e fundit si rezultat i rritjes së çmimeve të lëndëve të tjera djegëse dhe të energjisë elektrike. Lëndët djegëse të përpunuara të drurit - ashklat e drurit, paletat dhe briketat - nuk janë shumë të përdorura për shkak të çmimit të tyre të lartë dhe sistemit të pazhvilluar të furnizimit.

Kryesisht përdoren pjesët e mbetura nga rëniet e pemëve dhe drurë të cilësisë së dobët. Mbetjet e biomasës nga bujqësia nuk përdoret në masë të gjerë dhe zakonisht shkatërrohet në vend. Përdorimi i biogazit është i pazhvilluar, pavarësisht burimeve të disponueshme. Duhet të mbahet parasysh se shumica e pajisjeve ngrohëse që përdoren - sobat dhe oxhaqet - janë të vjetra dhe joefikase, me humbje nxehtësie që shkojnë deri në 40–50%. Ngrohja me kaldaja me eficiencë të lartë për sistemet lokale është e pazhvilluar. Vlerësimet e strategjisë së përditësuar të energjisë tregojnë një potencial të konsiderueshëm në nxjerrjen dhe shfrytëzimin e biomasës në Shqipëri nga pylltaria, bujqësia dhe bagëtia (për prodhimin e biogazit).

Biomasa mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike vetëm në centralet e bashkë-gjeneruese (CHP), veçanërisht në ato që punojnë me tallash druri nga industritë e ndryshme përpunuese të drurit. Përdorimi i saj në centralet elektrike të llojit me kondensim konsiderohet si i pafavorshëm nga pikëpamja mjedisore, ekonomike dhe teknike. Nga tabela 6 më poshtë, është e qartë se informacioni rreth sasive të disponueshme të biomasës është i pamjaftueshëm. Padyshim, autoritetet shtetërore duhet të bëjnë më shumë përpjekje për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi informimi lidhur me burimet e biomasës, i cili shërben për të kanalizuar informacionet në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Sektori i origjinës	Sasia e burimeve të brendshme	Importe		Eksporte	Sasia neto (ktoe)	Prodhimi i energjisë (ktoe)
		BE (ktoe)	Jo-BE (ktoe)	BE/jo-BE (ktoe)		
Biomasa nga pyjet:	Nga të cilat:	0	0	0	0	**210.00**
	1. Furnizimi direkt me biomasë drusore nga pyjet dhe nga tokat e tjera të pyllëzuara për prodhimin e energjisë	0	0	0	0	**210.00**
	Opsionale – nëse disponohet informacion, mund të detajoni më tej sasinë e lëndës së parë që i përket kësaj kategorie:	0	0	0	0	
	Drutë e prerë	0	0	0	0	**180.00**
	mbetjet nga drutë e prerë (majat, degët, lëvoret, rrënjët)	0	0	0	0	**20.00**
	mbetjet nga menaxhimi i peizazheve (biomasë drusore nga parqet, kopshtet, rreshtat me pemë, shkurret)	0	0	0	0	**10.00**
	të tjera (ju lutemi specifikoni)	0	0	0	0	**0.00**
	furnizimi indirekt me biomasë drusore për prodhimin e energjisë	0	0	0	0	**0**
	Opcionale - nëse disponohet informacion, mund të detajoni më tej:	0	0	0	0	**0**
	a) Mbetjet nga repartet e sharrave, industria e	0	0	0	0	**0**

	përpunimit të drurit, industria e mobilieve (lëvoret, tallashi)					
	b) Nënproduktet e industrisë së përpunimit të brumit të letrës dhe të letrës ("lëngu i zi", rrëshira e lëngshme)	0	0	0	0	**0**
	c) Drutë e zjarrit të përpunuara	0	0	0	0	**0**
	drutë e ricikluara pas konsumit (druri i ricikluar për prodhim energjie, druri nga mbeturinat familjare)	0	0	0	0	**0**
	të tjera (ju lutemi specifikoni)	0	0	0	0	**0**

Tabela 6: Furnizimi me biomasë në vitin 2009 (me të dhënat më të fundit të disponueshme)

Tabelat 7a dhe 7b japin kontributin e vlerësuar të përdorimit të energjisë nga biomasa në vitin 2015 dhe 2020.

Sektori i origjinës		2015		2020	
		Sasia e pritshme e burimeve të brendshme (m^3)	Prodhimi kryesor i energjisë (ktoe)	Sasia e pritshme e burimeve të brendshme (m^3)	Prodhimi kryesor i energjisë (ktoe)
A) Biomasa nga pyjet:	1. Furnizimi direkt me biomasë drusore nga pyjet dhe nga tokat e tjera të pyllëzuara	1,119,010	2316.28	923,112	2469.78
	2. Furnizimi indirekt me biomasë drusore për prodhimin e energjisë	156,250		173,307	
B) Biomasa nga bujqësia dhe peshkimi:	1. Kultura bujqësore energjetike dhe produkte peshkimi të furnizuara direkt	145,000		574,286	
	2. Nënproduktet bujqësore/mbetjet e përpunuara dhe nënproduktet e peshkimit	-		-	
C) Biomasa nga mbetjet:	1. Pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta urbane, përfshirë mbetjet biologjike dhe gazi i landfilleve të grumbullimit të mbeturinave	-		61,429	
	2. Pjesa e biodegradueshme e mbetjeve industriale (përfshirë letrat, kartonin, paletat)	-		235,286	
	3. Llumi i kanalizimeve	-		-	

Tabela 7a: Furnizimi i brendshëm i përllogaritur me biomasë në 2015 dhe 2020

Përveç informacionit të dhënë më lart, në tabelën 7b tregohet se aktualisht nuk ka plane për përdorimin e tokës bujqësore për prodhimin e kulturave bujqësore energjetike.

Përdorimi i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave bujqësore për energji	Sipërfaqja (ha)
Toka e përdorur për pemët me cikël të shpejtë rritjeje (shelgje, plepa)	zero
Toka e përdorur për kultura të tjera bujqësore energjike, si p.sh., barërat (Phalaris arundinacea, Panicum virgatum, Miscanthus), sorgum	zero

Tabela 7b: Përdorimi aktual i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave bujqësore energjetike në vitin 2009 (me të dhënat më të fundit në dispozicion)

4.3.2 Masat për rritjen e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë në konsideratë përdoruesit e tjerë të biomasës (bujqësinë dhe sektorët e tjerë që bazohen te pyjet)

Roli i biomasës do të rritet shumë pak në terma absolutë, siç tregohet më lart, por në të njëjtën kohë kontributi i saj relativ do të zvogëlohet. Janë parashikuar masa në dy drejtime:

- Ulja e lehtë e përqindjes së biomasës në konsumin final të energjisë;
- Ulja e lehtë e sasisë së ngrohjes së prodhuar nga shfrytëzimi i biomasës.

Përdorimi i biomasës ka qenë i qëndrueshëm përgjatë tri viteve të fundit për arsyet e mëposhtme:

- hyrja e ngadaltë e instalimeve të përmirësuara që përdoren për shfrytëzimin e biomasës në nxehtësi;
- rritja e çmimit të drurit; dhe
- performanca e përmirësuar e energjisë në banesa.

Përveç informacionit të ofruar më lart, ju lutemi përshkruani situatën aktuale të tokës bujqësore që përdoret për prodhimin e energjisë, si më poshtë:

- Përdorimi aktual i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave bujqësore energjetike në vitin 2009 (ha);
- Përdorimi i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave bujqësore energjetike, sipërfaqja.

1. Toka e përdorur për drurë me cikël të shpejtë rritjeje (shelgje, plepa): Për periudhën 2006–2009 nuk ka asnjë hektar tokë të përdorur për këto qëllime.

2. Toka e përdorur për kultura të tjera bujqësore energjetike, si p.sh.: barërat (*Phalaris arundinacea, Panicum virgatum, Miscanthus*), sorghum: bazuar në statistikat e publikuara nga INSTAT-i, për periudhën 2006–2009 nuk ka asnjë hektar tokë të përdorur për këto qëllime.

1.1.1.2 Mobilizimi i burimeve të reja të biomasës

Sipas shifrave të ofruara nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (bazuar në publikimin vjetor të vitit 2009), sipërfaqja e tokës së degraduar është 12 335 ha.

Toka bujqësore e papërdorur vlerësohet në rreth 34 568 ha. Nuk ka asnjë masë të planifikuar për rritjen e kulturave bujqësore energjetike, por në të njëjtën kohë është e rëndësishme të përmendet se mbjellja e kulturave bujqësore energjetike është një nga masat zbutëse për gazet me efekt serrë që përmendet në Komunikimin e Dytë Kombëtar të Shqipërisë drejtuar KKKBNK-së nga viti 2009.

Nuk është prodhuar energji nga plehu i kafshëve dhe janë kryer disa studime paraprake fizibiliteti për prodhimin e biogazit nga plehu i disa fermave të ndryshme. Nuk ka stimuj specifikë që promovojnë prodhimin dhe përdorimin e biogazit, përveç përdorimit të tij në prodhimin e kombinuar të nxehtësisë dhe të energjisë, sipas të cilit sasia e prodhuar e energjisë elektrike blihet me çmime preferenciale dhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE) duhet të përgatisë gjithashtu tarifat e posaçme për këtë teknologji. Momentalisht, sasia e biogazit të prodhuar është zero; megjithatë janë planifikuar masa për arritjen e prodhimit të një sasie prej 7,1 ktoe bogaz sipas dokumentit aktual të PKVER-së.

Po bëhen përpjekje për të përmirësuar menaxhimin e pyjeve me qëllim rritjen e zhvillimit në të ardhmen dhe riprodhimin e qëndrueshëm. Është planifikuar certifikimi i pyjeve komunale dhe i atyre shtetërore me qëllim përmirësimin e teknikave për menaxhimin e pyjeve.

1.1.1.3 Ndikimi në sektorët e tjerë

Nuk është bërë asnjë vlerësim i ndikimit të përdorimit të energjisë nga biomasa në sektorët e tjerë. Një vlerësim i tillë do të kryhet në të ardhmen (është hartuar një projektpropozim për t'i studiuar këto efekte, i cili është ende në fazën e diskutimeve të brendshme ndërmjet aktorëve kombëtarë).

Përdorimi i biokarburanteve në sektorin e bujqësisë ka një potencial të konsiderueshëm, pasi mbi 85% e konsumit të energjisë në sektorin bujqësor në vitin 2009 është bazuar te lëndët djegëse të lëngshme. Përdorimi i biokarburanteve në këtë sektor do ta lehtësonte rritjen e qëndrueshme të tij.

b) Çfarë lloj zhvillimi pritet në sektorët e tjerë që mbështeten te bujqësia dhe pylltaria, të cilat do të ndikonin në përdorimin e energjisë? (P.sh. eficienca/rendimenti i përmirësuar do ta rriste apo do ta ulte sasinë e nënprodukteve në dispozicion për përdorimin e energjisë?)

Rritja e prodhimit të biomasës së përpunuar, p.sh., ashklat e drurit, paletat dhe briketat e drurit do të çonin në një ulje çmimi për konsumatorët fundorë. Kjo gjë do të ulte konsumin e druve të zjarrit, si dhe do të zvogëlonte humbjet e kompanive që i shesin ato.

Masat për promovimin e përdorimit të BRE-ve paraqiten të përmbledhura në tabelën 4:

Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultatet e pritshme	Grupi i synuar dhe/ose aktiviteti	Ekzistuese ose e planifikuar	Data e fillim/ përfundimit	Efektet financ. mil. ALL/vit
MASA NË DREJTIM TË KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR						
1. Të bëhet e mundur arritja e objektivit kombëtar 38% për BRE-të në totalin e konsumit final bruto të energjisë.	Projekt VKM për sasinë e BRE që do të kosumohen deri në 2020	Energji e prodhuar (ktoe)	Investitorët e BREve, AKBN, MEI	E planifikuar në 2015	2015–2020	n/a
2. Hartimi i metodologjisë për çmimet fikse të energjisë elektrike nga BRE-E në tregun e energjisë.	Rregullatore	BRE-E në bursë energjisë elektrike	ERE/MEI	Planifikuar	Brenda 2016	25.50
3. Procedura të përshtatshme për ankande të BRE-E si kapacitete të parashikuara në PKVBR sipas propozimit nga MEI	Regullatore	Energji e prodhuar (ktoe)	MEI/ERE	E planifikuar	5 vjet	100.00
4. Garancitë e origjinës për të gjitha BRE	Rregullatore	Energji e prodhuar (ktoe)	Investitorët	E planifikuar	Nuk ka afat kohor specifik	400.0
5. Detyrimin e kompanive të transmetimit ose të shpërndarjes për të lidhur impiante të reja të BRE-së në rrjetet e tyre; pagesa vetëm e kostove direkt të lidhjes në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;	Rregullatore ligjore	Reduktimi i humbjeve.	Investitorët e BRE-ve, OST/OSSH.	E planifikuar në 2/4 e 2016	2016–2017	5,200.00
MASA ME EFEKTE FINANCIARE PËR PROMOVIMIN E BRE-ve						
6. Detyrimin e marrësit (Operatori) për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e vogla	Financiare	Energji e prodhuar (ktoe)	Investitorët e BREve, OSSH,	Ekzistuese me përmirësime në ¼ të 2016	Për projekte të reja, masa do të vazhdojë përtej vitit 2020	7,400.00
7. Marrëveshjet afatgjata të blerjes së energjisë për energjinë elektrike të prodhuar prodhuesit aktualë të energjisë elektrike nga BRE	Rregullatore financiare ligjore	Energji e prodhuar (ktoe) 3,700GWh	Investitorët e BREve, OSSH, KESH, OST	Ekzistuese	Në vartësi të kontratave PPA ekzistuese	5,400.00
8. Politika mbështetëse fiskale për promovimin e sistemeve të diversifikuara të BRE-E (HEC, PV dhe Eolik)	Financiare	Energji e prodhuar (ktoe)	Investitorët e BREve, OSSH, KESH, OST	Ekzistuese me përmirësime në ¼ të 2016	Kontrata PPA	
8. Blerja e detyrueshme e energjisë elektrike nëpërmjet kontratave CfD në tregun e	Rregullatore financiare	Energji e prodhuar (ktoe)	Investitorët e BREve, OSSH,	E planifikuar në ¾ të 2016	2016–2020	650.00

energjisë nga BRE-E.	ligjore		KESH, Ndihma Shteterore			
9. Detyrimet për personat që hedhin në treg për qëllime transporti lëndë djegëse të lëngshme me prejardhje nga nafta, për të ofruar karburante për motorët me naftë dhe benzinë, të cilat përzihen me biokarburante sipas përqindjeve të përcaktuara në ligjin ekzistues për biokarburantet.	Financiare	Prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve (ktoe)	Investitorët, MEI/MB/MM dhe zyra e monitorimit të kritereve të qëndrueshmërisë	E planifikuar	2016–2020	883.00
10. Niveli zero i taksës së akcizës për biodizelin e pastër deri më 2018-n	Financiare	identike	Investitorët, tregtarët dhe administrata publike	Ekzistuese	2016–2020	555.00
11. Mbikëqyrja e cilësisë së biokarburantëve nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe zyrat e vlerësimit të kritereve të qëndrueshmërisë	Administrative	Përdorimi i biokarburanteve për transport	Distributorët dhe përdoruesit fundorë	E planifikuar	2016–2020	15.30
12. Miratimi i politikave dhe masave për rritjen e përdorimit të energjisë diellore në ndërtesa për ngrohjen e ujit	Administrative	Energji e prodhuar nga sistemet NUED	Ndërtesat publike ose private që ndërtohen të reja ose ato ekzistuese	Ekzistuese	2016–2020	116.00
13. Financime nëpërmjet granteve nga Fondi i BRE-ve për projektet të ngrohje dhe ftohjes në sektorin e bujqësisë duke përdorur biomasën.	Financiare	Energji e prodhuar nga biomasa	Sektori i bujqësisë	E planifikuar	Qershor 2016	1.352.00
14. Përpunimi i druve të zjarrit	Financiare	Energji termike	Sektori i mjedisit	E planifikuar		
TOTALI në 5 vite se bashku 108,500 milionë ALL				**TOTALI në mil ALL/Vit**		**21,696.80**

Tabela 4: Përmbledhje e të gjitha politikave dhe masave

4.4 Masat specifike për përmbushjen e kërkesave sipas neneve 13, 14, 16 dhe të neneve 17 deri në 21 të Direktivës 2009/28/EC

4.4.1 Procedurat administrative dhe planifikimi hapësinor

a) Një listë e legjislacionit ekzistues, dhe nëse është e mundur, legjislacioni rajonal në lidhje me procedurat e autorizimit, certifikimit dhe licencimit dhe planifikimin e territorit që zbatohet për centralet dhe transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë së tyre në infrastrukturën e rrjetit:

Legjislacioni përkatës i zbatueshëm në sektorin e energjisë elektrike

- Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë", përcakton parimet kryesore për zhvillimin e sektorit të energjisë, duke përfshirë centralet elektrike me BRE-në dhe rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes. Ligji transponon direktivën 2009/72 të BE-së për energjinë elektrike dhe shfuqizon ligjin e vjetër për sektorin e energjisë elektrike (ligji nr. 40/2015, datë 22.5.2003). Ky ligj përmban, gjithashtu, kërkesat dhe kriteret për dhënien e një licence për kryerjen e një aktiviteti në sektorin e energjisë. Ligji përmban, gjithashtu, një numër dispozitash të caktuara që rregullojnë ndërtimin e një linje të drejtpërdrejtë ose të një linje tregtar interkonjeksioni.

- Qeveria shqiptare dhe ERE janë në proces rishikimi të akteve nënligjore me qëllim pajtueshmërinë me kërkesat e ligjit të ri të sektorit të energjisë, përfshirë një numër aktesh nënligjore të cilat jepen më poshtë.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 12.12.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", përcakton procedurat dhe dokumentet e nevojshme për aplikimin, vlerësimin dhe dhënien e një autorizimi për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues të energjisë, i cili nuk është objekt koncesioni.

- Vendimi i ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, "Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit dhe dhënies, ndryshimit dhe/ose revokimit të një licence", i ndryshuar. Ky vendim përcakton procedurat dhe kushtet për dhënien e një licence për kryerjen e çdo veprimtarie në sektorin e energjisë.

- Ligji nr. 125/2013, datë 25.4.2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat" përcakton kuadrin ligjor për të gjitha koncesionet. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm për promovimin dhe lehtësimin e implementimit të projekteve koncesionare, rritjen e transparencës, drejtësisë, efikasitetit, qëndrueshmërisë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke përfshirë koncesionet për ndërtimin e hidrocentraleve.

- VKM nr. 575, datë 10.7.2013, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik-privat", përcakton procedurat dhe kriteret e detajuara për vlerësimin dhe dhënien e një koncesioni të zbatueshëm për hidrocentralet.

- Ligji nr. 111, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i cili përcakton kuadrin ligjor për përdorimin e burimeve ujore të vendit, përfshirë përdorimin e tyre për prodhimin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", i cili përcakton kushtet dhe procedurat specifike për rishikimin dhe marrjen e vendimit për dhënien e një autorizimi ose leje shfrytëzimi për burimet ujore, përfshirë shfrytëzimin e ujit për ndërtimin e hidrocentraleve.

- Vendimi i ERE-s nr. 123, datë 24.10.2008, "Për miratimin e kodit të funksionimit të rrjetit të transmetimit", i ndryshuar, i cili përcakton procedurat e planifikimit dhe të lidhjes për zhvillimin e sistemit të transmetimit.

- Vendimi i ERE-s nr. 100, datë 26.8.2008, "Për miratimin e kodit të shpërndarjes së energjisë elektrike", i ndryshuar, i cili përcakton procedurat e planifikimit dhe të lidhjes për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.

- Vendimi i ERE-s nr. 9, datë 21.2.2007, "Për rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", i cili përcakton rregullat dhe procedurat specifike për dhënien e garancive të origjinës dhe certifikatave të gjelbra për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme.

- Ligji nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike".

- VKM nr. 646, datë 12.12.2002, "Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit, në fushat e industrisë dhe të energjetikës, të cilat duhet të marrin statusin "Rregulla teknike" të detyrueshme për zbatim".

- VKM nr. 529, datë 15.8.2007, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".

Legjislacioni specifik i zbatueshëm në sektorin e BRE-ve

- Ligji nr. 138/2013, datë 2.5.2013, "Për burimet e rinovueshme të energjisë", i cili përcakton dispozita të posaçme për lidhjen e impianteve që punojnë me BRE-në me rrjetin e transmetimit dhe/ose shpërndarjes.

- Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", i ndryshuar, përcakton kuadrin ligjor për dhënien e lejeve për prodhimin, tregtimin me shumicë dhe me pakicë të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport.

Legjislacioni specifik i zbatueshëm në planifikimin e hapësirave

- Ligji nr. 107, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, është legjislacioni kryesor që rregullon planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Shqipëri, qëllimi i të cilit është të përcaktojë parimet e përgjithshme, rregullat dhe procedurat, duke përfshirë përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Ligji për planifikimin dhe zhvillimin e territorit përcakton institucionet për organet përgjegjëse për planifikimin e territorit përfshirë:

a) Në nivel qendror

- Këshilli i Ministrave;

- Këshilli Kombëtar i Territorit;

Ministria përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (ministri i Zhvillimit Urban)

b) në nivel rajonal

- Këshilli Rajonal

c) në nivel vendor

- Këshillat bashkiakë; ligji parashikon se dy organet që kanë kompetenca për dhënien e lejeve të ndërtimit janë Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) dhe Kryetari i Bashkisë.

- Lejet e ndërtimit për çdo impiant energjie lëshohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Pavarësisht se ministritë e linjës, përfshirë ministrinë përgjegjëse për energjinë, nuk kanë asnjë pushtet vendimmarrës në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ato ngarkohen me përgjegjësi për përgatitjen e planeve sektoriale të zhvillimit dhe duhet të sigurohen që çdo aplikim për leje ndërtimi të jetë në përputhje me planet efektive sektoriale.

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit" i cili përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zhvillimin e territorit.

- VKM nr. 1190, datë 13.11.2009, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit". Ky vendim përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit që shërben si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit.

- VKM nr. 68, datë 15.2.2001, "Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit".

- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i cili përcakton kriteret dhe procedurat për shpronësimin e pronës private për çdo projekt që përbën interes publik, si p.sh. ndërtimi i një objekti energjetik, duke përfshirë objektet e prodhimit të energjisë elektrike, të transmetimit dhe shpërndarjes, objektet për prodhimin e biokarburanteve etj.

- Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e autoriteteve vendore, duke përfshirë përgjegjësitë specifike që ato kanë për rregullimin e hapësirës.

- Legjislacioni specifik për mjedisin.

- Ligji nr. 10431, datë 14.7.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, i cili ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe

sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

- Ligji nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedisi. Kërkesave të këtij ligji i nënshtrohet hartimi i të gjitha planeve dhe programeve për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, turizmin, planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshi dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

- VKM nr. 507, datë 10.6.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative të rëndësishme në mjedis që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

- VKM nr. 219, datë 11.3.2015, "Për rregullat e procedurat për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

- VKM nr. 620, datë 7.7.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjësive dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar".

- Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i cili përcakton se, përpara miratimit të çdo leje ndërtimi për objektet e prodhimit, transmetimit apo shpërndarjes, do të duhet të kryhet procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).

- VKM nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

- VKM nr. 247, datë 30.4.2014, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

- VKM nr. 598, datë 1.7.2015, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar".

- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Çdo instalim, i cili është i listuar në shtojcën 1 të këtij ligji duhet t'u nënshtrohet kërkesave të këtij ligji.

- VKM nr. 417, datë 25.6.2014, "Për miratimin e tarifave për lejet e mjedisit".

- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

- Ligji nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

- Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.

- VKM nr. 417, datë 25.6.2014, "Për miratimin e tarifave për lejet e mjedisit".

- VKM nr. 103, datë 31.3.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë".

- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

- Ligji nr. 8905, datë 6.6.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi".

- Ligji nr. 7875, datë 23.11.1994, "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë".

- Ligji nr 9385, datë 4.5.2005, i ndryshuar, në pritje të ligjit të ri që miratohet brenda këtij viti.

- Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000, "Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit "Për të drejtën e publikut VKM nr. 16, datë 4.1.2012, "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor".

- Ligji nr. 9334, datë 16.12.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike".

- VKM 1353 dhe 1257 për kriteret e heqjes nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtare të sipërfaqeve objekt koncensionesh.

- VKM nr. 1553, datë 26.11.2008, "Krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos".

- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

- VKM nr. 608, datë 17.9.2014, "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre".

- VKM nr. 127, datë 11.2.2015, "Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura".

Legjislacion tjetër i rëndësishëm

- Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton një "*one-stop shop*" për të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet që lëshohen për personat fizikë ose juridikë për kryerjen e një aktiviteti me interes publik ose përdorimin e një objekti publik.

- Ligji nr. 10137, datë 11.5.2009, "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i cili pasqyron ndryshimet në legjislacionin ekzistues të fushave specifike të prekura nga ligji nr. 10081, datë 23.2.2009.

- VKM nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

- VKM nr. 410, datë 13.5, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i cili krijoi inspektoratin qendror teknik me kompetenca në pajisjet elektrike, pajisjet që funksionojnë nën presion dhe tregun e nënprodukteve të naftës.

b) Organi (organet) përgjegjës për shpërndarjen e informacionit në nivel kombëtar/rajonal/lokal:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) ka përgjegjësi të plotë për sektorin e energjisë. MEI është institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave energjetike dhe të strategjive afatmesme dhe afatgjata për sektorin e energjisë. MEI, gjithashtu, ka përgjegjësi për vlerësimin dhe rishikimin e kërkesave për të drejtat për koncesion për ndërtimin e hidrocentraleve dhe për autorizimet e llojeve të tjera të teknologjisë për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, si: era, biomasa, diellore etj.

Misioni i ministrisë në sektorin e energjisë është të promovojë një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet:

- Përgatitjes, rishikimit periodik dhe përditësimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë;

- Promovimit të eficiencës së energjisë dhe burimeve të rinovueshme duke përfshirë hidrocentralet e vegjël;

- Parashikimit të kërkesës për burime të ndryshme energjie;

- Nxitjes së investimeve private, vendase ose të huaja, në sektorin e energjisë, duke krijuar një klimë ligjore tërheqëse për këto investime;

- Zhvillimit të reformave të tregut në sektorin e energjisë për të arritur objektivat kombëtarë për integrimin në BE dhe zhvillimit të një tregu rajonal të energjisë elektrike;

- Hartimit të kuadrit ligjor të nevojshëm;

- Përgatitjes për privatizim të kompanive shtetërore të energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila ka si objekt të punës së saj zhvillimin dhe mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, të mbështetur në politikat qeveritare dhe monitorimin e fazës passhfrytëzimit të tyre në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka një sërë përgjegjësish në bazë të ligjit për BRE-të, si organi kompetent për zhvillimin e BRE-ve.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është një institucion përgjegjës për garantimin e sigurisë së personave për mallrat që hidhen në treg. Ky inspektorat ka kompetenca për të mbikëqyrur sigurinë e pajisjeve dhe instalimeve elektrike, duke përfshirë sigurinë e objekteve të prodhimit të energjisë, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një organ publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror. ERE është organ kompetent për lëshimin e licencave për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike. Është përgjegjës për miratimin e kodit të rrjetit që u ofron të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike lidhje me dhe akses në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes. ERE ka, gjithashtu, kompetenca për të miratuar tarifat promovuese (*feed*-in) për të gjithë prodhuesit e privilegjuar me burime të rinovueshme, përfshirë tarifat, dhe marrëveshjen standard për blerjen e energjisë, të aplikuar për prodhues me përparësi të BRE-ve.

Një përgjegjësi e rëndësishme që i është dhënë ERE-s është zhvillimi dhe miratimi i rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe monitorimi i tregut të energjisë.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Turizmit është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit. Një sërë subjektesh të tjera që luajnë rol në zhvillimin e BRE-ve janë në varësi të kësaj ministrie.

Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) është një institucion publik i krijuar sipas ligjit dhe në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Turizmit. Misioni i Qendrës Kombëtare të Licencimit është të lehtësojë procedurat e licencimit, autorizimit dhe lejet që lëshohen nga autoritetet publike. QKL-ja është projektuar për të funksionuar si një "qendër me një ndalesë" (*one-stop shop*) për të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet që lëshohen nga autoritetet publike.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është një njësi e themeluar në bazë të ligjit për koncesionet dhe është në vartësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Turizmit. Misioni i ATRAKO-s është të mbështesë Autoritetin Kontraktor në vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve në të gjitha fushat e koncesioneve, përfshirë ndërtimin e hidrocentraleve.

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit, sipas përcaktimeve të ligjit. KKT-ja është një organ kolegjial, pranë Këshillit të Ministrave. Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) ka këto kompetenca:

a) vendos miratimin, miratimin me ndryshime, shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm ose mosmiratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit;

b) vendos miratimin e përcaktimit të rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit;

c) shqyrton dhe miraton përputhshmërinë e instrumentit vendor me instrumentet e planifikimit në fuqi;

d) nxit hartimin e planeve territoriale kombëtare e vendore nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe siguron që ato të përmbushin standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në ligj.

e) miraton lejet e ndërtimit për projekte të rëndësishme zhvillimi, përfshirë ndërtimin e impianteve të reja energjetike.

Ministria e Zhvillimit Urban është përgjegjëse për zhvillimin e politikave për planifikimin e hapësirave dhe lëshon licencat për projektimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe testimin e punimeve të ndërtimit. Kjo ministri është gjithashtu përgjegjëse për lëshimin e licencave profesionale për individët e angazhuar në projektimin, mbikëqyrjen dhe testimin e punimeve të ndërtimit.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është një institucion publik në varësi të Ministria e Zhvillimit urban dhe ka këto përgjegjësi:

a) mbështet bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare në planifikimin e territorit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare të fushave e sektorëve të ndryshëm, duke mbledhur autoritetet përgjegjëse dhe palët e interesuara dhe duke asistuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre;

b) mbështet bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit, duke mbledhur autoritetet përgjegjëse dhe palët e interesuara dhe duke asistuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore dhe palëve të interesuara;

d) u ofron mbështetje teknike njësive të qeverisjes vendore për hartimin e politikave dhe të akteve për planifikimin dhe menaxhimin urban, si dhe kontrollin e zhvillimit;

e) mbështet zhvillimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit, nëpërmjet trajnimit dhe ndihmës së drejtpërdrejtë;

f) kryen studime dhe vlerësime për zhvillimet në territor dhe, mbi këtë bazë, i sugjeron Këshillit të Ministrave përmirësimin e sistemit ligjor për planifikimin e territorit e instrumentet e kontrollit të zhvillimit ose nevojën e ndërmarrjes së proceseve planifikuese apo të masave të tjera të nevojshme;

g) informon publikun për proceset e planifikimit, ofron informacion dhe këshillon

autoritetet e planifikimit për procedurat dhe rregullat e një procesi planifikimi të territorit;

h) përgatit dhe boton manuale metodologjike për planifikimin e territorit, si dhe përgatit e ofron programe trajnimi për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit;

i) harton dhe shpërndan standardet teknike të ngritjes dhe administrimit të regjistrit;

j) mbështet autoritetet e planifikimit për mënyrën e regjistrimit dhe të administrimit në mënyrë të pavarur të të dhënave në regjistër dhe këshillon autoritetet e planifikimit për shpërndarjen efektive të tyre te palët e interesuara dhe procedurat e këshillimit;

k) mbështet bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit.

Ministria e Mjedisit (MM) ka përgjegjësi totale për mbrojtjen e mjedisit, specifikisht për ajrin, mbetjet, kimikatet, ndryshimet klimatike si edhe të pyjeve, zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit. Ministria është përgjegjëse për miratimin e vlerësimeve strategjike mjedisore për çdo plan territorial ose sektorial të miratuar sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; si për miratimin e raporteve të thelluara të VNM-së për çdo shpallje paraprake të ndikimit nëpërmjet projekteve të veçanta brenda planeve territorial

MM-ja është përgjegjëse për politikat lidhur me ndryshimet klimatike dhe shërben si pikë kontakti për qeverinë shqiptare për KKKBNK-në dhe Protokollin e Kiotos. MM-ja ushtron, gjithashtu, kompetencat e autoritetit kombëtar të përcaktuar për projektet MZHP sipas Protokollit të Kiotos në Shqipëri.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është një institucion në vartësi të Ministrisë së Mjedisit, e cila është përgjegjëse për shqyrtimin të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projekte të cilat janë objekt i ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, si dhe për dhënien shqyrtimin e aplikimeve për leje e mjedisi. Gjithashtu, kjo Agjenci është përgjegjëse për monitorimin e mjedisit.

Nën këndvështrimin e nenit 13/1 të Direktivës 2009/28/EC, qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm. Ligji i ri për sektorin e energjisë (ligji nr. 43/2015) në nenin 49/1 parashikon se ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese deri në 2 MË, përfshirë prodhuesit me BRE, miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë. Nga ana tjetër, ligji i ri për burimet e rinovueshme të energjisë (ligji 138/2013), në nenin 10 parashikon se Këshilli i Ministrave miraton procedurat e thjeshtuara për marrjen e autorizimeve dhe licencave të nevojshme për prodhimin e energjisë nga BRE-të.

Neni 37, paragrafi 6/b i ligjit për sektorin e energjisë parashikon, gjithashtu, se të gjithë prodhuesit, përfshirë vetë prodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW nuk janë të detyruar të pajisen me licencë prodhimi nga ERE. I njëjti ligj, në nenin 39, paragrafi 2, parashikon se ERE mund të miratojë procedura të thjeshtuara licencimi për prodhuesit e lidhur në rrjetin e shpërndarjes. Sipas legjislacionit të më sipërm, Këshilli i Ministrave pritet të përgatisë dhe miratojë procedura specifike që do të thjeshtojnë dhënien e autorizimit të ndërtimit të nevojshëm për prodhuesit me BRE, ndërsa ERE do të miratojë një procedurë të thjeshtuar për licencimin e prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, përfshirë prodhuesit me BRE të lidhur drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes.

Aktualisht duket se nuk ka ndonjë pengesë të panevojshme ose kërkesa të papërshtatshme lidhur me procedurat e autorizimit, certifikimit dhe licencimit që zbatohen për centralet dhe infrastrukturën që lidhet me transmetimin dhe shpërndarjen. Për më tepër, ligji për BRE-të parashikon dispozita të cilat përjashtojnë prodhuesit e vegjël të energjisë, me fuqi të instaluar deri në 1 MW, nga detyrimi për të marrë licencë prodhimi. Nga ana tjetër, krijimi i Qendrës Kombëtare të Licencimit, në bazë të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka lehtësuar dukshëm procesin e marrjes së një licence, autorizimi ose lejeje.

Autorizimet për ndërtimin e instalimeve të burimeve të rinovueshme të energjisë jepen nga Këshilli i Ministrave ose sipas kërkesave të ligjit për koncesionet për hidrocentralet, ose sipas kërkesave të ligjit Për sektorin e energjisë për llojet e tjera të prodhuesve të energjisë elektrike me BRE, ose sipas ligjit për biokarburantet për prodhuesit e biokarburanteve.

Licencat për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë lëshohen nga Enti Rregullator i Energjisë.

Çdo projekt i cili parashikon të gjeneroje energji

nga BRE-të ose për çdo prodhues biokarburantesh kërkohet të kryeje procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis paraprak ose të thelluar (në varësi të projektit) dhe më pas nëse instalimi është i listuar në shtojcën 1 të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit, të pajiset me Leje Mjedisi të tipit A, B ose C. Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis kërkon që Ministria e Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë dhe autoritetet vendore të bashkëpunojnë gjatë të gjithë procesit duke garantuar pjesëmarrjen e publikut në çdo vendimmarrje të mundshme.

Për sa u përket lejeve të ndërtimit, sipas ligjit të ri për planifikimin e territorit (ligji nr. 107/2014 dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015), autoritetet vendore janë përgjegjëse për dhënien e lejes për ndërtimin e çdo centrali energjie. Nga ana tjetër, për çdo instalim të sistemeve NUED apo fotovoltaike në ndërtesa që nuk konsiderohen si pjesë e trashëgimisë kulturore, kërkohet vetëm një njoftim paraprak i autoriteteve vendore (Kryetari i Bashkisë). Një masë e rëndësishme e përmirësuar, e paraqitur nga legjislacioni i ri për planifikimin e territorit është krijimi i një zyre me një ndalesë (*One stop shop*) për çdo leje ndërtimi. Kjo masë do të ulë kohën që duhet për marrjen e një leje ndërtimi në jo më shumë se 60 ditë, dhe do të rrisë transparencën e procesit.

Koncesionet për ndërtimin e hidrocentraleve jepen nëpërmjet një procesi të hapur dhe konkurrues ofertimi, ku ofertuesve i sigurohet akses i barabartë në informacionin dhe në të dhënat lidhur me projektin. Informacioni dhe të dhënat për një koncesion specifik vihen gjithashtu në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të MEI-së.

Kushtet dhe kriteret për dhënien e një autorizimi për ndërtimin e një centrali me burime të rinovueshme, i ndryshëm nga hidrocentrali, janë tashmë të parashikuara në ligjin e ri për sektorin e energjisë (ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015) dhe në rregulloren specifike të miratuar nga Këshilli i Ministrave (VKM nr. 1701, datë 17.12.2008).

Licencat për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, transmetimin dhe shpërndarjen jepen duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara nga ligji Për sektorin e energjisë dhe procedurat e licencimit të miratuara nga ERE, të cilat janë botuar në fletoren zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Personat e interesuar që dëshirojnë të kryejnë një aktivitet në sektorin e energjisë mund të kontaktojnë gjithashtu direkt me stafin teknik të ERE-s, i cili është përgjegjës për licencimin, si dhe të marrin informacion për procedurat, kërkesat dhe dokumentet që duhen dorëzuar për marrjen e një licence.

Qeveria shqiptare ka bërë shumë përpjekje për të lehtësuar koordinimin ndërmjet organeve të ndryshme administrative përgjegjëse për pjesë të ndryshme të lejes për një projekt specifik. Ngritja e Qendrës Kombëtare të Licencimit ka qenë një hap pozitiv përpara në krijimin e një shërbimi "one-stop shop" për të gjitha licencat dhe lejet e kërkuara për një projekt.

Megjithatë, sipas legjislacionit në fuqi, për ndërtimin e një termocentrali të ri apo infrastrukture të re transmetimi ose shpërndarje, kërkohen një sërë autorizimesh/leje/licenca kryesore, apo akte të tjera miratuese, përfshirë:

- Vendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose deklaratën e ministrit për VNM-në e thelluar, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar;
- Koncesion ose autorizim i miratuar nga Këshilli i Ministrave, ose të ministri përgjegjës për energjinë, sipas ligjit për koncesionet dhe ligjit për sektorin e energjisë elektrike;
- Licenca e aktivitetit, lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

Për sa u përket afateve kohore për përpunimin e një aplikimi, është e vështirë të jepet një kohë mesatare për administrimin e një çështjeje, sepse kjo varet shumë nga vetë projekti. Projektet e mëdha shpesh duhet t'i nënshtrohen një procesi planifikimi të hapësirës që do të kërkojë më shumë kohë, pjesërisht për shkak të karakterit kompleks të projektit dhe përfshirjes së popullsisë lokale gjatë procesit të rishikimit (procesi i miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis).

Këtu vlen të theksohet fakti se, legjislacioni parashikon zbatimin e parimit të miratimit automatik (miratim i heshtur) në rast mos-përgjigje nga ana e institucionit administrativ ndaj një kërkese, brenda një afati të caktuar kohe, të parashikuara në legjislacionin përkatës.

Për sa i përket procesit të VNM-së, legjislacioni parashikon disa dallime. Ndërtimi i centraleve të vegjël me BRE, sipas legjislacionit në fuqi, i nënshtrohen fillimisht vetëm VNM-ja

paraprake, dhe është Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që me anë të vendimit të saj vendos nëse projekti i propozuar duhet apo jo t'i nënshtrohet VNM-së së thelluar. Ndërsa centralet me energji konvencionale i nënshtrohen një procesi më të thelluar VNM-je. Procedurat e autorizimit në Shqipëri marrin parasysh specifikat e teknologjive të ndryshme të energjive të rinovueshme, sepse ato rregullohen nga legjislacione të ndryshme. Siç u përmend edhe më lart, autorizimet për hidrocentralet e reja jepen sipas ligjit për koncesionet, i cili përmban procedurat specifike, ndërsa autorizimet për teknologjitë e tjera të BRE-ve jepen sipas kërkesave të ligjit për sektorin e energjisë. Të dyja legjislacionet kanë procedura të ndryshme, sepse ndërkohë që koncesionet jepen mbi bazën e një procesi konkurrues ofertimi, autorizimet për teknologjitë e tjera BRE jepen mbi bazën e parimit "i pari në kohë, i pari në të drejta".

Për sa u përket lejeve të ndërtimit, legjislacioni nuk bën ndonjë dallim ndërmjet teknologjive BRE dhe teknologjive të tjera konvencionale.

Aktualisht, në Shqipëri nuk ka procedura specifike për instalimet e vogla të decentralizuara të BRE-ve. Të dyja ligjet, ai për sektorin e energjisë dhe të energjisë së rinovueshme, parashikojnë dispozita që i kërkojnë Këshillit të Ministrave dhe ERE-s të miratojnë procedura dhe kërkesa të thjeshtuara për marrjen e licencave dhe të lejeve për prodhuesit e privilegjuar me BRE dhe prodhuesit e vegjël.

Tarifat për autorizimet e centraleve të reja me BRE publikohen në fletoren zyrtare dhe në faqen e internetit të MEI-së së bashku me vendimin përkatës të qeverisë që përmban kriteret dhe procedurat për rishikimin dhe dhënien e autorizimeve.

Tarifat e licencave të vendosura nga ERE për licencat e prodhimit botohen në fletoren zyrtare dhe faqen e internetit të ERE-s së bashku me rregulloren për procedurat e licencimit. Pasi fillojnë veprimtarinë e prodhimit, personat e licencuar i nënshtrohen një tarife rregullatore të vendosur nga ERE bazuar në xhiron e tyre vjetore, por megjithatë, këto tarifa janë publike dhe zbatohen në mënyrë proporcionale për të gjitha kompanitë e licencuara.

Tarifat për lejet e mjedisit botohen në fletoren zyrtare dhe publikohen në faqen e internetit të MeM-së.

Tarifat e koncesionit për hidrocentralet janë rezultat i procesit të ofertimit, ku ofertuesit e ofrojnë tarifën e koncesionit bazuar në një përqindje të prodhimit vjetor që ata parashikojnë, i cili është një nga kriteret e vlerësimit të ofertës.

Nuk ka ndonjë udhëzues zyrtar në dispozicion të organeve administrative vendore të planifikimit, projektimit, ndërtimit dhe rehabilitimit të zonave industriale dhe rezidenciale që të instalohen pajisje dhe sisteme që përdorin burimet e rinovueshme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe ngrohjen dhe ftohjen.

Ligji i ri (neni 8) parashikon se Ministria përgjegjëse për energjinë dhe agjencia e autorizuar për të qenë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, do të duhet të sigurojnë që informacioni për masat mbështetëse për instalimet të jetë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara, siç janë zhvilluesit, sponsorët, investitorët, institucionet financiare, ndërtuesit, instaluesit, arkitektët dhe furnizuesit e pajisjeve dhe sistemeve të energjisë për ngrohjen, ftohjen, në pajtim me përdorimin e energjisë nga burime të rinovueshme

Megjithatë, ligji nuk përcakton ndonjë afat ose procedurë specifike për mënyrën sesi do të ofrohet ky informacion ose udhëzim. Prandaj, nevojitet të bëhet një rregullim specifik për këtë qëllim, në të ardhmen e afërt, dhe të miratohet si urdhër i ministrit përgjegjës për energjinë.

Nga ana tjetër, ligji për BRE-të (neni 28/1) parashikon se Këshilli i Ministrave do të nxjerrë një rregullore për të siguruar se publikut i vihet në dispozicion informacioni mbi disponushmërinë dhe përftimet mjedisore të të gjitha burimeve të rinovueshme të energjisë për transport. Rregullorja do të vendosë një detyrim për të treguar në pikat e shitjes, kur përqindjet e biokarburanteve, të përzier me derivate të naftës së papërpunuar, tejkalojnë përqindjen e vëllimit të përcaktuar nga ERE.

4.4.2 Ndërtesat

Ligji për BRE-të parashikon se Këshilli i Ministrave do të miratojë politika dhe masa për rritjen e përdorimit të energjisë diellore në ndërtesa, përfshirë detyrimin për kategori të ndryshme ndërtesash, qoftë të reja apo ekzistuese, publike apo private, për të instaluar sisteme të ngrohjes së ujit me energji diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar apo teknologjik, dhe për të përmbushur kështu objektivat e caktuar për rritjen

e kontributit të energjisë diellore në totalin e konsumit të energjisë në vend. I njëjti nen kërkon që Këshilli i Ministrave, me miratimin e ministrit përgjegjës për energjisë, do të përcaktojë sektorët e ekonomisë dhe kategoritë e ndërtesave, zonën minimale ose kapacitetin e sistemit të ngrohjes së ujit me energji diellore, kërkesat teknike të sistemeve të ngrohjes së ujit me energji diellore që do të duhet të instalohen, si dhe procedurat specifike dhe kriteret që do të ndiqen në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e këtij detyrimi nga institucionet përgjegjëse.

Ministria përgjegjëse për sektorin e ndërtimit është Ministria e Zhvillimit Urban. Megjithatë, çështjet e energjisë në ndërtesa ndahen deri diku ndërmjet MZHU-së dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Është e rëndësishme të theksohet se, bazuar në legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin urban, një rol të rëndësishëm në sektorin e ndërtimit kanë autoritetet vendore, të cilat janë përgjegjëse për lëshimin dhe monitorimin e lejeve të ndërtimit.

Ligji i ri 124/2015 për eficiencën e energjisë i jep një rol më të fortë Agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë lidhur me performancën e energjisë në ndërtesa, ku përputhja e çdo objektivi të detyrueshëm për instalimin e BRE në ndërtesa do të monitorohet në kuadër të performancës së përgjithshme të ndërtesës.

Ligji për BRE-të nuk përcakton ndonjë afat ose grafik për këtë masë, megjithatë, tashmë është përgatitur një projektvendim i Qeverisë përcakton krijimin e një grafiku për instalimin e detyrueshëm të sistemeve NUED në kategoritë ndryshme ndërtesash. Është e rëndësishme që miratimi dhe zbatimi i këtij vendimi të jetë në një linjë me legjislacionin e ri për performancën e energjisë të ndërtesave (legjislacioni për eficiencën e energjisë).

Një tjetër rishikim i rëndësishëm i legjislacionit ekzistues është ai i propozuar nga Programi i PNUD-it për Ndryshimet Klimatike për krijimin dhe fuqizimin e tregut të paneleve diellore për ujë të ngrohtë, si dhe për rishikimin e ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, "Për administrimin e bashkë-pronësisë në ndërtesat e banimit". Mbështetur në rishikimet e propozuara, instalimet e sistemeve NUED duhet të përfshihen në pronësinë e përbashkët në ndërtesat e apartamenteve duke mundësuar një funksionim dhe menaxhim më të mirë të këtyre sistemeve.

Po sipas Programit të PNUD-it për Ndryshimet Klimatike, për krijimin dhe fuqizimin e tregut të paneleve diellore për ujë të ngrohtë, është bërë një propozim nga një vendim i këshillit bashkiak të Tiranës për instalimin në sipërfaqe minimale të sistemeve NUED në kategori të ndryshme ndërtesash, duke përfshirë ndërtesat me familje, blloqet e apartamenteve, zyrat private, hotelet dhe restorantet, objektet sportive.

Aktualisht, nuk ka asnjë nivel minimal për përdorimin e energjisë së rinovueshme në rregulloret dhe kodet e ndërtimit. Siç përmendet edhe më lart, ligji i ri për energjitë e rinovueshme i kërkon Këshillit të Ministrave të vendosë objektiva minimalë për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe teknologjik me energji diellore në ndërtesa, si dhe instalimin e detyrueshëm të sistemeve NUED për një kategori ndërtesash. Ndërkohë që është përgatitur një projektvendim i qeverisë për instalimin e detyrueshëm të sistemeve NUED në ndërtesa. Projektvendimi përmban gjithashtu zonën minimale të NUED që duhet të instalohet për të përballuar kërkesën e ndërtesës për ujë të ngrohtë. Sipas projektvendimit, ky sistem NUED do të ketë një sipërfaqe që do të duhet të përmbushë të paktën 60% të kërkesës për ujë të ngrohtë, përveç pishinave të hapura që do të duhet ta ngrohin ujin tërësisht nga sisteme të energjisë termale diellore.

Në politikën kombëtare nuk është marrë në konsideratë asnjë detyrim për nivelet minimale të energjisë së rinovueshme në ndërtesat e reja dhe të ri-konstruktuara së fundmi. Mbështetur në kërkesat e ligjit të ri për energjitë e rinovueshme, këto nivele minimale do të merren parasysh në këto politika.

4.4.3 Dispozitat informuese

Informacionet aktuale dhe për të ardhmen, si dhe fushatat e programet ndërgjegjësuese së bashku me rishikimet e planifikuara dhe rezultatet e pritshme duhet të jenë të përshkruara. Shtetet anëtare duhet të tregojnë gjithashtu se cili autoritet përgjegjës do të monitorojë dhe shqyrtojë efektet e programeve. Kur autoritetet rajonale/vendore kanë një rol thelbësor, ju lutemi tregojeni dhe përmblidheni.

Sipas nenit 8 të ligjit për energjitë e rinovueshme, Ministria përgjegjëse për energjinë dhe agjencia e autorizuar përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë (AKBN), siguron që të gjithë të interesuarve, si konsumatorët, zhvillues,

planifikues, sponsorizues, investitorë, institucione financiare, ndërtues, instalues, arkitektë dhe furnitorë të pajisjeve dhe sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes, pajisjeve të energjisë elektrike dhe pajisjeve të tjera që përdorin energji të rinovueshme, t'u vihet në dispozicion informacioni për masat mbështetëse për centralet që përdorin burime të rinovueshme energjie.

Po i njëjti nen (paragrafi 2) parashikon se Ministria përgjegjëse për energjinë ose agjencia përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, duhet të zhvillojë programe të përshtatshme për trajnime ose udhëzime, sensibilizimi e informimi, në mënyrë që të informohen të interesuarit dhe shtetasit për përfitimet, kostot dhe realizimin e zhvillimit dhe përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

Ministria përgjegjëse për energjinë apo institucionet në varësi nuk kanë siguruar rregulla të detajuara apo procedura se si do të ofrohet ky informim apo ndërgjegjësim. Megjithatë, duhet përmendur se janë organizuar një sërë fushatash ndërgjegjësuese nga institucionet për energjinë në Shqipëri me qëllim promovimin e përdorimit të BRE-ve në Shqipëri, nëpërmjet seminareve të ndryshme, reklamave në median masive etj. Ministria përgjegjëse për energjinë së bashku me agjencitë në varësi të saj kanë organizuar një sërë aktivitetesh promovuese, që investitorët privatë të investojnë në prodhime të vogla energjie me rezultate shumë të mira. Vitet e fundit, një numër shumë i madh investitorësh privatë kanë treguar interes të madh për të investuar në energjinë elektrike të prodhuar nga uji dhe nga era.

Ende nuk ka një plan masash për nxitjen e përdorimit të BRE-ve në nivel vendor. Reforma e re territoriale, e cila do të mundësojë krijimin e bashkive të mëdha që priten të krijohen pas zgjedhjeve vendore të qershorit 2015, mund të jetë një mundësi me rëndësi për rritjen e rolit të autoriteteve vendore për zbatimin e politikave të BRE-ve.

Aktualisht nuk ekzistojnë organe përgjegjëse për ofrimin e informacionit për përdorimin e energjive të rinovueshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes dhe në sektorin e transportit. Siç përmendet edhe më lart, ligji i ri për energjitë e rinovueshme (neni 25), Këshilli i Ministrave miraton një rregullore për të siguruar që t'i jepet informacion publikut për disponimin dhe përfitimet mjedisore nga të gjitha burimet e ndryshme të rinovueshme të energjisë për transport. Rregullorja duhet të parashikojë dhe detyrimin për të treguar në pikat e shitjes kur përmbajtja e biokarburanteve, të tretura në nënproduktet e naftës, e kapërcejnë kufirin e vendosur në përqindje, sipas përcaktimeve të bërë nga ERE.

Siç u përmend edhe më sipër, projektligji i ri për energjitë e rinovueshme kërkon, për sa i përket informimit për masat mbështetëse për përdorimin e energjive të rinovueshme për energji elektrike, qeveria ia ka vënë në dispozicion këtë informacion investitorëve jo vetëm nëpërmjet legjislacionit të publikuar në fletoren zyrtare ose faqet e ndryshme të internetit, por gjithashtu edhe nëpërmjet një sërë evenimentesh publike si konferenca, seminare etj.

Qeveria ka në plan t'ia transformojë agjencinë përgjegjëse për energjitë e rinovueshme në qendra informimi për të gjitha palët e interesuara lidhur me masat mbështetëse për përdorimin e energjive të rinovueshme.

Aktualisht asnjë institucion ose agjenci nuk është përgjegjëse për përgatitjen dhe ofrimin e udhëzimeve për planifikuesit dhe arkitektët për t'i ndihmuar ata që të marrin në konsideratë në mënyrën e duhur kombinimin optimal të burimeve të rinovueshme të energjisë, të teknologjive me eficiencë të lartë, si dhe ngrohjen dhe ftohjen qendrore kur planifikojnë, projektojnë, ndërtojnë dhe rinovojnë hapësirat industriale ose rezidenciale.

Qeveria Shqiptare është duke përgatitur një legjislacion të ri për eficiencën e energjisë dhe performancën energjetike të ndërtesave, ku do të përfshihen dispozita specifike për kombinimin optimal të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe teknologjive me efikasitet të lartë në planifikim, projektim, ndërtimin dhe rinovimin e zonave industriale ose rezidenciale.

Informacioni, programet e ndërgjegjësimit dhe të trajnimit mbi përfitimet dhe praktikat e përdorimit të energjive të rinovueshme deri më sot nuk kanë qenë shumë të organizuara. Institucionet përgjegjëse për politikat e energjisë, kryesisht me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, kanë organizuar një sërë fushatash informuese dhe ndërgjegjësimi, por me rezultate të vogla. E vetmja hapësirë ku këto programe kanë pasur rezultate të kënaqshme janë programet për promovimin e prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike. Kohët e fundit, është treguar një interes më i madh nga

ministria përgjegjëse për energjinë dhe nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për promovimin e sistemeve të paneleve diellore për ujë të ngrohtë në vend.

4.4.4 Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë elektrike

Këtu duhen përshkruar përveç situatës ekzistuese dhe veprimeve të ardhshme të legjislacionit ekzistues, edhe rishikimet e planifikuara, organet përgjegjëse për to dhe rezultatet e pritshme.

Legjislacioni ekzistues kombëtar përfshin si më poshtë:

- Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë";
- Ligji nr. 138/2013, datë 2.5.2013, "Për burimet e rinovueshme të energjisë";
- Kodi i transmetimit;
- Kodi i shpërndarjes;
- Kodi i matjes;
- Rregullat e tregut
- Ligji nr. 107, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor";
- Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar;
- Legjislacion tjetër dytësor i miratuar sipas ligjit.

Sipas ligjit për sektorin e energjisë (neni 60), Operatori i Sistemit të Transmetimit, në konsultim me palët e interesuara, harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, dhe e paraqet atë për miratim tek ERE. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të marrë parasysh kërkesën ekzistuese dhe atë të parashikuar; për energji elektrik; planifikimin urban dhe rajonal të zonës ku shtrihen instalimet e transmetimit; planet e investimeve për rrjetet rajonale dhe legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht kërkesave të ligjit në fuqi për vlerësimin strategjik mjedisor.

Po ashtu, Kodi i Transmetimit (kapitujt 2, 3 dhe 4), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është ndër të tjera përgjegjës për funksionimin, zhvillimin dhe zgjerimin e rrjetit të transmetimit, si dhe për menaxhimin e çdo tranzitimi të energjisë elektrike, ndërmjet sistemeve të huaja, që shfrytëzojnë rrjetin shqiptar të energjisë elektrike. Sipas nenit III.5.1 të Kodit të Transmetimit, OST-së i kërkohet të përgatisë një Plan Perspektivë që të mbulojë një periudhë 15-vjeçare për zhvillimin e sistemit të transmetimit duke marrë në konsideratë parashikimet për kërkesat për energji elektrike, pikun e fuqisë, kapacitetet shtesë për energji elektrike, kapacitetet transmetuese, humbjet dhe parametrat e tjerë të rëndësishëm të SEE-së.

Nga ana tjetër, Kodi i Shpërndarjes (neni II.4) kërkon që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) të përgatisë një plan zhvillimi për sistemin e shpërndarjes në bazë të studimit të zhvillimit perspektiv të rrjetit elektrik për një periudhë mesatare 5-vjeçare dhe maksimale 10-vjeçare.

Si Kodi i Transmetimit dhe ai i Shpërndarjes do të rishikohen për të qenë në një linjë me dispozitat e ligjit për sektorin e energjisë.

Është e qartë se çdo plan zhvillimi duhet të marrin në konsideratë Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e përditësuar, për zhvillimin e burimeve të energjisë, përfshirë prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Aktualisht OST-ja ka në funksionim një sistem jo shumë modern të matjes dhe të mbledhjes së informacionit. Megjithatë, vitet e fundit OST-ja realizuar një qendër të re dispeçerimi së bashku me një sistem shumë të avancuar SCADA që do t'i mundësojë OST-së të marrë informacione në kohë reale nga të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike dhe pikat e transformimit.

Ligji i ri për energjinë (neni 78) kërkon që të mund të instalohen sisteme matëse inteligjente te klientë fundorë në tregun e furnizimit me energji elektrike. Vënia në zbatim e sistemeve të matësve inteligjentë do t'i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik paraprak, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për vënien në praktikë të këtij sistemi matjeje. OSSH-ja do të kryejë një vlerësim ekonomik dhe do të përgatisë një kalendar me objektivin e instalimit të sistemeve të matjes inteligjente brenda një periudhë 10-vjeçare.

Operatori shqiptar i sistemit të transmetimit ka përfunduar tashmë një linjë të re interkonjeksioni 400 kV me Malin e Zi (Tirana 2 - Podgorica), e cila rriti kapacitetin e interkonjeksionit të sistemit shqiptar deri në rreth 1000 MW.

Aktualisht, OST-ja po punon për ndërtimin e një linje të re 400 kV me Kosovën (Tirana 2 - Prishtina), e cila pritet të përfundojë në vitin 2016.

Përveç kësaj, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet operatorit shqiptar të sistemit të transmetimit dhe atij maqedonas për ndërtimin e një linje të re 400 kV (Elbasan-Bitola). Projekti pritet të financohet nga banka gjermane KfW.

Investitorët privatë kanë shprehur gjithashtu interes për të ndërtuar një kabllo nën ujore që lidhte Shqipërinë me Italinë. Gjithë këto interkonjeksione po rrisin dhe forcojnë kapacitetin interkonjektues të Shqipërisë me shtetet e tjera fqinje, i cili do të lehtësojë shumë zhvillimin e mundshëm të një tregu rajonal ku centralet elektrike me BRE pritet të luajnë një rol të konsiderueshëm duke pasur parasysh burimet e mëdha në Shqipëri dhe në shtetet e tjera në rajon.

Sipas nenit 31, të ligjit nr. 40/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë", autorizimi për ndërtimin e linjave të reja të interkonjeksionit, qofshin ato të financuara nga OST-ja ose nga persona privatë duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Për më tepër, lejet e ndërtimit për çdo infrastrukturë të rrjetit jepen vetëm shoqërive që kanë një licencë për transmetimin dhe/ose shpërndarjen e energjisë elektrike. Sipas ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", çdo leje ndërtimi për infrastrukturë të energjisë elektrike do të jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Projektet për ndërtimin e infrastrukturave të reja për energjinë elektrike kërkon që t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për këtë fushë.

Problemet kryesore që shoqëritë e transmetimit dhe të shpërndarjes hasin në ndërtimin e një linje lidhen me pronësinë e tokës. Këto vështirësi nuk lidhen më shumë me koston e pagimit të çmimit të kompensimit në rast të shpronësimit sesa me faktin që në shumë raste pronarët e tokës nuk zotërojnë certifikatën e pronësisë, meqenëse një pjesë e madhe e tokave në zonat e largëta nuk janë të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Procedurat për transferimin e pronësisë së tokës ku është zbatuar projekti ndiqen në zbatim të ligjit 8361, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik". Për këtë qëllim, subjekti i interesuar përgatit dosjen përkatëse sipas kërkesave të ligjit.

Dosja i dërgohet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), e cila cakton Komitetin e Posaçëm për Shpronësimet për rishikimin e dosjes. Nëse dosja është plotësuar në përputhje me ligjin, MEI dërgon një propozim për shpronësim në Këshillin e Ministrave, i cili vendos në favor në rastet kur vihet re që shpronësimi bazohet në ligj.

Më tej, aplikanti kompenson pronarët siç duhet sipas tarifave të përcaktuara duke tërhequr titullin e pronësisë (që merret nga Zyra e Kryeregjistruesit të Pasurive të Paluajtshme) dhe një dokument identifikimi, dhe përgatit dokumentacionin për regjistrimin e pronës nën emrin e tij/saj në ZRPP.

Për shkak të vështirësive që Shqipëria ka në planifikimin hapësinor administrativ, nuk ka ekzistuar një koordinim shumë efikas ndërmjet miratimit të infrastrukturës së rrjetit dhe procedurave të tjera administrative të planifikimit. Sidoqoftë, rregullorja e veçantë e miratuar nga ERE lidhur me rishikimin dhe miratimin e planeve të investimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike parashikon që plane të tilla duhet të marrin parasysh çdo planifikim të hapësirës të zhvilluar nga institucionet e pushtetit qendror ose nga autoritetet vendore.

Disiplina dhe planifikimi më i mirë i ndërtimeve të reja do ta lehtësonte zhvillimin dhe ndërtimin e një infrastrukture rrjeti të re në të ardhmen.

Sipas nenit 11 të ligjit për energjitë e rinovueshme, operatorët e sistemit të rrjetit, me kërkesën e një prodhuesi, në përputhje me rregulloret e ERE-s, bëjnë lidhjen e centralit me pikën e tij në sistemin e rrjetit, në variantin më të mirë të mundshëm, lidhur me largësinë dhe kërkesat teknike të centralit, në qoftë se sistemi i rrjetit nuk ka një pikë tjetër lidhjeje më të favorshme. Në zgjedhjen e kësaj pike më të mirë dhe më të përshtatshme, operatori i sistemit të rrjetit duhet të marrë në konsideratë kufizimet teknike apo dhe eficiencën teknike të pikës ku do të realizohet lidhja.

Po i njëjti nen (paragrafi 2), operatorët e sistemit të rrjetit, me kërkesën e prodhuesit që ka përparësi,

bëjnë lidhjen e centralit me pikën e tij në sistem, në variantin më të mirë të mundshëm për prodhuesin me përparësi nga vendndodhja e centralit, duke përmbushur kërkesat teknike të centralit, në qoftë se sistemi i rrjetit nuk ka një pikë tjetër lidhjeje më të favorshme.

Nuk ka raste të tilla, sepse legjislacioni aktual kërkon që përpara se të jepet një koncesion ose një autorizim për ndërtimin e një gjeneruesi të ri të energjisë elektrike, nga OST-ja ose OSSH-ja duhet të sigurohet një pikë lidhjeje me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes.

Sipas ligjit Për sektorin e energjisë (neni 28) çdo kosto e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe/ose shpërndarjes të një prodhuesi energjie elektrike, përfshirë prodhuesit e energjisë elektrike me BRE, do të përballohet nga prodhuesi. Procedurat e lidhjes janë të përcaktuara nga kodet e transmetimit ose të shpërndarjes. Neni 27 i ligjit për sektorin e energjisë parashikon se çdo lidhje e re do të bëhet në bazë të rregullave dhe procedurave të propozuara nga i licencuari dhe të miratuara nga ERE, ku përfshihet metodologjia e përllogaritjes së kostos dhe marrëveshja standarde e lidhjes në rrjet.

Megjithatë, ligji i ri për burimet e rinovueshme (neni 11) parashikon që operatorët e sistemit të rrjetit duhet të optimizojnë, të zgjerojnë dhe të përmirësojnë sistemin për lidhjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga centralet e reja, që përdorin burime të rinovueshme energjie, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, master-planet e operatorëve të sistemit për zgjerimin e sistemit të rrjetit apo çdo dokument zyrtar në fuqi. Këto plane për optimizimin, zgjerimin dhe rikonstruksionin e sistemit të rrjetit, kur është e përshtatshme, duhet të përfshijnë edhe kapacitetet e interkoneksionit, rrjeteve inteligjente dhe kapacitetet akumuluese, me qëllim që të sigurojnë operimin e operatorit të rrjetit, si dhe përshtatjen e zhvillimeve të mëtejshme për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë.

I njëjti nen specifikon që operatorët e sistemit të rrjetit duhet të hartojnë dhe të bëjnë publike rregullat standarde për mbajtjen dhe ndarjen e kostove të përshtatjeve teknike, si p.sh. lidhjet e rrjetit dhe përforcimi i rrjetit, përmirësimi i funksionimit të rrjeteve, dhe rregullat për zbatimin pa diskriminim të kodeve të rrjetit, të cilat janë të nevojshme për të integruar prodhuesin e ri në rrjetin kombëtar. Këto rregulla duhet të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese që marrin parasysh të gjitha kostot dhe përfitimet që vijnë nga lidhja e prodhuesve me rrjetin, si dhe rrethanat e veçanta të prodhuesve që ndodhen në rajone periferike dhe në rajone me dendësi të ulët popullsie. Rregullat standarde rreth mbajtjes dhe ndarjes së kostove do të miratohen nga ERE.

Çdo shpenzim që bëjnë operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes për përmirësimin e sistemeve përkatëse me qëllim mundësimin e lidhjes së prodhuesve të rinj të energjisë elektrike me BRE pasqyrohet në tarifat e tyre të transmetimit dhe shpërndarjes të miratuara nga ERE, nëse investimi për këto përmirësime është miratuar më parë nga ERE.

Kostot që pësojnë prodhuesit e energjisë elektrike për lidhjen në rrjet përballohen nga ata. Siç përmendet më sipër, ligji i ri për burimet e rinovueshme autorizon ERE-n të zhvillojë rregulla standarde, përfshirë ndarjen e kostove, ndërmjet prodhuesve të energjisë elektrike me BRE dhe operatorit të rrjetit. Megjithatë, këto rregulla specifike nuk janë hartuar dhe miratuar ende.

Nuk ekzistojnë rregulla të tilla për kostot lidhur me përmirësimin e rrjetit. Nëse një investim për lidhjen e një prodhuesi të ri energjie elektrike bëhet nga investitori privat, çdo lidhje e prodhuesve të tjerë që përdorin këtë investim do të jetë objekt i një marrëveshjeje private ndërmjet dy prodhuesve. Rregullat specifike për ndarjen e kostos së lidhjes në rrjet, siç kërkohet nga ligji për energjitë e rinovueshme, mund të përfshijë dispozita që trajtojnë lidhjen e këtij prodhuesi në një lidhje të një centrali ekzistues, të përfshirë tashmë nga prodhuesi i parë.

Aktualisht lidhja e prodhuesve të rinj me BRE bëhet sipas rregullave specifike të përfshira në kodin e transmetimit dhe shpërndarjes, por në legjislacionin parësor nuk ekziston asnjë dispozitë e veçantë për këtë qëllim. Ligji për energjitë e rinovueshme (neni 11/3) parashikon se, me kërkesën e prodhuesve që kërkojnë lidhje në sistemet e rrjetit, operatorët e sistemit të rrjetit do t'u japin atyre informacionin e plotë dhe të nevojshëm, ku përfshihen:

- Vlerësimi gjithëpërfshirës dhe i detajuar i kostove për lidhjen fizike me rrjetin;
- Afati kohor i arsyeshëm dhe i saktë për

marrjen dhe përpunimin e kërkesës për lidhje me rrjetin;

- Afati kohor i arsyeshëm për çdo lidhje të propozuar në rrjet.

- Të gjitha këto kërkesa do të jenë gjithashtu pjesë e kodeve përkatës ose të rregulloreve të tjera të veçanta që miratohen nga ERE.

4.4.5 Funksionimi i rrjetit të energjisë elektrike

Ligji i ri për sektorin e energjisë (neni 29) parashikon se operatorët e sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes garantojnë akses në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Po i njëjti nen parashikon se Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.

Ligji i ri për burimet e rinovueshme (neni 11/7) parashikon që transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet energjie të rinovueshme, janë të garantuara, përveç situatave të emergjencës të përcaktuara në ligjin Për sektorin e energjisë ose në kodet e transmetimit dhe shpërndarjes. Gjatë dispecerimit të centraleve gjeneruese të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit do t'u japë përparësi instalimeve gjeneruese të energjisë elektrike për aq sa e lejon funksionimi i sigurt i sistemit kombëtar të energjisë elektrike dhe bazuar në kritere transparente dhe jodiskriminuese.

Aktualisht, të gjithë prodhuesit ekzistues të energjisë elektrike në Shqipëri mbështeten në energji hidro, për rrjedhojë nuk i jepet asnjë përparësi instalimeve gjeneruese. Për më tepër, operimi i sistemit të transmetimit kryhet nga një operator i pavarur i sistemit të transmetimit, i cili i dispeceron prodhuesit bazuar në rregullat e tregut.

Sa për prodhuesit e lidhur me rrjetin e shpërndarjes, legjislacioni ekzistues garanton aksesin e tyre në rrjet, përveç rastit kur ekziston ndonjë problem sigurie me funksionimin e rrjetit.

Kufizimet/ndërprerjet e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme janë evidentuar në rastet kur operatori i sistemit të shpërndarjes ka qenë i detyruar për arsye teknike të shkëpusë një zonë të largët ku ndodhet dhe ku është lidhur prodhuesi i vogël me energji hidrike. Qeveria shqiptare ka përgatitur një kontratë blerjeje për HEC-et e vegjël bazuar në parimin "merre ose paguaje", e cila do të garantojë prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike që në rast kufizimi/ndërprerje nga operatori i rrjetit pa një arsye teknike ata do të kompensohen për prodhimin e reduktuar.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe të implementimit të masave të përshkruara më sipër. Ky ent rregullator është gjithashtu përgjegjës për miratimin e legjislacionit dytësor për funksionimin e rrjetit.

Të gjitha impiantet e energjisë me BRE janë të integruar në tregun e energjisë elektrike. Tregu i energjisë elektrike është projektuar sipas modelit shqiptar të tregut të miratuar nga VKM nr. 338, datë 19.3.2008. Ky model tregu kërkon që e gjithë energjia elektrike e prodhuesit të shpërndarë (HECV) të blihet nga blerësi me një tarifë të rregulluar promovuese të miratuar nga ERE. Në të njëjtën kohë, nga ERE është miratuar një marrëveshje standarde për blerjen e energjisë elektrike (MBE) për këto HECV. Megjithatë, modeli parashikon gjithashtu mundësinë që HECV-të ta shesin energjinë e tyre në treg me çmimet e tregut, nëse ata preferojnë kështu.

Shqipëria ka miratuar një ligj të ri për sektorin e energjisë (ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015), dhe një legjislacioni dytësor duhet të zhvillohet për të implementuar këtë ligj të ri, duke përfshirë edhe një model të të ri të tregut dhe rregullave të reja të tregut. Duke qenë se ligji i ri heq konceptin e Furnizuesi Publik me Shumicë, një entitet i ri pritet të emërohet si një marrës i energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me BRE.

Nga ana tjetër, prodhuesit e energjisë elektrike (PPE), që nuk plotësojnë kushtet për të marrë një tarifë promovuese për t'ia shitur energjinë elektrike marrësit, mund tia shesin energjinë elektrike OSSH-së me çmime të negociushme për të mbuluar humbjet e shpërndarjes ose ta shesin në energjinë e tyre në tregun konkurrues të brendshëm ose ta eksportojnë atë jashtë vendit duke përdorur të drejtën e aksesit në sistemin e transmetimit.

Të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike kërkohet që të jenë të licencuar nga ERE-ja dhe të regjistrohen tek operatori i tregut, si dhe të paguajnë një garanci financiare. Këto kërkesa janë të njëjta për të pjesëmarrësit në treg dhe nuk ofrohet trajtim preferencial për prodhuesit e energjisë elektrike nga BRE-ja.

Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike parashikon që tregu i energjisë elektrike duhet të stabilizohet në Shqipëri, me qëllim për të rritur më tej transparencën dhe konkurrencën në tregun me shumicë. Tregu ditë-përpara do të krijojë më shumë mundësi tregut për impiantet me BRE-në sidomos për ata që nuk kanë të drejtë për një tarifë promovuese.

Në bazë të metodologjive të tarifimit të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe sipas rregullave të tregut të miratuara nga ERE, tarifa e transmetimi ose shpërndarjes në tregun vendas paguhet sipas ngarkesës dhe jo nga prodhuesit. Nuk ka plane për futjen e një tarife shpërndarje ose transmetimi për prodhuesit e energjisë elektrike, përfshirë edhe ata me impiante RES, në të ardhmen e afërt.

4.4.6 Zhvillimi i infrastrukturës së ngrohjes dhe ftohjes rajonale

Vendi nuk ka asnjë infrastrukturë ngrohjeje ose ftohjeje në distancë dhe asnjë legjislacion specifik për ngrohjen ose ftohjen në distancë nuk është miratuar ose pritet të miratohet.

4.4.7 Biokarburantet dhe biolëngjet e tjera-kriteret e qëndrueshmërisë dhe verifikimi i përputhshmërisë

Pjesa në vijim e planit kombëtar të veprimit duhet të shpjegojë strategjinë e ardhshme të Palët Kontraktuese për plotësimin e kritereve të qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngjet dhe verifikimin e përputhshmërisë me skemën.

Në shkurt të vitit 2008, Shqipëria miratoi një ligj të veçantë për biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse të rinovueshme për përdorim në transport (ligji nr. 9876, datë 14.2.2008). Qëllimi i këtij ligji është të promovojë prodhimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme të përdorura për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës në sektorin e transportit, në mënyrë që të kontribuojë në përmbushjen e angazhimeve të vendosura në kuadër të Protokollit të Kiotos, për ndryshimet klimatike, si edhe të sigurojë mjete dhe të promovojë burimet e rinovueshme të energjisë nëpërmjet futjes dhe kultivimit të kulturave bujqësore për energji dhe mbrojtjen e mjedisit. Ligji transpozon direktivën e mëparshme të BE-së, Direktivën 2003/30/EC të 8 majit 2003 për promovimin e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme të përdorura për transport. Megjithatë, ligji aktual nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që përcakton kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolikuidet.

Qeveria shqiptare është në procesin e zhvillimit të një ligji të ri për biokarburanteve për transpozimin e Direktivës 2009/28/EC. Ligji i ri pritet përmbajë një numër dispozitash lidhur me kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolikuidet të prodhuara ose tregtuara në tregun shqiptar.

Ligji për biokarburantet ka vendosur objektiva specifikë për përdorimin e biokarburanteve në sektorin e transportit, dhe sipas ligjit të ri për burimet e rinovueshme këta objektiva do të integrohen në objektivin e përgjithshëm të energjive të rinovueshme në konsumin total final të energjisë në vend. Çdo përputhje me objektivat e vendosur nga ligji për konsumin e biokarburanteve dhe PKVER do të monitorohet nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial që është pasardhësi i ish-Inspektoratit Qendror Teknik.

Sipas ligjit të ri për burimet e rinovueshme, Plani Kombëtar i Veprimit për Energjitë e Rinovueshme që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, do të monitorohet nga agjencia përgjegjëse për burimet e energjisë së rinovueshme, e cila pritet të ketë autoritetin dhe kompetencat për monitorimin e përputhshmërisë me objektivat e vendosur për të gjitha burimet e rinovueshme, përfshirë biokarburantet.

Ndërsa ligji aktual për burimet e rinovueshme nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë për kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolikuidet, projektligji i ri për biokarburanteve do të inkorporojë kritere të tilla që transpozojnë Direktivën 2009/28/EC. Në të njëjtën kohë, projektligji i ri për biokarburantet do t'i kërkojë Agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme që në bashkëpunim me autoritetet respektive përgjegjëse për bujqësinë dhe pyjet të monitorojë dhe verifikojë pajtueshmërinë e prodhuesve të biokarburanteve me kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në ligj.

Agjencia Kombëtare për Burimet Natyrore, që është përgjegjëse për burimet e rinovueshme, siç parashikohet nga ligji i rishikuar për burimet e rinovueshme, do të ketë përgjegjësinë për monitorimin dhe verifikimin e pajtueshmërisë me kriterin e qëndrueshmërisë. Kjo Agjenci pritet të mbështetet nga autoritetet përgjegjës për bujqësinë dhe pyjet bazuar në ligjin e ri për ndarjen

administrative dhe teritoriale.

Zonat e mbrojtura, të përcaktuara sipas ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", administrohen nga autoriteti përkatës shtetëror, i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi nga lloji dhe natyra e zonës së mbrojtur. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe funksionimi i administrimit të çdo kategorie të zonës së mbrojtur, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

MM, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, mund të marrë përsipër administrimin e zonave të mbrojtura, duke përfshirë edhe marrjen nën kujdesin e saj të organit administrativ përkatës për këtë administrim.

MM-ja përcakton mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura në terren dhe në harta. Për të shënuar zonat e mbrojtura do të përdoret emblema e Republikës së Shqipërisë. MM-ja njofton organet përkatëse gjeodezike dhe të hartografisë për deklarimet, ndryshimet ose heqjen e statusit të zonës së mbrojtur. Zonat e mbrojtura regjistrohen në sistemin qendror të arkivimit të Ministrisë së Mjedisit, i cili është krijuar duke përdorur të dhënat e institucioneve shtetërore përkatëse dhe të institucioneve të tjera të specializuara.

MM-ja formulon dhe miraton rregullat për krijimin, funksionimin dhe përdorimin e sistemit qendror të arkivimit. Sistemi qendror i arkivimit të zonave të mbrojtura është i hapur për publikun dhe çdokush mund ta përdorë atë me lejen dhe në praninë e një nëpunësi të autorizuar.

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura" ofron mbrojtje të veçantë për disa elemente të rëndësishme të natyrës dhe të biodiversitetit. Ky ligj i klasifikon zonat e mbrojtura në gjashtë kategori, si më poshtë:

a) rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor – Kategoria I

b) parqet kombëtare – kategoria II

c) monumentet natyrore – kategoria III

d) rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve – kategoria IV

e) peizazh i mbrojtur – kategoria V

f) zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara – Kategoria VI

Kategorizimi i zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë mbështetet në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës.

Për secilën kategori, legjislacioni siguron një nivel të caktuar mbrojtjeje. Kategoritë e zonave të mbrojtura përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e tyre.

Neni 4/3 i ligjit, parashikon gjithashtu që zonat ku mund të vendosen lloje habitatesh natyrore me interes për Komunitetin Evropian, si dhe habitate të tjera me interes për këtë komunitet, deklarohen zona me ruajtje të veçantë. Këto zona janë pjesë e rrjetit ekologjik kombëtar dhe mund të përfshijnë zonat e mbrojtura, si dhe ekosistemet, habitatet dhe peizazhet jashtë këtij rrjeti. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton listën e zonave shqiptare me interes për Komunitetin Evropian.

Ligji parashikon që zonat e mbrojtura deklarohen territore tokësore, ujore, detare dhe bregdetare të caktuara për mbrojtjen e biodiversitetit, të veçorive kulturore dhe natyrore, shoqërore, të cilat menaxhohen me mjete ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore.

Neni 15 i ligjit parashikon që Ministria e Mjedisit, organet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore ose në bashkëpunim me të tretët, hartojnë për secilën zonë të mbrojtur planet e menaxhimit të kësaj zone. Planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura do të përfshihen në politikat, planet dhe programet qeveritare që lidhen me to, si dhe në vendimmarrjen në nivele kombëtare, rajonale ose lokale.

Procedurat për ndryshimin e statusit të tokës bujqësore parashikohen nga VKM-ja nr. 665, datë 28.7.2010, "Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", dhe VKM-ja nr. 410, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", që përmbajnë një numër kërkesash për çdo kërkesë lidhur me ndryshimin e statusit të tokës. Procesi përfshin disa institucione, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Pyjeve dhe Ministrinë e Mjedisit në rastet e ndryshimit të statusit të tokës pyjore.

Vendimi për ndryshimin e statusit të tokës bëhet nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për ndryshimin e statusit nga tokë bujqësore në tokë pyjore, në kullotë ose livadh dhe me anë të një vendimi të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Mjedisit për ndryshimin e statusit nga tokë pyjore, kullotë ose livadh në tokë bujqësore.

Statusi i mbrojtjes për një zonë të mbrojtur hiqet ose ndryshohet kur rrethanat ose objektivi për dhënien e këtij statusi ka ndryshuar. Dhënia fund e statusit të një zone të mbrojtur bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë së Mjedisit, pas marrjes së mendimeve nga institucionet e specializuara, nga autoritetet e qeverisë vendore, nga organizatat jofitimprurëse dhe nga pronarët, kur pronat e tyre janë pjesë e zonës së mbrojtur.

Në propozimin për heqjen e statusit të një zone të mbrojtur duhet të përfshihet:

a) argumentimi për heqjen e statusit;

b) vlerësimi i ndikimit në mjedis që pasqyron ndikimin në kategorizimin ekzistues të zonës së mbrojtur, në biodiversitetin dhe popullatat ose bashkësitë vendore;

c) përshkrimi i masave zbutëse;

d) rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe këshillimit me grupet e interesit të shoqërisë civile, veçanërisht me popullatat ose bashkësitë brenda dhe përreth zonës së mbrojtur, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve të marra dhe reflektimin në propozim.

Nuk është përcaktuar asnjë afat kohor nga legjislacioni për përditësimin e regjistrit (kadastral) të zoonimit të tokës, por megjithatë, legjislacioni kërkon nga Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në ndarjen e re territoriale dhe administrative do ta përditësojnë dokumentacionin kadastral për territorin nën juridiksionin e tyre dhe ato janë gjithashtu të detyruara që të informojnë zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për çdo ndryshim të kategorive të tokës, të cilat mund të miratohen sipas kërkesave dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.

Përgjithësisht, legjislacioni shqiptar kërkon që lëndët e para që përdoret në bujqësi të përmbushin praktikat e mira agraro-mjedisore. Përdorimi i lëndëve të para në bujqësi rregullohet nga ligji nr. 7659, datë 12.1.1993, "Për farat dhe fidanët". Për qëllimet e kontrollit të cilësisë për materialin mbjellës bimor dhe për ruajtjen e materialit gjenetik është ngritur Enti Shtetëror i Farave dhe i Fidanëve, i cili është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Enti Shtetëror i Farave dhe i Fidanëve është i vetmi organ qeveritar i autorizuar për licencimin e importimit ose të eksportimit të çdo lloj materiali mbjellës bimor.

4.5 Përdorimi i planifikuar i transferimeve statistikore ndërmjet shteteve anëtare dhe pjesëmarrja e planifikuar në projektet e përbashkëta me shtetet e tjera anëtare dhe me vendet e treta

Nën këtë nënkapitull, duhet përshkruar përdorimi i parashikuar i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta si Shqipëria. Ky informacion duhet të mbështetet në atë që jepet në dokumentin e parashikimit, të referuar në nenin 4(3) të direktivës 2009/28/EC.

4.5.1 Aspektet procedurale

Vlerësimi i saktë, i besueshëm dhe në kohë i kapaciteteve prodhuese është thelbësor për aftësinë e Shqipërisë që të ofrojë nga ana statistikore "prodhim me tepricë" për shtetet anëtare, duke marrë në konsideratë përqindjen e detyrueshme të energjive të rinovueshme në konsumin e energjisë.

Përcaktimi i procedurave kombëtare kërkon krijimin e një regjistri të përditësuar dhe të mirë-koordinuar të konsumit final bruto të energjisë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe ndjekjen e besueshme të zbatimit të projekteve të energjive të rinovueshme. Në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, prodhimi dhe konsumi bruto nga burimet e rinovueshme të energjisë caktohet mbi bazën e garancive/certifikatës të origjinës. Momentalisht në Shqipëri nuk ka ende një treg për garancitë / certifikatat e origjinës (p.sh., si pjesë të shitjeve të certifikatave të energjisë elektrike të gjelbër (të prodhuar nga burime të rinovueshme). Promovimet e detajuara të garancisë/certifikatës së origjinës sipas ligjit të ri për BRE-të paraqiten në nenet 19, 20, 21.

1.1.1.4 Certifikata e garancisë së origjinës

ERE, me kërkesën e një prodhuesi që ka marrë nga ERE kualifikimin paraprak teknik për centralin me energji të rinovueshme sipas dispozitave të rregullores së referuar në paragrafin 10 të këtij neni, do të lëshojë një certifikatë garancitë origjinës për energjinë elektrike ose nxehtësinë të gjeneruar nga një impiant prodhues. Garancitë e origjinës do të jenë për madhësinë standarde prej 1 MWh dhe do të specifikojnë:

- Burimet e energjisë nga të cilat është prodhuar energjia elektrike, të renditura sipas llojit dhe komponentëve kryesorë, duke përfshirë informacionin se deri në çfarë mase energjia elektrike është prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë;

- Përqindjen ekskluzive të biomasës, aty ku është përdorur biomasa;
- Emrin dhe adresën e prodhuesit;
- Vendndodhjen, kapacitetin dhe datën e vënies në punë të impiantit;
- Periudhën gjatë së cilës është prodhuar energjia dhe deri në çfarë mase është paguar në përputhje me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji; si dhe
- Vendin e lëshimit dhe numrin unik të identifikimit.

ERE do të mbikëqyrë lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të origjinës në përputhje me dispozitat e rregullores së nxjerrë në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni.

Garancitë e origjinës lëshohen bazuar në të dhënat gjithëpërfshirëse dhe tek informacioni i duhur për të certifikuar origjinën e energjisë elektrike të ofruar nga Prodhuesi, si dhe te të dhënat e certifikuara të matjes nga operatori i sistemit të rrjetit. Garancitë e origjinës lëshohen vetëm nëse Prodhuesi ofron të gjithë informacionin e kërkuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Çdo përdorim i garancisë së origjinës bëhet brenda 12 muajve të prodhimit të njësisë përkatëse të energjisë. Garancia e origjinës anulohet pasi është përdorur.

Nëse energjia elektrike është prodhuar nga një hidrocentral me sistem reversibël pompimi, Garancitë e origjinës lëshohen vetëm për sasinë e energjisë që i korrespondon diferencës ndërmjet energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali dhe energjisë elektrike të konsumuar nga sistemi i reversibël me pompim.

Nëse energjia elektrike është prodhuar nga biomasa, Garancia e origjinës lëshohen vetëm për përqindjen e energjisë që i korrespondon pjesës së biodegradueshme, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 3 të këtij ligji.

Brenda një periudhe 12-mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE do të ngrejë një regjistër elektronik të Garancive të origjinës me një mekanizëm të përshtatshëm për përpunimin e të dhënave për të siguruar që Garancitë e origjinës të lëshohen, të transferohen dhe të anulohen në mënyrë elektronike dhe të jenë të sakta, të besueshme dhe të mos jenë objekt mashtrimesh. Çdo palë e interesuar fiton të drejtën për të pasur akses lirisht në këtë regjistër.

Brenda së njëjtës periudhë të përmendur në paragrafin 8 të këtij neni, ERE do të miratojë një rregullore specifike për procedurën që zbatohet për Garancitë e origjinës. Rregullorja parashikon në mënyrë të veçantë:

Dokumentacionin që duhet dorëzuar nga Prodhuesi për kualifikimin teknik të instalimit të tij si një central prodhues i energjisë elektrike ose i nxehtësisë nga burimet e rinovueshme të energjisë.

Procedurën teknike të kualifikimit dhe veçanërisht afatin kohor brenda të cilit ERE duhet t'u përgjigjet aplikimeve të dorëzuara, si dhe pasojat ligjore nga moszbatimi i këtij detyrimi.

1.1.1.5 Procedura e monitorimit

Procedurën që zbatohet për lëshimin, regjistrimin, transferimin ose anulimin e Garancive të origjinës.

Çështjet që lidhen me bashkëpunimin me autoritetet kompetente të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të tjera me të cilat është nënshkruar një marrëveshje për njohjen reciproke të garancive të origjinës. ERE është përgjegjëse për ndryshimin e rregulloreve të mëparshme lidhur me procedurën që zbatohet për garancitë e origjinës për të pasqyruar dispozitat e parashikuara nga paragrafi 9 i këtij neni.

1.1.1.6 Procedura e monitorimit dhe ndalimi i shitjeve të shumëfishta

Për të siguruar që kushtet për lëshimin e Garancive të origjinës janë plotësuar dhe që të dhënat dhe informacioni mbi të cilat bazohet lëshimi i tyre janë të sakta, përfaqësuesit e ERE-s dhe çdo person i autorizuar praj saj, kanë të drejtë aksesi të lirshëm në impiantin përkatës të prodhimit dhe te të gjitha të dhënat dhe informacioni që lidhet me këtë impiant, pa cenuar respektimin e sekreteve të biznesit. Prodhuesi është i detyruar të lehtësojë punën e përfaqësuesve të ERE-s dhe të personave të autorizuar prej saj.

Energjia elektrike dhe nxehtësia e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe nga gazi i landfilleve ose nga gazi i trajtimit të ujërave të zeza të hedhur në rrjetin e gazit, nuk mund të shitet apo transferohet më shumë se një herë. Si rezultat, Prodhuesi paguhet me tarifa ligjore promovuese dhe nuk do të lejohet të transferojë ose të shesë asnjë Garanci të origjinës për këtë energji elektrike. Në rast se Prodhuesi e delegon këtë Garanci të origjinës për energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, për këtë energji elektrike

mund të mos paguhet asnjë tarifë ligjore promovuese (*feed-in tariff*) dhe Prodhuesi mund të humbë përfitimet nga tarifat ligjore promovuese.

1.1.1.7 Bashkëpunimi ndërkombëtar për Garancitë e origjinës

Garancia e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë, që lëshohet nga një shtet që është Palë Kontraktore ose shtet anëtar i një Pale Kontraktore të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, njihet gjithashtu në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave ose ministria përgjegjëse për energjinë mund të lidhë marrëveshje me një nga shtetet anëtare të BE-së ose me një palë kontraktore të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore për njohjen reciproke të Garancive së origjinës për qëllimet e matjes së pajtueshmërisë me kërkesat e nenit 4 të këtij ligji për objektivat e përgjithshëm kombëtarë për burimet e rinovueshme të energjisë.

Garancitë e origjinës lëshohen/regjistrohen nga ERE dhe ky mekanizëm mjafton për të përcaktuar prodhimin e energjisë së rinovueshme si pjesë e konsumit final bruto të energjisë elektrike.

Më e vështirë është të përcaktohet kontributi i madh i energjisë së biomasës në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes. Duke marrë parasysh pjesën e madhe të konsumit të biomasës drusore për qëllime ngrohjeje, vlerësimi i pjesës së burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin final të energjisë në këtë sektor kërkon informacion për:

- furnizimin total direkt me biomasë drusore (nga pyjet e menaxhuara);
- furnizimin total direkt me biomasë drusore nga mbledhjet në mënyrë individuale të fshatarëve;
- furnizimin total me biomasë nga mbetjet industriale (nga industria e përpunimit të drurit dhe e mobilieve, repartet e sharrave, industria e përpunimit të brumit të letrës dhe letrës, nga riciklimi i drurit);
- biomasën totale të ricikluar/të mbetur/të rigjeneruar;
- vlerësimin e vlerave bruto kalorifike të komponentëve alternativë të biomasës.
- prodhimin total të biomasës nga kulturat bujqësore energjetike;

Për këtë qëllim, duhet të garantohet bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Institutit të Statistikave (INSTAT).

Bazuar në informacionin e mësipërm, mund të përcaktohet përmbajtja energjetike totale nga prodhimi total i biomasës krahasuar me përmbajtjen energjetike totale përkatëse të lëndëve djegëse të përdorura për ngrohje. Pavarësisht ekzistencës së shumëllojshmërisë së madhe të teknologjive të djegies me eficiencë të lartë, mund të supozohet se në një përdorim të caktuar, përmbajtja energjetike totale e përdorshme e biomasës do të ishte e barabartë me atë të lëndëve djegëse të zakonshme, d.m.th. biokarburantet zëvendësojnë drejtpërdrejt të njëjtën sasi të energjisë konvencionale.

ERE dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore do të mbajnë një bazë të dhënash kombëtare për energjinë elektrike, për të gjitha të dhënat statistikore që lidhen me burimet e energjisë të përshkruara më lart. Garancitë statistikore të origjinës do të lëshohen për çdo 1 MWh (0,086 toe) të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë në sektorët e transportit dhe të ngrohjes, ashtu si dhe ato për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë. Këto garanci origjine do të jenë të disponueshme për tregtim me shtetet anëtare të BE-së.

Zbatimi i projekteve të energjive të rinovueshme mund të kombinohet me zbatimin e masave për eficiencën e energjisë bazuar në PKVEE-në, tashmë të miratuar nga qeveria shqiptare më 9 shtator 2011. Duke pasur parasysh potencialin e vendit për zbatimin e masave për eficiencën e energjisë, një kriter i rëndësishëm në përzgjedhjen e projekteve që kualifikohen për financim do të jetë pjesëmarrja e sipërmarrjeve që bëjnë përmirësime në eficiencën e energjisë, p.sh., sipërmarrjet me kërkesë të madhe për energji, ndërtesat e mëdha dhe tregtuesit e energjisë. Një avantazh tjetër do të ishte ekzistenca e një raporti auditimi për energjinë që të përmbante informacione për avantazhet ekonomike të masave për eficiencën e energjisë, duke lejuar kryerjen e një vlerësimi nëse këto masa duhet të bashkohen ose jo me masat për energjitë e rinovueshme.

Kontratat me rezultate të garantuara, së bashku me financimin e granteve për masa shtesë nga buxheti i shtetit, investitorët privatë dhe nga

programet operacionale, do të përbëjnë një mekanizëm të përshtatshëm.

Shqipëria është e gatshme të marrë pjesë në projekte të përbashkëta me shtetet anëtare. Pas miratimit të ligjit për BRE-të, ERE duhet të përgatisë tarifat promovuese (*feed*-in) për impiantet e bashkëprodhimit që përdorin energjinë nga biomasa.

1.1.1.8 Teprica e llogaritur e prodhimit të energjive të rinovueshme që mund të transferohet në shtetet e tjera anëtare, krahasuar me trajektoren treguese

Në skenarin më të favorshëm për zhvillimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, i ndërthurur me një politikë të fortë për eficiencën e energjisë, potenciali i Shqipërisë për transferime statistikore në shtetet e tjera anëtare është i madh, veçanërisht bazuar në idenë se do të nevojiteshin vetëm centrale elektrike me erë (parqe eolike) me kapacitet 100-120 MW për të mbuluar objektivin BRE. Potenciali i erës është rreth 1500 MW, ashtu siç do të përmendet në seksionin në vijim, dhe e gjithë diferenca do të jetë e gatshme për qëllime eksportimi.

1.1.1.8.1 Potenciali i llogaritur për projektet e përbashkëta

Ekzistojnë një numër i madh mundësish për zhvillimin e projekteve për përdorimin e energjive të rinovueshme në Shqipëri. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë gjen një mbështetje të fortë në legjislacionin kombëtar dhe ka një sërë investitorësh nga Bashkimi Evropian. Një numër projektesh kanë përfunduar tashmë, ndërkohë që të tjerë janë në proces përgatitjeje. Ka një sërë mundësish për projekte të përbashkëta në këtë sferë, në diapazonin deri në 3000 MW kapacitet të instaluar (kryesisht energji hidrike, nga era, nga biomasa dhe energji diellore).

Megjithatë, kushtet ekonomike në Shqipëri kërkojnë kombinimin e politikave për promovimin e përdorimit të energjive të rinovueshme me politikën e promovimit të prodhimit të nxehtësisë, e cila është shumë më efikase nga pikëpamja e përdorimit parësor të energjisë dhe kërkon më pak investime relative. Kostot e furnizimit dhe të transformimit do të ishin gjithashtu më të ulëta duke qenë se prodhimi do të ishte më afër konsumit. Ekzistojnë një sërë mundësish:

- një program me shkallë të gjerë për të promovuar përdorimin e paneleve diellore për ngrohjen e ujit, duke reduktuar kështu përdorimin e energjisë elektrike. Vlen të përmendet se Programi i PNUD-it për Ndryshimet Klimatike, i mbështetur nga FGM dhe qeveria shqiptare, është duke punuar që prej dy vjetësh për promovimin e kësaj teknologjie si një nga shfrytëzimet më të rëndësishme të BRE-ve për mbulimin e kërkesës për ujë të ngrohtë, shoqëruar me reduktim të gazeve me efekt serrë;

- djegia e kombinuar e lëndëve djegëse fosile dhe e biomasës për ngrohjen qendrore/rajonale në ndërtesat publike;

- zgjerimi i prodhimit të ashklave të drurit nga shfrytëzimi i mbetjeve të drurit, me idenë e zëvendësimit të instalimeve për prodhimin e nxehtësisë në industri dhe në ndërtesat e shërbimeve publike.

- Qeveria shqiptare është duke zbatuar gjithashtu një projekt për zëvendësimin e lëndëve djegëse fosile me burime të rinovueshme energjie për ngrohje/ngrohjen e ujit në ndërtesat publike. Ky projekt i mbështetur nga KfW "Promovimi i eficiencës së energjisë i burimeve të rinovueshme të energjisë në Shqipëri" është zbatuar tashmë si projekt pilot në tre raste dhe po planifikon të investojë rreth 5 milionë euro të tjera në ndërtesa të ndryshme publike. Kaldajat aktuale që punojnë me lëndë djegëse mund të zëvendësohen plotësisht me impiante që përdorin biomasë të ngurtë, biogaz ose biokarburante për plotësimin e kërkesës për energji për ngrohjen e ambienteve, dhe nga kolektorët diellorë për plotësimin e kërkesës për ujë të ngrohtë.

Po, një teknologji e përshtatshme për ngrohjen e banesave është ajo e bazuar te djegia e biomasës së ngurtë të papërpunuar (p.sh., ashklat dhe paletat e drurit) në kaldajat me kapacitet të instaluar prej 0,1 deri në 0,3 MW. Numri i saktë i instalimeve të mundshme do të përcaktohet në dy vitet e ardhshme kalendarike pas përgatitjes së regjistrit të kaldajave me ujë të ngrohtë në territorin e Shqipërisë, ashtu siç kërkohet nga projektligji për eficiencën e energjisë. AKBN-ja do të fillojë përgatitjen e një regjistri të tillë brenda dy viteve të ardhshme.

Pjesa më e madhe e mbetjeve nga bujqësia, nga industria përpunuese ushqimore dhe prerja e drurëve mund të përpunohen duke u kthyer në ashkla dhe në briketa druri. Aktualisht, këto

mundësi nuk janë shfrytëzuar për shkak të çmimit të lartë të ashklave dhe çmimit relativisht të ulët të druve të zjarrit që përdoren gjerësisht nga familjet. Sipas vlerësimeve, rreth një e treta e apartamenteve në Shqipëri përdorin biomasë drusore për ngrohje, një pjesë e madhe e së cilës është e papërpunuar. Ky treg po zgjerohet vazhdimisht meqenëse familjet refuzojnë të përdorin shërbimet e shtrenjta të kompanive për ngrohje qendrore, të cilat përdorin kryesisht energjinë elektrike dhe GLN-në.

Bashkitë me pyjet e tyre që kanë rritjen e duhur vjetore për të furnizuar kapacitetet e planifikuara, janë të përshtatshme për zbatimin e projekteve të përbashkëta. Financimi mund të sigurohet sipas kontratave për kursimet e garantuara të energjisë dhe sipas programeve operacionale të Bashkimit Evropian. Pronarët e pyjeve ose të fermave të mëdha dhe prodhuesit e kaldajave me biomasë janë pjesëmarrës të ligjshëm për ndërtimin e fabrikave për prodhimin e ashklave dhe të paletave të drurit.

Shqipëria aktualisht nuk ka asnjë projekt të përbashkët me shtete të tjera anëtare lidhur me promovimin e kaldajave me biomasë me eficiencë të lartë energjie. Megjithatë, teknologjitë e përshtatshme nga Gjermania dhe Austria sapo kanë mbërritur gjithashtu edhe në tregun shqiptar.

5. VLERËSIMET

5.1 Vlerësimi i potencialit të disponueshëm për zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në vend

5.1.1 Potenciali i hidrocentraleve (HEC)

Duhet theksuar se në Shqipëri ekziston akoma një potencial i konsiderueshëm hidrik për ngritjen e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë, që do të ndërtohen gjatë viteve të ardhshme. HEC-et e mëposhtme propozohen të merren në konsideratë si kapacitete të reja:

- Rreth nëntë hidrocentrale mesatare dhe të mëdha me kapacitet total të instaluar prej 385 MW, përfshirë HEC-in e Kalivaçit.
- Në lumin Devoll: HEC-i Banjës me 65 MW dhe HEC-i Moglicës me 178 MW
- HEC-e të mesme dhe të mëdha me kapacitet total të instaluar prej 480 MW
- Impiante Ere me kapacitet total të instaluar 30 MW
- Impiante fotovolaltaike me kapacitet total të instaluar 32 MW

5.1.2 Koncesionet për HECV-et

Qysh prej datës 31 dhjetor 2014, qeveria shqiptare, mbështetur në ligjin "Për koncesionet" (miratuar në dhjetor 2006), ka dhënë deri në rreth 120 kontrata koncesionesh (110 janë miratuar tashmë dhe 10 prej tyre janë në fazën finale të diskutimit) për ndërtimin e HEC-eve të kategorive të ndryshme. Aneks I jep numrin në total të koncesioneve, kompaninë përkatëse, kapacitetin e instaluar, prodhimin mesatar vjetor dhe investimin përkatës për çdo kontratë koncesioni. Për të pasur një tablo të qartë ndërmjet HEC-eve të vegjël, mesatarë dhe të mëdhenj, lista totale e HEC-eve është ndarë në tre kategoritë e mëposhtme:

1. Një ose Kaskada e HECV-e me kapacitet total nën 15 MW. Bazuar në përkufizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM), ato konsiderohen si HECV;
2. Kaskada e HECV-e me një kapacitet total mbi 15 MW: Bazuar në përkufizimin e VKM-së, meqenëse secili impiant ka kapacitet nën 15 MW, ato do të konsiderohen si HECV;
3. HEC-et mesatarë dhe të mëdhenj dhe Kaskada e HEC-eve me kapacitet të secilit impiant mbi 15 MW: Bazuar në përkufizimin e VKM-së, meqenëse secili impiant ka kapacitet mbi 15 MW, ato nuk konsiderohen si HECV;

Analiza tregon që numri më i madh i koncesioneve lidhet me grupin e parë dhe të dytë, me një total prej 112 kontratash koncesionare të përfshira në kategorinë e hidrocentraleve të vegjël. Kapaciteti total i instaluar i projektuar është 1740 MW dhe pjesa e HECV-eve është rreth 48% me një kapacitet të instaluar prej 839 MW. Kapaciteti i ri i planifikuar i energjisë përbën një kapacitet të konsiderueshëm nëse e krahasojmë me kapacitetin aktual total të instaluar të HEC-eve në Shqipëri (1426 MW). Gjithashtu, kapaciteti total i parashikuar HECV-të prej 839 MW është shumë më i lartë krahasuar me kapacitetin aktual të instaluar të HECV-eve ekzistuese (25 MW) deri në vitin 2006.

Krahasimi i prodhimit vjetor të parashikuar të energjisë elektrike me prodhimin mesatar vjetor të energjisë elektrike nga të gjithë hidrocentralet ekzistues në Shqipëri (4180 GWh) tregon se potenciali i përgjithshëm i prodhimit të energjisë elektrike është 185% e prodhimit aktual nga hidrocentralet. Grupi i parë mund të sigurojë 84% të mesatares aktuale, ndërkohë që grupet dy dhe tre mund të prodhojnë 45% dhe 55% të prodhimit aktual të energjisë elektrike nga HEC-et.

Lidhur me investimin total për secilin nga grupet e sipërpërmendura, analiza tregon se kërkesa në total për investime është 2471 milionë euro dhe pjesa e këtij investimi që kërkohet për HEC-et e vegjël është rreth 785 milionë euro. Që të dyja këto vlera përbëjnë shuma të konsiderueshme për ekonominë shqiptare në përgjithësi dhe për sektorin e saj bankar në veçanti duke e bërë këtë një sektor shumë atraktiv.

1.1.1.9 HECV në funksionim: njësitë e vjetra të rehabilituara dhe njësitë e reja

Lista totale e HECV-e ekzistuese në funksionim dhe prodhimi i tyre për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 disponohet nga MEI. Në fillim të vitit 2015, numri i HECV-e ekzistuese në funksionim ishte përafërsisht 90 krahasuar me 18 që ishin në funksionim në fillim të vitit 2006.

Lista totale e HECV-e të reja në funksionim, kapaciteti i tyre total i instaluar është i barabartë me 294.32 MW dhe prodhimi i tyre për 2014 (i barabartë me 919 GWh).

1.1.1.10 HECV-të në ndërtim

Numri i kontratave koncesionare për HEC-et e vegjël në ndërtim është përafërsisht 25 dhe 8 prej tyre kanë siguruar kreditë, 15 prej tyre janë në proces negocimi me bankat.

5.2 Potenciali i energjisë nga biomasa

Biomasat e përdorshme për qëllime energjetike mund të klasifikohet në katër kategori kryesore:

- Druri ose mbetjet e tij nga industritë e ndryshme përpunuese të drurit;
- Mbetjet bimore (kërcejtë, farat etj.) pas përfundimit të ciklit të tyre të prodhimit, të cilat nuk përdoren në sektorë të tjerë prodhues;
- Kulturat bujqësore energjetike (drurët) të kultivuara për t'u djegur si biomasë, dhe;
- Mbetjet shtazore (kockat, lëkura, plehu i kafshëve), të cilat nuk përdoren në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Pyjet zënë rreth 36% të sipërfaqes së tokës së Shqipërisë. Disa zona të pyllëzuara janë të përfshira në llogaritjet e tokës së mbuluar me pyjeve, ku gjysma e tyre është klasifikuar si korije dhe shkurre, dhe gjysma tjetër pyje me trungje të larta. Gati 4/5 e drurëve përbëhet nga specie gjethegjerë, ku dominojnë lisi dhe ahu me gjelbërim të përhershëm.

Shqipëria është një nga vendet e pakta evropiane që ka pasur rënie të zonës së mbuluar me pyje gjatë dekadave të fundit, për shkak të pastrimit për bujqësi, kullotja e tepër dhe prerja e materialit drusor për lëndë djegëse, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit (rreth 1990-s). Prerja e pemëve ka tejkaluar rritjen vjetore neto, gjë që sjell si rezultat rënie në stokun pemëve në rritje; ka pasur gjithashtu edhe një rënie në cilësinë e tij si pasojë e prerjeve të jashtëligjshme. Pjesa më e madhe e pyjeve është e disponueshme për furnizimin me lëndë drusore; pjesa tjetër, që është dhe pjesa më e madhe, nuk është në dispozicion për arsye ekonomike. Më shumë se 4/5 e pyjeve klasifikohen si gjysmënatyrorë, ndërsa pjesa tjetër ndahet në pyll të pa prekur nga njeriu dhe plantacione. Vendi zhvilloi një program ripyllëzimi për mbjelljen e pemëve, kryesisht në tokën e vështirë, por aktualisht kjo gjë është ulur për shkak të mungesës së investimeve në këtë fushë. Të gjitha pyjet kanë qenë në pronësi të shtetit, por regjimi i pronësisë mbi tokën po ndryshon duke përfshirë kategoritë e pyjeve private dhe të komunitetit. Aktualisht 47% e pyjeve është në pronësi të bashkive, rreth 51% është në pronësi të shtetit dhe rreth 2% është në pronësi private. Po bëhen përpjekje për të rritur zonën pyjore të mbrojtur për të ruajtur biodiversitetin e pasur dhe peizazhin. Zonat e mbrojtura përbëjnë më shumë se 450 mijë hektarë, dhe ato do të rriten si rezultat i angazhimeve të qeverisë shqiptare.

Nga viti 2004 deri në 2012, hapësira e zonave të mbrojtura shqiptare është rritur tri herë më shumë. Gjatë viteve 1990, dhe pavarësisht nga fakti që menaxhimi i pyjeve u ndikuar veçanërisht nga rënia e papritur e ekonomisë së mëparshme, sektori pyjor nuk marri ndihmë të mjaftueshme. Megjithatë, kapaciteti produktiv i sektorit ka potencial për t'u restauruar në mënyrë që të luajë rol të rëndësishëm në punësimin rural, zhvillimin industrial, dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në kundërshtim me rëndësinë e tij unike për ekonominë e vendit, sektori i pyjeve vazhdon të vuajë nga disa probleme tipike të tranzicionit: rënie e investimeve, dobësim i menaxhimit praktik të pyjeve, mirëmbajtja, mungesa e mbikëqyrjes dhe zbatimit të ligjit. Për rrjedhojë, baza e burimeve ka rënë ndjeshëm për vite me radhë drejt fundit, jo vetëm në drejtim të aspekteve sasiore, por edhe në aspektin e degradimit në shkallë të gjerë të pyjeve. Rritje e drurëve për hektar është prekur ndjeshëm, dhe një sasi e konsiderueshme e lëndës drusore të maturuar, në ditët e sotme, mund të gjendet vetëm

në pjesë fizikisht më të paarritshme të vendit. Njëkohësisht, ristrukturimi ekonomik ka shkaktuar rënien e efikasitetit të prerjes dhe përpunimit të drurit; ndërkohë që prerje të jashtëligjshme kanë çrregulluar çmimet e tregut. Gjithashtu, politikat energjetike të vendit nuk kanë qenë në favor të pyjeve, duke ndikuar negativisht në degradimin e pyjeve.

Në mbarë Shqipërinë, veçanërisht në zonat malore, pyjet shërbejnë si burim jetese dhe të ardhurash. Së pari, drutë e zjarrit që mbledhin fshatarët, pa përmendur një pjesë të mirë të popullsisë në zonat urbane që furnizohen me dru zjarri, kanë rëndësi jetike për ngrohje dhe gatim pothuajse gjatë tërë vitit. Drutë e zjarrit janë një mall i rëndësishëm për Shqipërinë, sepse ato përdoren për ngrohje nga shumica e familjeve, dhe në zonat rurale përdoren edhe për gatim. Ato mbulojnë sot 36% të kërkesës së energjisë për ngrohje dhe 12% të energjisë për gatim. Kjo do të thotë se drutë e zjarrit janë ende burim i domosdoshëm energjie dhe do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm. Grupet më të mëdha të konsumatorëve të druve të zjarrit janë familjet, por institucionet publike, prodhuesit e qymyrdrurit dhe gëlqeres konsumojnë gjithashtu volume të konsiderueshme të druve të zjarrit.

Një nga problemet kryesore të sektorit pyjor është mungesa e të dhënave të sakta në lidhje me stokun e pyjeve (rritja, zvogëlimi i sipërfaqes dhe vëllimi i saj etj.). Kadastra e pyjeve vazhdon të mos pasqyrojë gjendjen reale të pyjeve kombëtare. Nga ana tjetër, nuk ka ndonjë zyrë kadastrale për mbarë vendin, ku të evidentohen/pasqyrohen ndryshimet përkatëse nga përdorimi i tokës së vendit. Hapësira pyjore është një nga treguesit kryesorë të pyllit. Përgjatë viteve, ajo ka pësuar disa ndryshime domethënëse; është zvogëluar dhe në mungesë të një sistemi të të dhënave si rezultat i mos hartimit prej shumë vitesh të planeve te menaxhimit, inventarit kombëtare te pyjeve dhe kullotave dhe sistemit të mbajtjes së të dhënave. Për këtë është në proces me mbështetjen e B. Botërore një projekt identifikimi. Të dhënat e paraqitura në figurat më poshtë janë mbështetur në informacionin e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.



Figura 9: Hapësira pyjore (ha) vjetore për Shqipërinë (Burimi – Ministria e Mjedisit)



Figura 10: Vëllimi vjetor i biomasës pyjore (000 m³) për Shqipërinë (Burimi – Ministria e Mjedisit)



Figura 11: Norma vjetore e rritjes përkatëse (m³/ha në vit) për Shqipërinë (Burimi – Ministria e Mjedisit)



Figura 12: Konsumi vjetor i lëndës drusore si lëndë djegëse (ktoe) për Shqipërinë (Burimi – Bilanci Kombëtar i Energjisë, AKBN)



Figura 13: Krahasim i konsumit vjetor të drurit si lëndë djegëse (ktoe) dhe Rritja vjetore e pyllit (e shprehur në ktoe) për Shqipërinë



Figura 14: Hapësirat aktuale dhe të parashikuara pyjore për arritjen e objektivit kryesor: në 2020 konsumi i drurit si lëndë djegëse do të jetë i barabartë me rritjen vjetore të pyllin për Shqipërinë

Kategoritë e biomasës	Potenciali teorik (ktoe)	Pjesëmarrja në balancën energjetike (%)	Potenciali teknik i energjisë nxehtësia (ktoe)	Pjesëmarja në balancën e energjisë për ngrohje (%)	Potenciali teknik i energjisë elektriciteti (ktoe)	Potenciali teorik i pjesëmarrjes në balancën energjetike (%)	Potenciali i besueshëm për dekadën e ardhshme, (ktoe)
Pyjet	263.6	1.07%	234.4	0.95%	70.3	1.07%	315.1
Biomasa nga fara e frytit & prodhimi bujqësor	1521.1	6.17%	1449.8	3.97%	293.9	4.45%	1316.8
Mbetja urbane	1576.4	6.39%	1276	5.18%	382.8	5.80%	1446.6
Mbetje nga drurët frutorë	168.1	0.68%	142.9	0.58%	42.9	0.65%	207.5
Mbetje nga bagëtitë	585.25	2.37%	521.6	2.12%	156.50	2.37%	701.5
Impiantet energjetike	62.34	0.25%	57.1	0.232%	17.13	0.260%	76.72
TOTALI	**4176**	**16.9%**	**3212**	**13.0%**	**963.6**	**14.6%**	**4064.2**

Tabela 9: Potenciali teorik, teknik dhe ekonomik i çdo kategorie të biomasës

Mbi bazën e të dhënave të paraqitura, është e qartë se niveli aktuali konsumi të drurit si lëndë djegëse që përdoret vetëm për energji kërkon rritje një rritje më të madhe vjetore me 35-55% se rritja vjetore e pyjeve, dhe kjo tendencë duhet të ndryshojë për të lejuar zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori për ekonominë vitale shqiptare. Për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm të pyllit, do të duhet të merret parasysh përdorimi i biomasës si lëndë djegëse për uljen e konsumit nga 2011,50 ktoe (në 2013) për 167,79 ktoe (në 2020), dhe ripyllëzimi në pragun minimal të paktën 2200 ha për çdo vit.

Përdorimi i biomasës për gjenerim energjie në Shqipëri mund të sigurohet nga burimet e mëposhtme (tabela 9):

- Mbetjet bujqësore (bishta, fara etj.), pas përfundimit të ciklit të tyre të prodhimit, të cilat nuk përdoren në sektorë të tjerë prodhimi;
- Dru zjarri ose mbetje druri nga industritë ndryshme të përpunimit të drurit;
- Plantacione energjetike (korije me rritje të shpejtë) të kultivuara për t'u djegur si biomasa, dhe;
- Mbetjet e kafshëve (kocka, lëkurë, plehu i bagëtive) që nuk përdoren në sektorë të tjerë të ekonomisë;
- Mbetjet (p.sh., mbetje ushqimore dhe familjare).

Rritja e ullirit është një industri e rëndësishme për pjesën bregdetare të Shqipërisë. Nxjerrja e vajit të ullirit është procesi i ndarjes së vajit nga përmbajtja tjetër frutore (ekstrakt vegjetativ i lëngët dhe material i ngurtë). Hapat themelorë në bërjen e vajit të ullirit janë gjithmonë të njëjtë dhe përfshijnë: 1) pastrimin e ullinjve dhe heqjen e farave, gjetheve, sythat dhe mbetjet e tjera; 2) shtypja e ullinjve për bërjen e një paste; dhe 3) ndarja e vajit nga pjesa tjetër e përbërësve të ullirit. Aktualisht, përdoren tre mënyra kryesore të nxjerrjes së vajti të ullirit: "procesi tradicional", procesi me 3 faza dhe procesi me 2 faza.

Llojet e mbeturinave që krijohen: teknologjia e mullirit të ullirit prodhon një larmishmëri mbetjesh, si të ngurta dhe të lëngshme. Mbetjet e ngurta të prodhuara nga nxjerrja e vajit të ullirit janë alperujo [spanjisht] (d.m.th bërsi të mbetura nga sistemi me dy faza), dhe orujo [spanjisht] (d.m.th., bërsi të mbetura nga sistemi me tre faza). Mbetje të ngurta krijohen edhe në ullishte gjatë krasitjes së ullirit. Këtu përfshihen gjethe dhe degë të vogla (pas krasitjes). Gjethet mund të përdoren si ushqim për kafshët, si pleh ose për prodhimin e përzierje plehrash, ndërsa degët e vogla, bërthamat dhe bërsitë e ullirit të thara mund të përdoren gjithashtu për prodhimin e energjisë. Mbetjet e lëngshme njihen si ujërat e zeza të mullirit të ullirit dhe përdoren në disa raste si aditivë për prodhimin e produkteve kozmetike dhe, gjithashtu, për bogaz, pasi sasi të konsiderueshme të vajit të pa mbledhur dhe mbetjet e imëta të bërsisë mbeten në grimcat e ujërave të zeza të mullirit të ullirit.

Përdorimet e mundshme të bërsisë janë: i) prodhimi i bioenergjisë; ii) prodhimi i një vaji me cilësi të ulët, si produkt ushqimor, me anë të një

procesi kimik në fabrika që njihen si "rafineri të bërsive të ullirit"; iii) përhapen në fushat bujqësore si pleh (ose përzihen me dhe për rimbushje, për shembull në gurore); iv) përdoret si ushqim për kafshët; dhe v) shkatërrimi si mbeturina. Për prodhimin e energjisë (fokusi i këtij projekti) bërsitë e ullirit digjen drejtpërdrejtë në kaldaja ose kthehen në paletë ose briket për përdorim në kaldaja dhe soba. Në të dyja rastet bërsitë, së pari, duhet të thahen.

Zonat rurale paraqesin disa karakteristika që favorizojnë zhvillimin e mundshëm të një zinxhiri energjie me bërsi ulliri; kjo pasi: a) sektori i bujqësisë është një nga aktivitetet më të rëndësishme ekonomike në zonat rurale, të cilat përballen me vështirësi të mëdha. Shkalla e papunësisë është më e lartë se mesatarja kombëtare, sidomos te të rinjtë; b) komunitetit vendas i ofrohet një veprimtari ekonomike shtesë. Zhvillimi i komunitetit mbi bazën e industrive bio shpesh sjell forcimin e shërbimeve mbështetëse të komunitetit, duke ofruar vende pune shtesë në organet e qeverisë vendore dhe sektorët e shërbimeve; c) ofron etiketën e gjelbër për përdoruesit e energjisë duke e diferencuar atë nga konkurrentë të tjerë; dhe d) zbut shpopullimin rural. Dokumenti FGM/C.31/5 i Këshillit FGM, së bashku me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO), kanë krijuar me Ministrinë e Mjedisit projektin "përdorimi i bërsisë së ullirit për qëllime energjie", ku qëllimi është lehtësimi e një drejtimi për zhvillimin me sasi të vogla karboni në industrinë agro-bujqësore në Shqipëri. Faktorët kritikë për suksesin e projektit janë zbatimi i zgjidhjeve teknike që janë përshtatur me nevojat vendase të katër nën-sektorëve industrialë në Shqipëri, dhe krijimi i një zinxhiri furnizimi vendas, në mënyrë që pjesë të pajisjeve të prodhohen me kosto-efektive, ndërtimi i sistemit dhe kostot të jenë në përputhje me ekonominë vendase, dhe vënia në punë dhe mirëmbajtja të jetë në kohë dhe e përballueshme. Përvoja e UNIDO-s duke punuar me sektorin industrial në përgjithësi për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në veçanti, është me rëndësi për arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë projekt. Për më tepër, me përdorimin e bërsisë si biomasë, pjesa më e madhe e fabrikave të vajit të ullirit kanë parashikuar të përdorin një pjesë të biomasës (15-20%) për nevojat e brendshme dhe pjesa tjetër (80-85%) do të të transformohet në briketa/pal`t dhe do të shiten për ndërtesat e banimit, ndërtesat e shërbimeve private/publike, si dhe për ndërmarrjet e vogla të përpunimit të ushqimit me anë të përdorimit të teknologjive të fjalës së fundit të energjisë së rinovueshme.

Përdorimi i biogazit është i pazhvilluar, pavarësisht nga burimet e disponueshme, kështu që në vijim do të llogaritet në detaje biomasa bujqësore nga bimët kryesore dhe biomasa që do të mblidhet nga krasitja e pemëve frutore më të rëndësishme.

Bimë (ha)	Grurë	Elb	Misër	Tagji	Drithë
TOTALI	**70000**	**2150**	**68000**	**205000**	**150000**

Tabela 10 paraqet zonat përkatëse të mbjella me grurë, elb, misër, foragjere dhe drithërat dhe bimët më të rëndësishme bujqësore për vitin 2014, bazuar në të dhënat e mbledhura nga Komunikimi i Tretë Kombëtar.

Fruta (numri i pemëve)	Të gjitha frutat e tjera	Ullinj	Agrume	Pjergull	Vresht
TOTALI	**9882000**	**5590000**	**707000**	**5503000**	**9806000**

Tabela 11 paraqet numrin përkatës të pemëve të ullirit, agrumeve, pjergullave, vreshtat dhe të gjitha pemët e tjera për vitin 2014, bazuar në të dhënat e mbledhura nga Komunikimi i Tretë Kombëtar.

Mbështetur në shifrat e mësipërme, në tabelat 12-13 paraqitet energjia nga biomasa e llogaritur nga ana teorike dhe teknike, e cila mund të përdoret për të mbuluar një pjesë të kërkesës për ngrohje me BRE për periudhën 2015–2020.

Parametrat	Bimët (ton)					Tharje e frutave (ton)				
	Grurë	Elb	Misër	Tagji	Drithë	Të gjitha frutat	Ullinj	Agrume	Pjergull	Vresht
Sasia totale e biomasës, ton	183,167	5,193	305,029	443,931	241,538	71,150	40,248	5,090	3,9622	11,767
Pjesët e biomasës për t'u përdorur për energji, %	20%	20%	20%	20%	20%	80%	80%	80%	80%	80%

Sasia totale e biomasës, tonët për t'u përdorur për energji, ton	36,633	1,039	61,006	88,786	48,308	56,920	32,198	4072	31,697	9,414
Vlera kalorifike neto (MJ/kg)	14.4	14.1	18.6	14.2	14.3	18.1	18.1	18	18.2	18.3
Biomasa bujqësore për t'u përdorur për qëllime ngrohjeje, ktoe	12.60	0.35	27.11	30.12	16.50	24.61	13.92	1.75	13.78	4.12

Tabela 12: Potenciali teorik dhe teknik i energjisë nga biomasa që mund të përdoret për të mbuluar një pjesë të kërkesë për ngrohje me BRE

Potenciali i biomasës për sektorin e transportit nuk është llogaritur për momentin dhe do të jetë një detyrë e rëndësishme për punët e ardhshme.

Parametrat	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Bimët bujqësore (ha)	495150	519908	545903	573198	601858	631951	654069	676962	700655	725178	750559
Potenciali i biomasës bujqësore,	86.68	91.01	95.56	100.34	105.36	110.63	116.16	121.97	128.06	134.47	141.19
Biomasa Bujqësore për t'u përdorur	4.334	6.371	8.601	11.038	13.697	16.594	20.909	25.613	30.736	36.306	42.357
Zonat e pemëve frutore (ha)	83939	86457	89051	91722	94474	97308	100227	103234	106331	109521	112807
Potenciali i pemëve frutore si biomasë falë procesit të tëharrjes, ktoe	58.18	59.93	61.72	63.58	65.48	67.45	69.47	71.56	73.70	75.91	78.19
Shpërndarja e pemëve frutor për t'u përdorur për takimin e Synimeve të ngrohjes BRE për t'u përdorur	10%	15.0%	20.00%	25.00%	30.00%	35.00%	40.00%	45.00%	50.00%	55.00%	60.00%
Shpërndarja e biomasës së pemëve frutore për t'u përdorur	5.818	8.989	12.345	15.894	19.645	23.607	27.789	32.200	36.851	41.753	46.915
TOTALI i biomasës bujqësore dhe pemëve frutore për t'u përdorur	10.152	15.360	20.946	26.932	33.342	40.201	48.697	57.813	67.587	78.059	89.272

Tabela 13: Potenciali teorik dhe teknik i energjisë nga biomasa që mund të përdoret për të mbuluar një pjesë të kërkesë për ngrohje me BRE për periudhën 2015–2020

5.2.1 Potenciali i energjisë diellore

Studimi "Dielli në veprim"[6] tregoi që ekziston një potencial shumë i madh për sistemet ngrohëse diellore, jo vetëm për rajonin e BE-së, por praktikisht në të gjithë botën, duke përfshirë shtetet pjesëmarrëse në ANE. Është treguar, gjithashtu, që duhet të kapërcehen një numër pengesash për të zhvilluar tregun për këtë teknologji të nxjerrë prej kohësh. Në përgjithësi, tregu i energjisë diellore mund të përshkruhet si një treg me rritje të qëndrueshme dhe me teknologji të nxjerra në treg prej kohësh. Megjithatë, pjesë të publikut dhe sektorët tregtarë vazhdojnë të mos jenë në dijeni të këtyre fakteve dhe habiten nga objektivat e përfitimit afatshkurtër. Për këtë arsye, industritë, kompanitë e strehimit privat e publik dhe ndërmarrjet e shërbimeve publike, përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të përdoruesve të instalimeve të sistemeve për ngrohje me energji diellore. Synimi i kësaj analize është të përshkruajë potencialin e ngrohjes së ujit me energji diellore dhe rritjen e pritur të tregut, si dhe pengesat kryesore, me qëllim theksimin e mundësive për të përhapur përdorimin e ngrohjes diellore për tregun e energjisë dhe të sektorit të banesave. Kohët e fundit janë kryer disa studime të rëndësishme për zhvillimin e tregut dhe potencialin e sistemeve me energji diellore. Të gjitha këto studime kanë arritur në të njëjtin rezultat: Tregu është shumë i madh dhe, i marrë në tërësi, është në rritje të qëndrueshme, ndonëse ecuria e rritjes ndryshon shumë nga shteti në shtet. Në këto studime tregohet që potenciali i kolektorëve diellorë për sektorin e banesave dhe për sektorin e ngrohjes rajonale mund të shprehet lehtësisht si një shifër shumë domethënëse: **0,5 – 1,0 m^2 kolektorë diellorë për banorë.**

Vlera minimale përfaqëson klimat më të ngrohta dhe vlera e lartë klimat e Evropës Veriore dhe Qendrore. Studimet tregojnë gjithashtu se numri në fjalë mund të shkojë drejt 1 m^2 kolektor diellor për banor në shtetet me klimë më të ngrohtë. Në Shqipëri ka kushte të shkëlqyera për ngrohjen e ujit nëpërmjet sistemeve për ngrohje me energji diellore. Rrezatimi diellor vjetor është i lartë dhe teorikisht mund të sigurojë në Shqipëri një ngrohje të ujit të nevojshme me temperaturë të ulët gjatë një periudhe kohore të paktën (7–8) muaj. Regjimi i rrezatimit diellor dhe orët me diell gjatë vitit në Shqipëri tregohen në figurat 15 dhe 16.

Sistemet e kolektorëve diellore të disponueshëm në tregjet shqiptare mbështeten si energji shtesë në energji elektrike, veçanërisht gjatë periudhës nëntor–mars. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet që kërkesa për energji për ngrohjen e ujit në një familje me 4 persona është afërsisht 2,500 kWh/vit. Nevoja për energji shtesë mund të reduktohet duke instaluar panele diellore më efikase, por si rrjedhim kjo do të rrisë tepricën e energjisë diellore nga prilli në shtator.

Siç shihet nga grafikët, për një eficiencë mesatare 55% të sistemeve diellore, sistemet NUED mund të sigurojnë deri në 68% të kërkesës për energji për ngrohjen e ujit në Peshkopi, e cila shkon deri në 86% në Sarandë.

MEI, gjatë gjithë periudhës 2009–2015, e asistuar nga programi i FGM/PNUD-it "Iniciativa globale për transformimin dhe fuqizimin e tregut për përdorimin e energjisë diellore për ngrohjen e ujit: Programi për Shqipërinë" ka marrë përsipër shumë detyra, veçanërisht lidhur me monitorimin e sistemeve për ngrohje me energji diellore të instaluara deri tani në Shqipëri dhe vlerësimin e së ardhmes së tregut për familjet, banesat e shërbimeve publike dhe private, si dhe për disa nënsektorë të industrisë.

[6] Tregjet termike diellore në Evropë Tendencat dhe statistikat e tregut 2009 (botuar në qershor 2010)





Figura 15 dhe 16: Rrezatimi diellor (kWh/m² vit) dhe orët me diell (orët/vit) në Shqipëri



Figura 17: Potenciali i sistemeve NUED për sektorin familjar/banesave (m²) për çdo zonë klimatike



Figura 18: Potenciali i sistemeve NUED për sektorin e ndërtesave të shërbimeve publike dhe private (m²)

5.2.2 Potenciali i energjisë së erës

Energjia e erës përdoret për pompimin e ujit, mullinjtë me erë dhe në dekadat e fundit vëmendja është përqendruar në prodhimin e energjisë elektrike. Makineritë që operojnë me energjinë e erës kanë një kapacitet të instaluar që ndryshon nga disa [kW] deri në 5 [MW] dhe po përdoren me sukses në zona të veçuara. Energjia e erës është një potencial i konsiderueshëm si burim energjie dhe është e shpërndarë njëtrajtësisht në çdo cep të botës. Mullinjtë me erë mund të instalohen shpejt dhe përdorin një sipërfaqe të vogël toke. Në shumicën e shteteve, instalimet e mullinjve me erë përballen me një shqetësim të përbashkët, mungesën e matjes së vazhdueshme të shpejtësisë së erës dhe me mungesën e erës së përhershme.



Figura 21: Ndarja në zona sipas sasisë së orëve vjetore të erës për një vlerë mesatare të shpejtësisë së erës

Për këtë arsye, shoqëritë e ndryshme që duan të investojnë në këtë sektor e kanë të vështirë të marrin një vendim nëse ia vlen të investohet në një rajon të caktuar pa këto të dhëna të domosdoshme. Të dhënat e marra nga stacione të ndryshme Metrologjike në Shqipëri janë të përafërta dhe jo shumë të besueshme, sepse nuk janë mbledhur me qëllimin specifik të matjes së energjisë së erës (tabela 14 dhe figura 21).

Ekzistojnë plane të mëdha për zhvillimin e energjisë së erës në Shqipëri në vitet e ardhshme me investime të konsiderueshme, me një total të centraleve të erës të licencuar me fuqi 1300 MW (tabela 14) (licenca të lëshuara deri në vitin 2010).

Emri i shoqërisë	Vendndodhja	Kapaciteti i instaluar, MW	Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit	Prodhimi vjetor GWh	Investimi (K Euro)	Afati për vënien në punë	Licenca dhënë më
HERA sh.p.k.	Bilisht Kapshticë	150	N/st Zemblak 400/110 kV	330	229,037	2014	Nëntor 2007
Alb Wind Energy sh.p.k.	Grykëderdhja e Shkumbinit, Tërpan	225	220 kV Rrashbull –Fier, 110 kV Tempan – Uznovë	484	454,127	2013	Janar 2008
Enpower Albania sh.p.k.	Karaburun Llogara	500	N/st 110 kV Kavajë	1,369	700,000	2015	Tetor 2008
Ers-08 shpk	Kryevidh Kavajë	40	N/st 110 kV Kavajë	68	43,582	2013	Qershor 2008
Biopower Green Energy sh.p.k.	Shëngjin Kodrat e Rencit, Lezhë	230	N/st 400/220/30 kV	450	250,000	2013	Gusht 2008
Unione Eolika Albania sh.p.k.	Kryevidh Kavajë	150	220 kV Rrashbull-Fier	300	149,100	2012	Gusht 2008

E-Vento Albania sh.p.k.	Butrint Markat	72	N/st 150 kV Bistricë	65	93,000	2012	Korrik 2008
TOTALI		**1367**		**3,066**	**1,918,846**		

Tabela 14: Lista e parqeve eolike për të cilat është dhënë licenca për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike

Duke pasur si qëllim vlerësimin e potencialit të këtij burimi, është vlerësuar niveli i prodhimit të parqeve eolike të planifikuar për ndërtim në Shqipëri (tabela 15).

Disponueshmëria e parkut eolik ose faktori i ngarkesës - përqindja e kohës gjatë së cilës turbinat e erës janë në gjendje pune me ngarkesë të plotë– konsiderohet universalisht si problemi më i madh për energjinë e erës. Pasiguria mbi sasinë që do të prodhojë një park eolik është një sfidë më vete. Metodologjia e parashikimit dhe vlerësimet e burimeve të erës janë detyra të specialistëve. Matjet mesatare vjetore të erës ndërmjet 5,8 m/s deri në 7 m/s në zonat e kërkuara janë premtuese. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet që faktorët e ngarkesës në mënyrë tipike nga 22% deri në 25%.

Gjatë periudhës 2010–2014, ka vazhduar dhënia e licencave, dhe deri në fund të dhjetorit 2014 në Shqipëri, totali i tyre shkon përafërsisht në 2548 MË, në bazë të informacionit të dhënë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me potencial prodhimi energjie prej rreth 5 TWh/vit. Kapaciteti i sistemit elektrik shqiptar për të dërguar dhe përthithur energjinë e erës është vlerësuar përafërsisht deri në 180-200 MW.

Duke qenë se era është një burim energjie me probabilitet të ulët është i nevojshëm realizimi i balancimit. Kombinimi i erës dhe i burimeve hidrike është një opsion i mirë. Centralet hidrike mund të futet në punë në çdo moment prandaj është një balancues i shkëlqyer për centralet e erës.

Shoqëria	**Zona**	**Kapaciteti i instaluar**	**Faktori i ngarkesës**	**Fuqia mesatare efektive gjatë një viti**	**Prodhimi vjetor GWh (vlerësim i kompanisë)**	**Prodhimi vjetor GWh (vlerësim i studimit)**
HERA sh.p.k.	Bilisht Kapshticë	150 MW	23.8%	35 MW	330	312
Alb Wind Energy sh.p.k.	Grykëderdhja e Shkumbinit, Tërpan	225 MW	20.7%	46 MW	484	407
Enpower Albania sh.p.k.	Karaburun Llogara	500 MW	25.9%	129 MW	1,369	1,134
Ers-08 sh.p.k.	Kryevidh Kavajë	40 MW	21.0%	8 MW	68	73
Biopower Green Energy sh.p.k.	Shëngjin, Kodrat e Rencit, Lezhë	230 MW	22.0%	50 MW	450	481
Unione Eolika Albania sh.p.k.	Kryevidh Kavajë	150 MW	24.3%	36 MW	300	319
E-Vento Albania sh.p.k.	Kryevidh Kavajë	72 MW	23.2%	17 MW	65	146

Tabela 15: Lista e parqeve eolike për të cilat është dhënë licenca për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike

5.2.3 5.1.8 Rezervat e energjisë gjeotermale

Ekziston një shumëllojshmëri burimesh gjeotermale, të cilat mund të klasifikohen në: burimet hidrotermale, rrymat e nxehta të ujit dhe shkëmbinjtë e shkrirë. Nga këto tre grupe, deri më tani, vetëm burimet hidrotermale kanë gjetur përdorim praktik në Shqipëri. Burimet hidrotermale, shumicën e kohës janë burime energjie gjeotermale që prodhojnë ujë të nxehtë dhe përdoren në disa shtete për ngrohje të ambienteve të ndryshme.

Një teknikë e re përdorimi e energjisë gjeotermale është injektimi i ujit të ftohtë në puse të thella nafte dhe gazi natyror, të cilat tashmë nuk përdoren më, për t'u ngrohur. Uji injektohet me një temperaturë (7–8)^{o}C dhe del në sipërfaqe me një temperaturë (22–25)^{o}C. Në Shqipëri ka pak shpresa për të prodhuar avull nga burimet gjeotermale, por ka disa burime hidrotermale me temperaturë më të ulët (tabela 16)

Nr.	Vendndodhja e burimit hidrotermal	Temperatura, ^{0}C	Emri i pusit	Temperatura e ujit në sipërfaqe, ^{0}C
1	Karmë-Sarandë	34	Ishmi-1/b	60
2	Langaricë-Përmet	26-31	Kozan-8	54
3	Sarandapori-Leskovik	26-27	Galigati-2	45
4	Tërvoll-Gramsh	24	Bubullima-5	48-50
5	Llixha-Elbasan	58	Seman-1	35
6	Kozan-Elbasan	57	Ardenica-12	32-38
7	Shupal-Elbasan	29-30		
8	Mamurras-Krujë	21		
9	Peshkopi	35-43.5		

Tabela 16: Burimet gjeotermale në Shqipëri

Burimet më të rëndësishme gjeotermale të eksploruara deri më tani në Shqipëri janë:

- Sipërfaqja gjeotermale e Krujës, e cila është zona me burimet më të mëdha gjeotermale në Shqipëri, me një sipërfaqe 18 km gjatësi dhe 4,5 km gjerësi, e cila përmban rezerva të një game $5.9x10^{8}$-$5.1x10^{9}$ GJ.

- Zona gjeotermale e Ardenicës ku uji del nga thellësia me një temperaturë 32-38 ^{o}C dhe rrjedh në sipërfaqe me një prurje me 15-18 l/s.

- Zona gjeotermale e Peshkopisë ku ndodhen disa burime gjeotermale të vendosur pranë njëri-tjetrit. Prurja e ujit është rreth 14-17 l/s dhe temperatura është 35-43,5 ^{o}C.

5.2.9 Kontributi i BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike

Për të përgatitur më mirë zbatimin e Direktivës 2009/28/EC, Shqipëria si të gjithë anëtarët e BE-së dhe Palëve Kontraktore të tjera të Traktatit të KE-së, ka bërë një vlerësim të potencialit të disponueshëm për zhvillimin burimeve të energjive të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Tabela 10 së bashku me tabelat 1 dhe 3 të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme janë përdorur si strukturë për të përmbledhur gjetjet kryesore.

Për sektorin e energjisë, kapaciteti i instaluar i parashikuar (i akumuluar) (në MW) dhe prodhimi vjetor (GWh) tregohen sipas secilës teknologji. Për sektorin hidrik, bëhet një dallim ndërmjet centraleve me kapacitet të instaluar nën 1 MW, midis 1 dhe 10 MW dhe mbi 10 MW. Për energjinë diellore, detajet janë dhënë veçmas për kontributet nga centralet elektrike me panele diellore fotovoltaike dhe ato me sisteme për ngrohje me energji diellore. Të dhënat për energjinë e erës në det (*onshore*) dhe në tokë (*offshore*) tregohen të ndara. Për biomasën e përdorur për energjinë elektrike, është i nevojshëm një dallim midis biomasës së ngurtë, të gaztë dhe të lëngshme (tabela 17.a dhe 17.b). Figura 22 paraqet parashikimin e furnizimit me energji elektrike, sipas këtij studimi, mbështetur në studimet e ndryshme dhe të përditësuar. Gjithashtu, mbulimi përkatës për çdo bimë (përfshirë bimët BRE), jepet në figurat 22-26.



Figura 22: Vlerat historike (2001-2014) të furnizimit me energji elektrike dhe parashikimi përkatës 2015- 2020 (GWh/vit)

Teknologjitë	*2009*		*2010*		*2011*		*2012*		*2013*		*2014*	
	MW	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*
Hidro:												
<1MW	19	53	21	69	23	91	25	101	33	122	45	164
1MW–10 MW	9	24	18	32	26	100	44	188	117	375	225	755
>10MW	1,460	5,900	1,460	7,743	1,460	4,158	1,460	4,725	1,483	6,586	1,506	4,058
Diellore:												
Fotovoltaike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Energji diellore e NEUD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Era:												
Në det	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Në tokë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Biomasa:												
E ngurtë	-	-	1	4	2	8	3	12	4	16	5	20
Bio-gaz	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Biolëngje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	**1,488**	**7,200**	**1,499**	**7,360**	**1,509**	**7,379**	**1,529**	**7,552**	**1,633**	**7,701**	**1,777**	**7,793**
nga të cilat në CHP	-	-	1	4	2	8	3	12	4	16	5	20

Teknologjitë	*2015*		*2016*		*2017*		*2018*		*2019*		*2020*	
	MW	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*	*MW*	*GWh*
Hidro:												
<1MW	48	185	50	195	55	213	60	232	61	236	67	259
1MW–10 MW	248	941	272	1,035	315	1,197	360	1,368	369	1,402	423	1,607
>10MW	1,506	4,453	1,571	4,713	1,571	4,713	1,571	4,713	1,834	5,680	1,834	5,680
Diellore:												
Fotovoltaike	-	-	-	-	50	120	-	-	-	-		
Energji diellore e NEUD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Era:												
Në det	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Në tokë	-	-	-	-	4	8	10	20	20	40	30	60
Biomasa:												
E ngurtë	-	-	1	4	2	8	3	12	4	16	5	20
Bio-gaz	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Biolëngje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	**1,803**	**8,095**	**1,995**	**8,396**	**2,052**	**8,697**	**2,114**	**8,998**	**2,405**	**9,299**	**2,483**	**9,600**
nga të cilat në CHP	-	-	1	4	2	8	3	12	4	16	5	20

Tabela 17.a: Vlerësimi i potencialit të disponueshëm në Shqipëri për çdo teknologji energjie të rinovueshme në energjinë elektrike 2010–2014

ANEKS I

BILANCI ENERGJETIK (2009/NË ktoe)

BAZUAR NË VLERAT KALORIFIKE NETO

Year 2009	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
Primary production	1263.07	3.2	8.2	576.626	213	449.82	6.65	5.6
Recovered products	0.00			0.0				
Imports **(Pet Prod+ Electricity)**	1298.73	50.0		1086.65		162.13		
Stock change	54.03			54.03				
Exports	403.83			362.00		41.83		
Bunkers	0.00							
Gross inland consumption	2103.93	53.15	8.2	1247.25	213.00	570.12	6.65	5.60
Transformation input	805.14			355.40		449.75		
Classic thermal Power Stations	1.70			1.7				
Public Hydro power stations	449.75					449.75		
Autoprod. thermal power stations	0.00			0.00				
Nuclear power stations	0.00							
Patent fuel and briquetting plants	0.00							
Coke-oven plants	0.00							
Blast-furnace plants	0.00							
Gas works	0.00							
Refineries	353.70			353.697				
District heating plants	0.00							
Transformation output	663.20	0		342.30		447.70		3.3
Classic thermal Power Stations	0.07					0.07		
Public Hydro power stations	447.63					447.63		
Autoprod. thermal power stations	0.00							
Nuclear power stations	0.00							
Patent fuel and briquetting plants	0.00							
Coke-oven plants	0.00							
Blast-furnace plants	0.00							
Gas works	0.00							
Refineries	345.60			342.30				3.3
District heating plants	0.00	0						
Exchanges and transfers, returns	0.00							
Interproduct transfers	0.00							
Products transferred	0.00							
Returns from petrochem. industry	0.00							
Transformation Losses	**15.15**	**0**		13.10		2.05		
Consumption of the energy branch	33.29		7.2	25.63		0.43		**0**
Production and distribution of electricity	0.41					**0.41**		
Pumped storage stations	0.00							
District heating plants	0.00							
Extraction and agglo. of solid fuels	0.00							
Coke-oven and gas works plants	0.00							
Oil and Nat. Gat extraction plants	22.87		3.9	18.93		0.01		
Oil & Gas pipelines	0.00							
Oil refineries	10.01		3.3	6.7		0.01		
Nuclear fuel fabrication plants	0.00							
Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd)	105.49					105.5		**0.00**
Available for final consumption	1946.70	53.15	0.9	1208.52	213.00	462.15	6.65	2.30
Final non-energy consumption	76.10			76.10				
Chemical industry	12.90			12.90				
Other sectors	63.20			63.20				
Final energy consumption	**1870.60**	53.2	0.9	1132.4	213.0	462.15	6.7	2.3
Industry	275.54	50		149.83	2.1	71.31		2.3
Iron & steel industry	25.60			15.86		9.74		
Non-ferrous metal industry	5.39			1.05		4.35		
Chemical industry	23.40			19.32		4.08		
Glass, pottery & building mat. industry	86.67	50		27.79		8.88		
Ore-extraction industry	13.88			8.89		4.99		
Food, drink & tobacco industry	28.92			11.21		15.42		2.3
Textile, leather & clothing industry	11.88			2.50		9.38		
Paper and printing	8.54			1.40		7.14		
Engineering & other metal industry	6.83			2.60		4.23		
Other industries	65.39		0.90	59.29	2.1	3.10		
Transport	754.44			754.44				
Railways	3.00			3.00				
Road transport	721.79			721.79				
Air transport	18.50			18.50				
Inland navigation	11.15			11.15				
Households, commerce, pub. auth., etc.	653.52	3.2		121.35	204.6	317.72	6.65	
Households	487.32	0.9		73.00	187.42	224.00	2.00	
Agriculture	94.51			80.00	6.3	8.21		
Fisheries	25.00			25.00				
Other	65.12			0.00		65.12		
Statistical difference	**2.48**	**-0.05**	**0.94**	**1.79**	**0.00**	**-0.20**	**0.00**	**0.00**

Bilanci energjetik i Shqipërisë për vitin 2009 (Burimi: AKBN – dhjetor 2011)

ANEKS II

BILANCI ENERGJETIK (2014/NË ktoe)

BAZUAR NË VLERAT KALORIFIKE NETO

Year 2014	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
Primary production	**2021.34**	**0**	**27.6**	**1368.22**	**202**	**406.30**	**12.14**	**5.1**
Recovered products	0.00			0.0				
Imports **(Pet Prod+ Electricity)**	1897.96	92.82		1515.20	10.400	279.54		
Stock change	307.54			307.54				
Exports	1244.97	0.26		1209.75	19.190	15.78		
Bunkers	27.00			27.00				
Gross inland consumption	**2339.78**	**92.56**	**27.6**	**1339.13**	**193.21**	**670.06**	**12.14**	**5.10**
Transformation input	767.30			361.00		406.30		
Classic thermal Power Stations	0.00			0		0		
Public Hydro power stations	406.30					406.30		
Autoprod. thermal power stations	0.00			0.00		0		
Nuclear power stations	0.00							
Patent fuel and briquetting plants	0.00							
Coke-oven plants	0.00							
Blast-furnace plants	0.00							
Gas works	0.00							
Refineries	361.00			361.00				
District heating plants	0.00							
Transformation output	**663.20**	**0**	**0**	**335.62**	**0**	**406.30**	**0.00**	**1.5**
Classic thermal Power Stations	0.00					0.00		
Public Hydro power stations	404.80					404.80		
Autoprod. thermal power stations	0.00							
Nuclear power stations	0.00							
Patent fuel and briquetting plants	0.00							
Coke-oven plants	0.00							
Blast-furnace plants	0.00							
Gas works	0.00							
Refineries	336.92			335.62				1.3
District heating plants	0.00	0						
Exchanges and transfers, returns	0.00							
Interproduct transfers	0.00							
Products transferred	0.00							
Returns from petrochem. industry	0.00							
Transformation Losses	**27.08**	**0**	**0**	**25.38**	**0**	**1.50**	**0.00**	**0.2**
Consumption of the energy branch	59.31	**0**	**20.0**	**26.48**	**0**	**12.83**	**0**	**0**
Production and distribution of electricity	0.33					0.33		
Pumped storage stations	0.00							
District heating plants	0.00							
Extraction and agglo. of solid fuels	2.80					2.8		
Coke-oven and gas works plants	0.00							
Oil and Nat. Gat extraction plants	27.70		20.0	2.50		5.20		
Oil & Gas pipelines	0.00							
Oil refineries	28.48		0.0	23.98		4.500		
Nuclear fuel fabrication plants	0.00							
Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd)	94.74	**0**	**0**	**0**	**0**	**94.74**		**0.00**
Available for final consumption	2157.35	**92.56**	**7.6**	**1287.26**	**193.21**	**560.99**	**12.14**	**3.60**
Final non-energy consumption	87.49			87.49				
Chemical industry	0.33			0.33				
Other sectors	87.17			87.17				
Final energy consumption	**2069.85**	**92.6**	**7.6**	**1199.8**	**193.2**	**560.99**	**12.1**	**3.6**
Industry	417.75	87.36	7.6	182.72	10	126.09	0.40	3.6
Iron & steel industry	104.66			88.47		16.19		
Non-ferrous metal industry	6.16			0.00		6.16		
Chemical industry	18.99			8.96		10.03		
Glass, pottery & building mat. industry	151.19	87.36		44.16		19.66		
Ore-extraction industry	7.35			0.29		7.06		
Food, drink & tobacco industry	57.60		6.6	22.35		24.67	0.40	3.6
Textile, leather & clothing industry	18.03			1.91		16.12		
Paper and printing	11.38			1.26		10.12		
Engineering & other metal industry	7.01			1.01		6.00		
Other industries	35.77		1.00	14.31	10	10.07		0.40
Transport	815.99	0	**0.00**	**815.99**	**0.00**	**0.00**	0.00	**0**
Railways	2.10			2.10				
Road transport	779.30			779.30				
Air transport	0.91			0.91				
Inland navigation	33.67			33.67				
Households, commerce, pub. auth., etc.	**722.38**	**5.2**	**0.00**	**115.24**	**171.2**	**419.00**	**11.74**	**0.00**
Households	546.11	0.5		79.23	160	301.00	5.38	
Agriculture	79.69			51.79	12	15.90		
Fisheries	34.04			34.04				
Other	0.00			0.00		0.00		
Statistical difference	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**

Bilanci energjetik i Shqipërisë për vitin 2013 (Burimi: AKBN – maj 2015)

ANEKS III

TARIFA PROMOVUESE PËR TEKNOLOGJITË E IMPIANTEVE TË ERËS DHE IMPIANTET FOTOVOLTAIKE PËR VENDE TË NDRYSHME

Tarifa promovuese për impiantet e srës

Për shumë teknologji BRE në përgjithësi dhe në veçanti impiantet e Erës kostot specifike të gjenerimit të energjisë elektrike në MWh ndryshojnë sipas madhësisë e impiantit; kjo është tipike për turbina të erës të vogla dhe të mëdha etj. Pothuajse të gjithë vendet e BE-së, kandidatë dhe jo, janë duke aplikuar tarifa promovuese me nivele të ndryshme të shpërblimit, kryesisht në bazë të madhësisë së impiantit në këto teknologji. Duke aplikuar këtë qasje mund të merren parasysh kostot e prodhimit të energjisë elektrike të ulët/të lartë, për shkak të ekonomive/joekonomive të shkallës. Gama e çmimeve mund të jetë shumë e madhe për kapacitet të ndryshme të instaluar. Në figurën 1, paraqitet një krahasim për impiantet e Erës për vende të ndryshme dhe sipas madhësive të ndryshme.



Figura 27: Krahasimi i tarifave promovuese për impiantet e erës për vende të ndryshme dhe madhësi të ndryshme (€ cent/kWh)

Projektet e impianteve të erës kërkojnë investime fillestare të larta, kështu që parashikimi CAPEX është shumë kritik. Figure 2 paraqet rezultatet për tarifat promovuese për impiantet e Erës bazuar në tarifat promovuese mesatare (nxjerrë nga figura 1) për instalime të impianteve të erës me kapacitet më të lartë.



Figura 28: Krahasimi i tarifave promovuese për impiantet e Erës për vende të ndryshme dhe për kapacitet mesatar (€ cent/kWh)

Tarifa promovuese për impiantet PV

Për shumë teknologji të BRE në përgjithësi dhe impiantet PV në veçanti kostot specifike të gjenerimit të energjisë elektrike për MWh ndryshojnë sipas madhësisë së impiantit; kjo është tipike për impiantet PV, diellore, biomasa dhe biogazi, gjeotermale, turbina ere të vogla etj. Pothuajse të gjithë vendet e BE-së, kandidatë dhe jo, po aplikojnë tarifa promovuese me nivele të ndryshme të shpërblimit, kryesisht në bazë të madhësisë së impiantit në këto teknologji. Pothuajse të gjithë vendet e BE-së, kandidate dhe jo, janë duke aplikuar tarifa promovuese me nivele të ndryshme të shpërblimit, kryesisht në bazë të madhësisë së impiantit në këto teknologji. Duke aplikuar këtë qasje mund të merren parasysh kostot e prodhimit të energjisë elektrike të ulët/të lartë, për shkak të ekonomive/joekonomive të shkallës. Gama e çmimeve mund të jetë shumë e madhe. Në Gjermani, për impiantet diellore me kapacitet mes 500 kW dhe 5 MW niveli i tarifave varion nga 130 dhe 80 €/MWh, ndërsa në ekstremin tjetër gjejmë Mbretërinë e Bashkuar, me një tarifë promovuese që fillon nga 61 €/MWh për 5 MW deri në 270 €/MWh për impiante prej 15 kW. Në figurën 3, paraqitet një krahasim i tarifave promovuese për impiante diellore PV për vende të ndryshme dhe madhësi të ndryshme impianti.



Figura 29: Krahasimi i tarifave promovuese për impiantet diellore PV për vende të ndryshme dhe madhësi të ndryshme (€ cent/kWh)

Figura 4 tregon tarifat promovuese mesatare (nxjerrë nga figura 3) për impiante PV me kapacitet mesatar të instaluar (impiante PV prej 200-1000 kW).



Figura 30: Krahasimi i tarifave promovuese për impiantet diellore PV për vende të ndryshme dhe kapacitet mesatar (€ cent/kWh)

VENDIM
Nr. 28, datë 20.1.2016

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË HIMARËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Himarës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores "Për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe të Zonës së Mbrojtur përreth", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

QENDRA HISTORIKE HIMARË-FSHAT
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE

	Gjatësi			Gjerësi		
Pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
Q1	40°	7`	6.44``N	19°	43`	56,68``E
Q2	40°	7`	5.58``N	19°	43`	58,57``E
Q3	40°	7`	4.41``N	19°	43`	59.00``E
Q4	40°	7`	4.24``N	19°	43`	58.77``E
Q5	40°	7`	3.60``N	19°	43`	58.79``E
Q6	40°	7`	3.00``N	19°	43`	59.12``E
Q7	40°	7`	2.09``N	19°	43`	59.53``E
Q8	40°	7`	1.49``N	19°	43`	58.98``E
Q9	40°	7`	1.09``N	19°	43`	57.86``E
Q10	40°	7`	0.97``N	19°	43`	56.90``E
Q11	40°	7`	0.51``N	19°	43`	56.33``E
Q12	40°	7`	0.69``N	19°	43`	55.08``E
Q13	40°	7`	1.08``N	19°	43`	54.06``E
Q14	40°	7`	1.46``N	19°	43`	53.24``E
Q15	40°	7`	2.26``N	19°	43`	54.10``E
Q16	40°	7`	3.14``N	19°	43`	53.14``E
Q17	40°	7`	4.24``N	19°	43`	52.57``E
Q18	40°	7`	5.25``N	19°	43`	52.83``E
Q19	40°	7`	5.91``N	19°	43`	53.82``E
Q20	40°	7`	6.24``N	19°	43`	55.08``E
Q21	40°	7`	6.50``N	19°	43`	56.01``E

PËR SHPALLJEN E ZONËS TË MBROJTUR (HIMARË)

KOORDINATAT GJEOGRAFIKE

	Gjatësi			Gjerësi		
Pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
Q1	40°	7`	6.44``N	19°	43`	56.68``E
Q2	40°	7`	5.58``N	19°	43`	58.57``E
Q3	40°	7`	4.41``N	19°	43`	59.00``E
Q4	40°	7`	4.24``N	19°	43`	58.77``E
Q5	40°	7`	3.60``N	19°	43`	58.79``E
Q6	40°	7`	3.00``N	19°	43`	59.12``E
Q7	40°	7`	2.09``N	19°	43`	59.53``E
Q8	40°	7`	1.49``N	19°	43`	58.98``E
Q9	40°	7`	1.09``N	19°	43`	57.86``E
Q10	40°	7`	0.97``N	19°	43`	56.90``E
Q11	40°	7`	0.51``N	19°	43`	56.33``E
Z12	40°	7`	0.12``N	19°	43`	57.57``E
Z13	40°	6`	59.64``N	19°	43`	59.21``E
Z14	40°	6`	59.16``N	19°	44`	1.18``E
Z15	40°	6`	58.99``N	19°	44`	2.70``E
Z16	40°	6`	59.39``N	19°	44`	3.94``E
Z17	40°	6`	59.93``N	19°	44`	4.75``E
Z18	40°	7	0.48``N	19°	44`	6.16``E
Z19	40°	7`	2.02``N	19°	44`	6.32``E
Z20	40°	7`	2.95``N	19°	44`	5.23``E
Z21	40°	7`	3.86``N	19°	44`	3.77``E
Z22	40°	7`	4.42``N	19°	44`	2.98``E
Z23	40°	7`	5.12``N	19°	44`	2.02``E
Z24	40°	7`	5.92``N	19°	44`	1.02``E
Z25	40°	7`	6.78``N	19°	44`	0.05``E
Z26	40°	7`	7.56``N	19°	43`	59.20``E
Z27	40°	7`	8.38``N	19°	43`	58.32``E
Z28	40°	7`	8.57``N	19°	43`	57.74``E
Z29	40°	7`	7.94``N	19°	43`	57.13``E
Z30	40°	7`	7.24``N	19°	43`	56.76``E

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË HIMARËS DHE ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) administrimi i Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth, sipas hartës së zoonifikimit, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë përbërëse e saj;

b) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Himarës.

3. Rregullorja përcakton edhe mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Himarës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Himarës, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore, i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Himarës, me vlera historiko-kulturore, përbëhet prej:

a) Qendrës Historike;

b) Zonës së Mbrojtur përreth.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj paraqiten në hartën e zoonifikimit të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth, e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

4. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Himarës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth.

Neni 3
Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike e qytetit të Himarës kufizohet nga jugu, perëndimi dhe veriu nga konturi i mureve rrethuese të kalasë së Himarës dhe është hapësira me vlera të rëndësishme historike e arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit të vendbanimit nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Ajo përmban monumente antike, siç është kalaja e Himarës, fillimet e së cilës datojnë në shek. IV-III p.e.s., monumente kulti, siç është kisha e Shën Sergut dhe Bahut, fillimet e së cilës duhet t'i përkasin qendrës peshkopale të Himarës, shumë kisha të tjera pasbizantine, si dhe një numër të madh banesash me një tipologji të larmishme e një rrjet rrugor të kalldrëmuar, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësitë e terrenit dhe vende-vende me kalime në formë tuneli nën banesat e fshatit.

2. Kufijtë e Qendrës Historike të qytetit të Himarës paraqiten me koordinata gjeografike, si dhe në hartën e zoonifikimit të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4
Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

1. Ndërhyrjet restauruese dhe rigjallëruese në Qendrën Historike të qytetit të Himarës, si dhe në monumentet e të dyja kategorive do të kenë si qëllim kthimin e qytetit të Himarës në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar. Për të realizuar këtë qëllim, për Qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese e rigjallëruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike të qytetit të Himarës, brenda kësaj zone lejohen vetëm:

a) ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive, të cilat mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare e ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë;

b) ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale;

c) studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve që, me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike;

ç) studime që përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara;

d) ndërhyrjet rehabilituese, konservuese ose restaurimet integruese në shumë ndërtime në Qendrën Historike që janë në gjendje rrënoje, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim, mbi strukturën ekzistuese (muret perimetrale) me objektiv primar ruajtjen, sa të jetë e mundur, të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3 m, ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen, duke zbatuar parimet e mësipërme.

Projektet për ndërhyrjet në këto lloj objektesh do të shqyrtohen dhe miratohen rast pas rasti në Këshillin Shkencor dhe Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

dh) në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;

e) ritrajtimet dhe rikonstruksionet që integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

3. Në Qendrën Historike ndalohen ndërtimet e reja, me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikën 2, të këtij neni.

4. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe, më pas, procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 5

Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e Mbrojtur e qytetit të Himarës shtrihet në anën lindore të Qendrës Historike. Ajo përbëhet nga:

a) Zona e Mbrojtur 1;

b) Zona e Mbrojtur 2.

2. Zona e Mbrojtur 1 përmban disa banesa me vlera arkitektonike dhe rrjetin rrugor karakteristik të fshatit, me të cilat plotëson vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës së planifikuar për ndërtime të reja.

3. Zona e Mbrojtur 2 është një zonë me një gjelbërim të strukturuar, që formohet nga një parcelë e hershme, e mbjellë me ullinj, e cila përbën kurorën e gjelbër të fshatit.

4. Kufijtë e Zonës së Mbrojtur paraqiten me koordinata gjeografike, si dhe në hartën e zoonifikimit të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në Zonën e Mbrojtur

1. Në Zonën e Mbrojtur ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

2. Ruhen dhe përfshihen vlerat mjedisore, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësisë tradicionale.

3. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues, përveç rikonstruksionit të tij. Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë, detyrimisht, materialet dhe teknikat tradicionale.

4. Kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo edhe ndërtime të reja, për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësuar kushtet e jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

5. Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por, sidoqoftë, jo më shumë se 2 (dy) – 6.5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit.

6. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

7. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe, më pas, procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 7

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e kulturës në qytetin e Himarës, sipas vlerave të tyre historiko–kulturore, ndahen në dy kategori:

a) monumente të kategorisë I;

b) monumente të kategorisë II.

2. Ato ndodhen në Qendrën Historike të qytetit të Himarës, në Zonën e Mbrojtur rreth saj ose në pjesët e tjera të qytetit. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Neni 8

Monumentet e kategorisë I

1. Monumentet e kategorisë I janë ndërtime me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale himariote.

2. Monumentet e kategorisë I, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tillë, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

3. Monumentet e kategorisë I ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur rreth saj dhe në pjesën tjetër të qytetit.

4. Në monumentet e kategorisë I kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese, sipas gjendjes fillestare.

5. Deri në shpalljen e zonës së Mbrojtur të monumenteve të kategorisë I, që ndodhen jashtë zonës së Qendrës Historike, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës.

Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare shqyrtohet rast pas rasti nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 9

Monumentet e kategorisë II

1. Monumentet e kategorisë II janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, që marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por ruajnë dhe vlera arkitekturore në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme e të brendshme, në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë. Këto ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë II lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale

dhe përdorimi i teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme, si dhe për t'u adaptuar edhe për shërbime të tjera.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve, të përmendura në shkronjat "c", "ç", "d" e "dh", të pikës 2, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës, ose nga subjekte të licencuara në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, ose subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas kësaj rregulloreje. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave, në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme, për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre, të përmendura në nenin 6, të kësaj rregulloreje, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 12
Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e Kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo edhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 13
Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plani rregullues i qytetit të Himarës, detyrimisht, merr parasysh vlerat e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 15
Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi, sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të zoonifikimit të Qendrës Historike të qytetit të Himarës dhe Zonës së Mbrojtur përreth saj.

3. Brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë, i paraqet ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës së kategorive I e II për shqyrtim dhe miratim.



VENDIM
Nr. 1, datë 21.1.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 22.9.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 41/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kume Dapi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., Tiranë, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja, bazuar në vendimin nr. 142, datë 19.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është trashëgimtare ligjore e Hysen Dapit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 6022, datë 7.7.2011, la në fuqi vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të KKP-së të qarkut Tiranë, i cili kishte vendosur që trashëgimtarët ligjorë të Hysen Dapit, ku përfshihet edhe kërkuesja, të njihen pronarë të një sipërfaqeje prej 100 dynymësh, e ndodhur te kthesa e Kamzës, në fshatin Mëzes, komuna Kashar, qarku Tiranë, prej së cilës iu kthye fizikisht sipërfaqja prej 91247 m², ndërsa për sipërfaqen prej 8753 m² atyre u ishte njohur e drejta e kompensimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4102, datë 29.3.2012, lëshoi urdhrin për ekzekutimin e vendimit nr. 6022, datë 7.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Shoqëria përmbarimore private “Hoti Bailiff Service” filloi ekzekutimin e detyrueshëm, duke i kërkuar regjistruesit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, objekt i vendimit gjyqësor nr. 6022, datë 7.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, bazuar në nenet 25/a, 37 dhe 45 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, hartoi projekturdhrin nr. 1784, datë 8.6.2012, “*Për refuzimin e regjistrimit të kësaj pasurie me arsyetimin se dokumentet e paraqitura për regjistrim nga kërkuesja krijonin mbivendosje me pasurinë e regjistruar më parë në favor të Bashkisë të Tiranës, në favor të shtetit apo edhe me pasuritë e pronarëve të tjerë privatë.”*. Ky projekturdhër, me të njëjtat arsye, u la në fuqi nga urdhri nr. 523, datë 19.6.2012, i Kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8736, datë 24.7.2013, vendosi: *“Anulimin e urdhrit nr. 523, datë 19.6.2012, të Kryeregjistruesit të ZQRPP-së; detyrimin e ZVRPP-së Tiranë që të regjistrojë titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit për sipërfaqen e truallit prej 91247 m².”*

6. Prej aktit të ekspertimit, i hartuar nga eksperti topograf i thirrur nga gjykata, ka rezultuar se planvendosja e pronës që u është njohur dhe kthyer trashëgimtarëve ligjorë të Hysen Dapit me vendimin nr. 136, datë 26.5.2008, të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, bazuar në këqyrjen dhe matjet në terren, krijon mbivendosje me pasurinë nr. 68/55

vol 18, faqe 159, të ndodhur në ZK 2679, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe me pasurinë nr. 98, vol 4, faqe 148, ZK 2679, në pronësi të shtetit, ndërsa nuk krijon mbivendosje me pozicionin gjeografik faktik të pasurive të tjera të personave privatë të cituar në urdhrin nr. 523, datë 19.6.2012 të Kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

7. Gjykata Administrative Tiranë, me vendimin nr. 1167, datë 1.4.2014, la në fuqi vendimin nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Mbi kërkesën e kërkueses, shoqëria përmbarimore private "Strati Bailiff's Service" filloi ekzekutimin e detyrueshëm të vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përmbushje të këtij ekzekutimi të detyrueshëm përmbaruesi gjyqësor lëshoi urdhrin nr. 2884. prot, datë 14.5.2014, me anë të të cilit urdhëronte ZVRPP-në Tiranë që të regjistronte titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit për sipërfaqen e truallit prej 91247 m².

9. Kërkuesja është vënë në dijeni nga shoqëria përmbarimore se pala debitore, ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën e datës 7.8.2014, ka njoftuar këtë shoqëri se në përgjigje të aplikimit të saj ka kryer vetëm veprimin e inskriptimit të urdhrit të përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e pasqyruar atë në seksionin E të kartelës së pasurisë me nr. 68/55, vol 18, f. 159, të ndodhur në ZK 2679, regjistruar në pronësi të Bashkisë Tiranë. Kësaj shkrese i është bashkëngjitur kopja e kartës së kësaj pasurie, ku në seksionin E të saj rezulton se është bërë shënimi i urdhrit të përmbaruesit gjyqësor nr. 6173 prot., datë 14.5.2014 të shoqërisë përmbarimore private "Strati Bailiff's Service".

10. Pas këtij veprimi, kërkuesja, në datën 20.8.2014, i është drejtuar me kërkesë përmbaruesit gjyqësor dhe ZQRPP-së, për dijeni edhe ZVRPP Tiranë, duke kërkuar marrjen prej përmbaruesit gjyqësor të të gjitha masave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të detyruar regjistruesit e ZVRPP-së Tiranë të ekzekutojnë në mënyrë të rregullt dhe të plotë vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe ushtrimin nga ana e Kryeregjistruesit të kontrollit mbi veprimtarinë e regjistruesit të ZVRPP-së Tiranë për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me ekzekutimin e rregullt dhe të plotë të këtij vendimi gjyqësor.

11. Në përgjigje të kërkesës, Kryeregjistruesi i ZQRPP-së, me shkresën nr. 4724/1, datë 26.9.2014, është shprehur se bazuar në dispozitat ligjore për këtë kërkesë, kërkuesja duhej t'i drejtohej ZVRPP-së Tiranë dhe se për të marrë informacion nga kjo zyrë duhej të paguheshin tarifat përkatëse, ndërkohë që kërkuesja, në cilësinë e kreditorit, kishte paguar tarifën për ekzekutimin e detyrueshëm të regjistrimit të vendimit gjyqësor.

12. Përmbaruesi gjyqësor, me shkresat nr. 246, datë 12.1.2015 dhe nr. 1305, datë 30.1.2015, paralajmëroi ZVRPP-në Tiranë dhe ZQRPP-në për vendosjen e gjobës dhe me vendimin nr. 2519, datë 19.2.2015 ka vendosur të gjobisë për moskryerjen e veprimit të caktuar, regjistruesen e ZVRPP-së Tiranë.

13. Regjistruesja e ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. 7945, datë 9.3.2015, ka njoftuar si përfaqësuesin e kërkueses, ashtu edhe shoqërinë përmbarimore private "Strati Bailiff's Service", se në datën 9.3.2015 e ka regjistruar vendimin nr. 1167, datë 1.4.2014 të Gjykatës Administrative Tiranë në seksionin "Përshkrimi i veçantë" dhe në seksionin E të kartelës së pasurisë me nr. 68/55, vol. 18, f. 159, të ndodhur në ZK 2679, në pronësi të Bashkisë Tiranë, me regjistrim të tipit "Kufizim" deri në zgjidhjen e çështjes me themel, me objekt fshirjen e regjistrimeve të kryera dhe pretendimin e palëve nga organet kompetente. Kësaj shkrese i është bashkëngjitur kopja e kartës së kësaj pasurie, ku si në seksionin "Përshkrimi i veçantë", ashtu edhe në seksionin E të saj rezulton se është bërë regjistrimi i vendimit nr. 1167, datë 1.4.2014, të Gjykatës Administrative Tiranë.

14. Gjithashtu, pala debitorë, në datën 25.2.2015 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt padie "Kundërshtim i veprimeve përmbarimore për gjobitjen për moskryerje të veprimit të caktuar" në emër të titullares së institucionit. Me vendimin nr. 2762, datë 20.5.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj."*.

II

15. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.

16. ***Subjekti i interesuar***, Zyra Përmbarimore Tiranë, me shkresën nr. 877 prot., datë 30.6.2015, paraqiti dosjen përmbarimore, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e tij në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesja pretendon se pala debitore, ZVRPP-ja, refuzon të ekzekutojë vendimin gjyqësor të formës së prerë duke vazhduar të pengojë me veprimet e saj procesin e regjistrimit të pronës në emër të kërkueses.

18. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese.*)

20. Gjykata e vlerëson çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (24.7.2013) deri në ushtrimin e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë më shumë se 2-vjeçare. Një periudhë e tillë për regjistrimin e një vendimi gjyqësor konsiderohet nga Gjykata si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë.

i) Kompleksiteti i çështjes

21. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt regjistrimin e një vendimi gjyqësor nga ZVRPP-ja, duke bërë kështu veprimin e fundit të kalimit të pronësisë dhe njohjes trashëgimtare të kërkueses mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Argumenti i paraqitur nga ZVRPP-ja lidhet me ekzistencën, sipas saj, të një regjistrimi të mëparshëm në kohë dhe nëse do të regjistrohej edhe prona e kërkueses, atëherë do të kishte një mbivendosje midis pronave të dy subjekteve. Sipas ZVRPP-së, një veprim i tillë nuk mund të kryhet prej saj pa shmangur mbivendosjen, gjë e cila duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

22. Pavarësisht këtij argumenti, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqet kompleksitet ligjor, duke qenë se zgjidhja e problemit faktik që ekziston në regjistrimin e pronës nga ana e ZVRPP-së nuk e

bën çështjen komplekse në atë shkallë saqë të përbëjë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se veprimi që duhet të kryhet nga pala debitore nuk ka kosto financiare, që të mund të pengojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

23. Gjykata çmon se nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuesit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuesit

24. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuesit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

25. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo ka ndjekur rigorozisht të gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e saj të fituar gjyqësish, pra regjistrimin e faktit të qenies trashëgimtare e ligjshme dhe si e tillë pronare e ligjshme e objekteve të përcaktuara në vendim gjyqësor.

26. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të saj për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve

27. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje është e nevojshme të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore dhe ZVRPP-ja kanë marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata.

28. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimi nr. 7, datë 27.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe ai i ka shfrytëzuar ato. Shoqëria përmbarimore ka kryer të gjitha komunikimet e nevojshme, me qëllim vënien në dijeni dhe detyrimin e palës debitore për të zbatuar vendimin gjyqësor, deri në vendosjen e gjobës për mosekzekutim të vendimit gjyqësor. Me qëllim përmbushjen e këtij ekzekutimi të detyrueshëm, përmbaruesi gjyqësor lëshoi urdhrin nr. 2884 prot., datë 14.5.2014, me anë të të cilit urdhëronte ZVRPP-në Tiranë që të regjistronte

titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRPP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit, për sipërfaqen e truallit prej 91247 m². Përmbaruesi gjyqësor, me shkresat nr. 246, datë 12.1.2015 dhe nr. 1305, datë 30.1.2015, paralajmëroi ZVRPP-në Tiranë dhe ZQRPP-në për vendosjen e gjobës dhe me vendimin nr. 2519, datë 19.2.2015, ka vendosur gjobitjen për moskryerjen e veprimit të caktuar nga ana e regjistrueses së ZVRPP-së Tiranë.

32. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se nga shoqëria përmbarimore janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, përfshi edhe vendosjen e gjobës, por ato kanë rezultuar të pasuksesshme.

33. Gjykata mori në vlerësim, gjithashtu, edhe veprimet e palës debitore, ZVRPP-së Tiranë, e cila ka refuzuar vazhdimisht të regjistrojë një vendim gjyqësor të formës së prerë. ZVRPP-ja ka parashtruar si argument për mosregjistrimin e vendimit gjyqësor se ka mbivendosje të pronave midis dy ose më shumë subjekteve dhe se kjo situatë, sipas saj, duhet zgjidhur nga kërkuesja në rrugë gjyqësore.

34. Gjykata konstaton se duke filluar nga data 24.7.2013, kur është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kërkueses, shoqërisë përmbarimore dhe palës debitore. Gjatë gjithë kësaj kohe nga ana e palës debitore nuk është marrë asnjë masë konkrete për të regjistruar pronën. Shënimi i vendosur nga ana e ZRPP-së si pronë e regjistruar me kufizim, nuk është zgjidhje e këtij problemi dhe as ekzekutim i vendimit gjyqësor, pasi kërkuesja aktualisht nuk mund të pajiset me një certifikatë të rregullt pronësie. Gjykata çmon se një proces tjetër gjyqësor ose administrativ do të cenonte edhe më tej kërkuesen në realizimin e së drejtës së saj për të qenë pronare dhe për të ushtruar efektivisht të drejtën e pronës. Për këtë arsye, i takon palës debitore të gjejë mjete të tjera për të ekzekutuar vendimin gjyqësor. Është detyrim i debitorit që në çështjen konkrete të gjejë mundësitë e duhura për të regjistruar pronën në emër të kërkueses sipas vendimit gjyqësor dhe jo të paraqesë pengesa apo arsye për të mos e regjistruar pronën në emër të kërkueses.

35. Megjithatë, pavarësisht detyrimit që ka pala debitore për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, Gjykata e sheh me vend të theksojë se në rastet kur regjistrimi i pronës në regjistrin e pasurive të paluajtshme ndesh në vështirësi ose është i pamundur për shkak të mbivendosjes së dy ose më shumë pronave, kjo situatë kërkon një zgjidhje, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Gjykata vëren se bazuar në nenin 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" (i ndryshuar), ky institucion, mes të tjerash, drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë, si dhe kryen drejtimin metodik të shërbimeve dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Bazuar në nenin 13/c të rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", institucion i varësisë së Ministrisë të Drejtësisë është edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Duke qenë se është detyrë funksionale e organit epror të monitorojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e organeve vartëse, duke marrë masat përkatëse që funksionimi i këtyre të fundit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, mosushtrimi i këtyre tagrave, për të siguruar që të drejtat e shtetasve të garantohen ose për të korrigjuar gabimet e organit vartës në bazë të ndërhyrjes vertikale, do të ravijëzohet në një përgjegjësi të organit epror. Për këtë arsye, Gjykata e gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së këtij organi për të siguruar shmangien e situatave të tilla, të cilat mund të gjejnë zgjidhje vetëm nëpërmjet krijimit të një sistemi regjistrimi eficient dhe transparent të pasurive të paluajtshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet efektivisht e drejta e pronës së shtetasve (*shih vendimin nr. 6, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të

nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vitore Tusha, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

KËRKESË
Nr. 331, datë 19.1.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)", për objekte dhe truall.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit objekte dhe truall. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 3378693 (tre milionë e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

SEKRETARI I MINISTRISË SË
TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

Lista e pronave që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan (Rreshqitja në fshatin Ibë)".

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Z. Kadast	Nr.pas.	Lloji pas.	Sip.Total	Sip.ndert. m2	Vlera(Leke)	Lloji pas.	Sip.truall m2	Cmimi(Leke/m2)	Vlera(Leke)	Vlera Totale	Konfirmime
1	Shefikat	Dalip	Filolli	1977	306/1	NDERTESE	50	50	693758	TRUALL	50	665	33250	727008	Konf.ZVRPP
2	Shefikat	Dalip	Filolli	1977	306/3	NDERTESE	100	100	1894639	TRUALL	100	665	66500	1961139	Konf.ZVRPP
3	Xhelal		Filolli	1977	306/2	NDERTESE	48	48	690546					690546	Konf.ZVRPP
TOTALI							198	198	3278943		150		99750	**3378693**	

NDREQJE GABIMI

Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 1098 të Këshillit të Ministrave, datë 28.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i objektit "Studim, projektim, lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë"", të ndryshuar, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 243, viti 2015, në kolonën e tretë "Nr.Pasurisë" në nënndarjen nr. 40, shifra që **ishte"…11/177…" bëhet "…11/176…"**.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 532 lekë